**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2403/7 prot. Datë 14/11/2023

**V E N D I M**
**Nr. 1148/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|---|---|
| Jonaid Myzyri | Kryetar |
| Fiorent Zguro | Nënkryetar |
| Kreshnik Ternova | Anëtar |
| Anila Malaj | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 14/11/2023 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt**: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik "4 AM" SHPK në procedurën e prokurimit "*Procedure e Hapur" me mjete elektronike – Pune mbi kufirin e lartë monetar*" me nr. REF-76782-08-04-2023 me objekt: "*Rikonstruksion dhe fuqizimi i N/Stacionit Kuçovë 110/35/20/10/6 kV*", me fond limit 649.995.513.87 (*gjashtëqind e dyzet e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë e pesëqind e trembëdhjetë pikë tetëdhjetë e shtatë*) lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 11.09.2023, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Tensionit të Lartë OSSH ShA.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operaotëve ekonomikë "ENBI POWER" SHPK & "Aci Enginnering" SHPK në procedurën e prokurimit

**Ankimues:** "4 A-M" SHPK me NIPT K92005016L dhe adresë, Rruga "Artan Lenja", Pallati i 4 A-M, Apartamenti A1, kati i I-re, Tiranë.

| | |
|---|---|
| | "ENBI POWER" SHPK me NIPT K47905860J dhe me adresë, Rruga "Kavajes", Kompleksi 100 Vitrinat, Kulla II, Kati 3, Tiranë & "Aci Enginnering" SHPK me NIPT L51609014F dhe adresë, Njesia Bashkiake Nr. 5, Rruga Abdyl Frashëri, Ndërtesa 8, Hyrja 13, Apartamenti 07, 1019, Tiranë. |
| **Autoriteti Kontraktor:** | Drejtoria e Tensionit të Lartë OSSH Sh.A me adresë Rruga "Gramoz Pashko", Vila Gri, Tiranë, Shqipëri. |
| **Baza Ligjore:** | Ligji nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik*", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020, "*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19"*. |

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V ë r e n:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*" dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues, kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

## II

*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 07.08.2023, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit "*Procedure e Hapur" me mjete elektronike – Pune mbi kufirin e lartë monetar*" me nr. REF-76782-08-04-2023 me objekt: "*Rikonstruksion dhe fuqizimi i N/Stacionit Kuçovë 110/35/20/10/6 kV*", me fond limit 649.995.513.87 (*gjashtëqind e dyzet e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë e pesëqind e trembëdhjetë pikë tetëdhjetë e shtatë*) lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 11.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Tensionit të Lartë OSSH ShA.

II.2. Në datën 11.09.2023 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 26.09.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1. | "Senka" SHPK | 0.00 lekë | Skualifikuar |
| 2. | BOE "ENBI POWER" SHPK & "Aci Enginnering" SHPK | 610,195,972.28 lekë | Skualifikuar |
| 3. | "Stat Co" SHPK | 636,282,396.80 lekë | Skualifikuar |
| 4. | "4 AM" SHPK | 630,484,449.23 lekë | Skualifikuar |

II.4. Në datën 27.09.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE "Publikimi i Anulimit" për procedurën e prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 82, datë 02.10.2023.

II.5. Operatori ekonomik "4 AM" SHPK rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për arsyet si më poshtë:
*"• Operatori Ekonomik ofertues duhet te ketë të punësuar si staf teknik, dy inxhinier elektrike. Për të provuar plotesimin e këtij kushti duhet të paraqitet:*

*- Kontratë pune të vlefshme*

*- Diplome, CV*

*- Librezat e punes*

*- List pagesat E-sig 25 ku të jenë te pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë për një periudhë 3 muajsh nga dita e shpalljes se tenderit.*

*OE ''4AM'' ShPK ka deklaruar ne shtojcën nr. 8 disponimin e ketyre inxhiniereve, por nuk ka paraqitur dokumentacionin e kerkuar per te (Kontratë pune të vlefshme)*

*- Diplomë, CV*

*- Librezat e punës*

*- Çertifikata perkatese e Inxhiniereve Elektrik te certifikuar nga prodhuesi i mbrojtjes rele dhe komandimit.*

*Nderkohe, per kete kriter nuk eshte lejuar permbushja me vetdeklarim, po eshte kerkuar paraqitja e dokumentacionit ne fjale.*

*• Operatori ekonomik duhet te kete në stafin e tij te pakten 1 Inxhinier Elektrik te certifikuar nga prodhuesi ose ekuivalent i releve te mbrojtjes te cilat do te furnizoje per pregatitjen e skemave elektrike sekondare për integrimin dhe konfigurimin e releve të reja në skemen ekzistuese sekondare të mbrojtjes rele, sinjalizimet dhe komandimet.*

*Për të provuar plotesimin e këtij kushti duhet të paraqitet:*

*- Kontratë pune të vlefshme*

*- Diplomë, CV*

*- Librezat e punës*

*- Certifikata perkatese e Inxhiniereve Elektrik te certifikuar nga prodhuesi i mbrotjes rele dhe komandimit. Listëpagesat E-sig 25 ku të jenë te pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë për një periudhë 3 muajsh nga dita e shpalljes se tenderit.*

*OE ''4AM'' ShPK ka deklaruar ne shtojcen nr. 8 disponimin e ketij inxhinieri, por nuk ka paraqitur dokumentacionin e kerkuar per te (Kontratë pune të vlefshme)*

*- Diplomë, CV*

*- Librezat e punës*

*- Certifikata perkatese e Inxhiniereve Elektrik te certifikuar nga prodhuesi i mbrojtjes rele dhe komandimit.*

*Nderkohe, per kete kriter nuk eshte lejuar permbushja me vetdeklarim, po eshte kerkuar paraqitja e dokumentacionit ne fjale.*

*I.OSSH FIER objekti "Rikonstruksion i kabinave 6/0.4 KV te fierit 26,6 KV, Nenstacioni Fier" Vlera 91.539.798,86 leke pa TVSh.*

*Iliriada 20% dhe 4 AM 80%*

*1. Situacioni perfundimtar i punimeve*

*2. Certifikatë marrje ne dorezim*

*3. Kontrata*

*4. Kontrate bashkepunimi+ Prokure*

*5. Ska tabelen e ndarjes se punimeve qe ka marre persiper te kryeje secili operator ekonomik.*

*6. Formular Vleresimi*

*7. Akt kolaudimi*

*8. Ska paraqitur faturat*

*Nuk ploteson dokumentacion*

*II.OSHE SELITE objekti: "Ndërtim i fiderit 20 KV S1 dhe S2 te Nenstacionit 110.20.10 KV Selite, kabina te reja dhe kabina rikonstruksion si dhe linja TU me kabell ABC" (Punetori) Vlera 34.654.664 leke pa TVSh.*

*4 AM 100%*

*1. Certifikatë marrje ne dorezim*

*2. Faturat*

*3. Kontrate*

*4. Formular Vleresimi*

*5. Akt kolaudimi*

*6. Situacion perfundimtar*

*Nuk konsiderohet pune e ngjashme*

*III.OSHE ZEJMEN objekti: "Rikonstruksion i disa kabinave elektrike dhe zhvillimi i rrjetit TU me kabell ABC ne fidrin e Zejmenit, nenstacioni Lezhe" Loti II " Rikonstruksion I rrjetit ajror TM, rikonstruksion i tete kabinave dhe ndertimi I dy kabinave shtyllore fidri 10 KV zejmen Nenstacionib110/10 KV Lezhe*

*Vlera 36.988.563 leke pa TVSh.*

*4 AM 100%*

*1. Certifikatë marrje ne dorezim*

*2. Faturat*

*3. Kontrate*

*4. Formular Vleresimi*

*5. Akt kolaudimi*

*6. Situacion perfundimtar*

*Nuk konsiderohet pune e ngjashme*

*IV.OSSH Elbasan me objekt: "Rikonstruksion i rrjetit TU me kabell ABC ne Belsh si dhe kabinave gjate rruges kryesore Elbasan-Peqin"*

*Vlera 232.988.238 leke pa TVSh.*

*Iliriada 40% dhe 4 AM 60%*

*1. Situacion perfundimtar*

*2. Kontrata*

*3. Kontrate bashkepunimi+ Prokure*

*4. Ska tabelen e ndarjes se punimeve qe ka marre persiper te kryeje secili operator ekonomik.*

*5. Formular Vleresimi*

*6. Akt kolaudimi*

*7. Fatura*

*8. Certifikata e marrjes ne dorezim*

*9. Nuk konsiderohet pune e ngjashme*

*V.OSHE FIDERI me objekt: "Zevendesimi i rrjetit ekzistues 6 KV ne rrjet me tension 20KV te fiderit 248 N/stacioni Dinamo"*

*Vlera 72.881.602 leke pa TVSh.*

*4 AM 100%*

*1. Kontrate*

*2. Formular vleresimi*

*3. Akt kolaudimi*

*4. Fature*

*5. Proces verbal marrje ne dorezim*

*6. Situacion perfundimtar*

*Nuk konsiderohet pune e ngjashme*

*VI.OSSH BURREL me objekt: " Rikonstruksion i rrjetit TU A.B.C dhe ndertimin e kabinave shtyllore, ne Agjencine Bulqize Drejtoria Rajonale Burrel"*

*Vlera 110.153.870,78 leke pa TVSh.*

*4 AM 100%*

*1. Kontrate*

*2. Formular Vleresimi*

*3. Akt Kolaudimi*

*4. Situacion Perfundimtar*

*5. Fatura*

*6. Proces Verbal marrje ne dorezim*

*Nuk konsiderohet pune e ngjashme*

*V.OSSH KINOSTUDIO me objekt: "Kthim ne 20 kv i nje pjese te fiderit 126 Nenstacioni Kinostudio, Tirane"*

*Vlera 180.467.986,78 leke pa TVSh.*

*4 AM 100%*

*1. Kontrate*

*2. Formular vleresimi*

*3. Akt Kolaudimi*

*4. Situacion perfundimtar*

*5. Fatura*

*6. Certifikate marrje ne dorezim*

*Nuk konsiderohet pune e ngjashme*

*VII.LINJA 110 KV me objekt: Realizimin e punimeve civile ne nenstacionin 110 KV.*

*Vlera 61.460.882,5 leke pa TVSh.*

*Vlera shtese 195.100.600 leke pa TVSh.*

*4 AM 100 %*

*1. Formular vleresimi kontrate baze*

*2. Akt kolaudimi baze*

*3. Kontrata baze*

*4. Situacion perfundimtar*

*5. Faturat per kontraten baze*

*1. Formular vleresimi kontrate baze*

*2. Akt kolaudimi baze*

*3. Kontrata baze*

*4. Situacion perfundimtar*

*5. Faturat per kontraten baze*

*Nuk ka certificate te marrjes ne dorezim as per bazen as per shtesen*

*Nuk ploteson dokumentacionin*

*VIII.OSHE RRASHBULL me objekt: Zgjatimi i rrjetit 20 kv nga F.53 Nst shkozet dhe ndertimi i kabinave te reja dhe rrjetit TU per zonen kantina e veres, tuneli i trenit, laboratori Rrashbull"*

*Vlera 93.426.914 leke pa TVSh.*

*4 AM 100 %*

*1. Formular vleresimi*

*2. Akt kolaudimi*

*3. Kontrata*

*4. Situacion perfundimtar*

*5. Faturat*

*6. Ka nje vertetim per permbushjen e kushteve te garancise*

*Nuk ka certificate te marrjes ne dorezim*

*Nuk konsiderohet pune e ngjashme*

*IX.OST Cerrik me objekt : Ndertimi i Linjes se re 110 KV me nje qark Cerrik-Kajan-Kucove-Jagodine dhe rehabilitimi i trakteve dalese te linjave 110 KV te N/Stacioneve Cerrik dhe Kuçovë Vlera 570.250.000 leke pa TVSh.*

*4 AM 98 % dhe Bonus 2%*

*1. MB + Prokure + tabela e ndarjes se punimeve*

*2. Akt kolaudimi*

*3. Kontrata*

*4. Situacion perfundimtar*

*5. Faturat*

*6. Certifikate marrje ne dorezim*

*7. Ska Formular vleresimi*

*Nuk ploteson dokumentacionin*

*X.Godina RSU Tirane me objekt: Ndertim i godines tip RSU Nr.3*

*Vlera 305.946.636,93 leke pa TVSh*

*4 AM 100%*

*1. Kontrata*

*2. Formular vleresimi*

*3. Akt Kolaudimi*

*4. Situacion perfundimtar*

*5. Fature*

*6. Certifikate marrje ne dorezim*

*Ploteson dokumentacionin*

*Nuk konsiderohet pune e ngjashme*

*XI.OSHE Lezhe: Rikonstruksion i rrjetit elektrik TM TU ne qytetin Lezhe*

*Vlera 136.885.517 leke pa TVSh*

*4 AM 100%*

*1. Kontrata*

*2. Formular vleresimi*

*3. Akt Kolaudimi*

*4. Situacion perfundimtar*

*5. Fature*

*6. Certifikate marrje ne dorezim*

*Nuk konsiderohet pune e ngjashme*

*XII.OSHE KOMBINAT: Rrjeti 20KV i fiderave T16, T17, T18. T19 nga nenstacioni i ri 110/20 KV Kombinat si dhe rrjeti TU me kabllo me vetembajtje tip ABC ne kabinat e tyre Tirane.*

*Vlera 155.913.305 leke pa TVSh*

*4 AM 100%*

*1. Kontrata*

*2. Formular vleresimi*

*3. Akt Kolaudimi*

*4. Situacion perfundimtar*

*5. Fature*

*6. Certifikate marrje ne dorezim*

*Nuk konsiderohet pune e ngjashme*

*XIII.OSSH Durres: Ndertimi i rrjetit TM 20 KV, Fideri F6, kabinave perkatese dhe rrjetit TU me percjelles ABC, N/ST Gjiri i Lalzit, Loti II.*

*Vlera 159.477.902,27 leke pa TVSh*

*4AM 95% dhe Iliriada 5%*

*1. Situacion perfundimtar*

*2. Kontrata*

*3. Kontrate bashkepunimi+ Prokure*

*4. Ska tabelen e ndarjes se punimeve qe ka marre persiper te kryeje secili operator ekonomik.*

*5. Formular Vleresimi*

*6. Akt kolaudimi*

*7. Fatura*

*8. Certifikata e marrjes ne dorezim*

*Nuk konsiderohet pune e ngjashme*

*XIV.DTL Nenstacioni Vore: Rikonstruksion i N/Stacionit Vores 35/20/6 KV*

*Vlera 208.993.280.01 leke pa TVSh*

*Vlera e modifikimit te kontrates 8.457.007 leke pa TVSh*

*4 AM 100%*

*1. Kontrata*

*2. Formular vleresimi*

*3. Akt Kolaudimi*

*4. Situacion perfundimtar*

*5. Fature*

*6. Certifikate marrje ne dorezim*

*Ploteson dokumentacionin".*

II.5.1. Në datën 02.10.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3458 dhe me nr. 2403/2023 prot., datë 02.10.2023 e operatorit ekonomik "4 A-M" SHPK, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike.

Pretendimet janë si më poshtë vijon:
*"Shoqëria "4A-M" SHPK si operator ekonomik i cili ka interes në ketë procedurë prokurimi publik , e konsideron refuzimin e ofertës së saj si te pa bazuar ne ligj dhe ne fakt dhe e kundërshton me argumentet si me poshtë:*
*A. Lidhur me pretendimet e Autoriteti Kontraktor për mosdorëzimin e dokumenteve si Kontrate pune te vlefshme - Diplome, CV - Librezat e punës - Certifikata përkatëse e Inxhiniereve Elektrik te certifikuar nga prodhuesi i mbrotjes rele dhe komandimit për inxhinieret elektrik, sqarojmë se shoqëria "4A-M" SHPK ka dorëzuar në shtojcën nr. 8 ku ka deklaruar të gjithë stafin e kërkuar sipas kualifikimeve të kërkuar.*
*Ky vetdeklarim është kryer në përputhje me kriteret e tenderit dhe me kërkesat e pikave 1 dhe 2 të nenit 82 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".*

*Shoqëria 4A-M ShPK në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ka plotësuar të gjitha të dhënat e mundshme që parashikon formulari përmbledhës, konkretisht ka deklaruar punonjësit në shtojcën përkatëse të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas përcaktimit të dokumenteve në lidhje me përmbushjen e kriterit mbi disponimin e stafit kryesor, mbështetës dhe stafin teknik punonjësit specialistë të kualifikuar të kërkuar për realizimin me sukses të procedurës objekt-shqyrtimi.*
*autoriteti kontraktor në fazën e vlerësimit procedural në të cilën ndodhet aktualisht procedura e prokurimit objekt-ankimi, për përmbushjen e kritereve të kualifikimit, duhet ti referohet formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas rubrikave të aksesueshme elektronikisht nga autoriteti kontraktor dhe kërkesën për dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat (a, (b, (d, (dh, (e, (h, (i, (j të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.*

*Pra, pretendimi i Autoritetit Kontraktor se ofertuesi duhet tij kishte dorëzuar edhe dokumentet Kontrate pune te vlefshme - Diplome, CV - Librezat e punes - Certifikata perkatese e Inxhiniereve Elektrik te certifikuar nga prodhuesi i mbrojtjes rele dhe komandimit se bashku me ofertën elektronike nuk qëndron pasi ky kriter konsiderohet i plotësuar me dorëzimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit deri ne momentin e verifikimit të këtij dokumentacioni me kërkesën e autoritetit kontraktor.*

*Me poshtë sqarojmë dokumentacionin e dorëzuar ne ofertën tone dhe ngjashmërinë e eksperiencave te dorëzuar me objektin e tenderit:*
*o I. OSSH FIER objekti Rikonstruksion i kabinave 6/0.4 KV te fiderit 26,6 KV, Nenstacioni Fier Vlera 91.539.798,86 leke pa TVSh. Iliriada 20% dhe 4 AM 80% 1.Situacioni perfundimtar i punimeve 2. Cerifikate marrje ne dorezim 3. Kontrata 4. Kontrate bashkëpunimi+ Prokure 5. Ska tabelen e ndarje se punimeve qe ka marre përsipër te kryeje secili operator ekonomik 6. Formular Vlerësimi 7. Akt kolaudimi 8. Ska paraqitur faturat. Nuk plotëson dokumentacion.*
*Lidhur me pretendimin e autoritetit kontraktor se për këtë kontratë nuk është paraqitur tabela e ndarjes së punimeve sqarojmë se kjo ndarje është bërë në tekstin e marrëveshjes së bashkëpunimit dhe konkretisht në nenin 3 të saj ku specifikohen zërat e marrë përsipër nga shoqëria "ILIRIADA" SHPK.*
*Gjithashtu lidhur me paraqitjen e faturave tatimore, shoqëria 4A-M SHPK ka paraqitur situacionin përfundimtar se bashku me faturën tatimore ne faqet 85-87 te dokumentit OSSH Fier 2ë sipas kërkesave te kritereve të veçanta të tenderit.*
*o II. OSHE SELITE objekti: Ndertim i fiderit 2 KV S1 dhe S2 te Nenstacionit 110.20.10 KV Selite, kabina te reja dhe kabina rikonstruksion si dhe linja TU me kabull ABC (Punetori) Vlera 34.654.664 leke pa TVSh. 4 AM 100% 1. Certifikatë marrje ne dorezim 2. Faturat 3. Kontrate 4. Formular Vleresimi 5. Akt kolaudimi 6. Situacion perfundimtar nuk konsiderohet pune e ngjashme.*
*Ne ndryshim nga pretendimet e autoritetit kontraktor ne vlerësojmë se ky objekt ka ngjashmëri me kontratën objekt shqyrtimi. Punimet e kryera për këtë kontratë rezultojnë të jenë të ngjashme me procedurën objekt ankimimi si nga specifikimet teknike, nga kompleksiteti, metodologjia, teknologjia, zërat e punëve që do të bëhen etj. Situacionet e paraqitura dëshmojnë për kryerjen e punimeve edhe në nënstacion, fakt ky i cili ka lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me natyrën e kontratës që synon të realizojë autoriteti kontraktor në përfundim të procedurës së prokurimit objekt ankimimi. Zërat konkretë të punimeve të përshkruara në situacionet e paraqitura rezultojnë të kenë ngjashmëri me zërat e objektit të prokurimit dhe ky fakt është evident duke qenë se jem përpara dy kontratave të ngjashme nga natyra me njëra tjetrën. Konkretisht mund të përmendim zërat që kanë të bëjnë me:*
*- furnizim dhe shtrim kabulli TM dhe TU, furnizim vendosje terminalesh, prishje shtresa betoni, punime gërmimi me krah dhe me eskavator, punime suvatimi mur tulle dhe fasade, sherbetisje dhe bojatisje me gëlqere, konstruksione metalike, punim shtresa betoni, rrethim me rrjete teli, ulluk shkarkimi, FV tuba, mur tulle, hidroizolim, mbushje, transport materialesh pajisjesh dhe dherash, demontim pajisjesh dhe konstruksionesh ekzistuese, furnizim dhe instalim transformator fuqie, montim ura TM, furnizim vendosje kolaudim cela*

*TM, Autovinça 5 ton per ngritje dhe zbritje pajisje dhe materiale, elektroda tokezimi, ndares/shkeputes tokëzimi.*
*Nisur nga konstatimet sa më sipër operatori ekonomik 4A-M SHPK nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur ka provuar ngjashmërinë e punimeve midis këtij objekti dhe objektit të tenderit.*
*o III. OSHE ZEJMEN objekti: Rikonstruksion i disa kabinave elektrike dhe zhvillimi i rrjetit TU me kabull ABC ne fidrin e Zejmenit, nenstacioni Lezhe Lot II Rikonstruksion I rrjetit ajror TM, rikonstruksion i tete kabinave dhe ndërtimi i dy kabinave shtyllore fidri 10 KV zeimen Nenstacioni b110/ KV Lezhe Vlera 36.988.563 leke pa TVSh. 4 AM 100% 1. Certifikatë marrje ne dorëzim 2. Faturat 3. Kontrate 4. Formular Vlerësimi 5. Akt kolaudimi 6. Situacion përfundimtar Nuk konsiderohet pune e ngjashme*
*NË ndryshim nga pretendimet e autoritetit kontraktor ne vlerësojmë se ky objekt ka ngjashmëri me kontratën objekt shqyrtimi. Punimet e kryera për këtë kontratë rezultojnë të jenë të ngjashme me procedurën objekt ankimimi si nga specifikimet teknike, nga kompleksiteti, metodologjia, teknologjia, zërat e punëve që do të bëhen etj. Situacionet e paraqitura dëshmojnë për kryerjen e punimeve edhe në nënstacion, fakt ky i cili ka lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me natyrën e kontratës që synon të realizojë autoriteti kontraktor në përfundim të procedurës së prokurimit objekt ankimimi. Zërat konkretë të punimeve të përshkruara në situacionet e paraqitura rezultojnë të kenë ngjashmëri me zërat e objektit të prokurimit dhe ky fakt është evident duke qenë se jem përpara dy kontratave të ngjashme nga natyra me njëra tjetrën. Konkretisht mund të përmendim zërat që kanë të bëjnë me:*
*- furnizim dhe shtrim kabulli TM dhe TU, furnizim vendosje terminalesh, prishje shtresa suvaje, punime gërmimi me krah dhe me ekskavator, punime suvatimi mur tulle dhe fasade, sherbetisje dhe bojatisje me gëlqere, konstruksione metalike, punim shtresa betoni, shtrese zhavorri, ulluk shkarkimi, FV tuba, mur tulle, hidroizolim, mbushje dhe rrafshim, transport materialesh pajisjesh dhe dherash, demontim pajisjesh dhe konstruksionesh ekzistuese, furnizim dhe instalim transformator fuqie, Autovinça 5 ton per ngritje dhe zbritje pajisje dhe materiale, elektroda tokëzimi, ndarës/shkeputes tokëzimi.*
*Nisur nga konstatimet sa më sipër operatori ekonomik ì4A-Më SHPK nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur ka provuar ngjashmërinë e punimeve midis këtij objekti dhe objektit të tenderit.*
*o IV. OSSH Elbasan me objekt: Rikonstruksion i rrjetit TU me kabull ABC ne Belsh si dhe kabinave gjatë rrugës kryesore Elbasan-Peqin Vlera 232.988.238 leke pa TVSh. Iliriada 40% dhe 4 AM 60% 1. Situacion perfundimtar 2. Kontrata 3. Kontrate bashkëpunimi+ Prokure 4. Ska tabelen e ndarjes se punimeve qe ka marre persiper te kryeje secili operator ekonomik. 5. Formular Vleresimi 6. Akt kolaudimi 7. Fatura 8. Certifikata e marrjes ne dorezim 9. Nuk konsiderohet pune ngjashme*

*o Lidhur me pretendimin e autoritetit kontraktor se për këtë kontratë nuk është paraqitur tabela e ndarjes së punimeve sqarojmë se kjo ndarje është bërë në tekstin e marrëveshjes së bashkëpunimit dhe konkretisht në nenin 3 të saj ku specifikohen zërat e marrë përsipër nga shoqëria "ILIRIADA" SHPK.*

*Ne ndryshim nga pretendimet e autoritetit kontraktor ne vlerësojmë se ky objekt ka ngjashmëri me kontratën objekt shqyrtimi. Punimet e kryera për këtë kontratë rezultojnë të jenë të ngjashme me procedurën objekt ankimimi si nga specifikimet teknike, nga kompleksiteti, metodologjia, teknologjia, zërat e punëve që do të bëhen etj. Situacionet e paraqitura dëshmojnë për kryerjen e punimeve edhe në Nënstacion, fakt ky i cili ka lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me natyrën e kontratës që synon të realizojë autoriteti kontraktor në përfundim të procedurës së prokurimit objekt ankimimi. Zërat konkretë të punimeve të përshkruara në situacionet e paraqitura rezultojnë të kenë ngjashmëri me zërat e objektit të prokurimit dhe ky fakt është evident duke qenë se jem përpara dy kontratave të ngjashme nga natyra me njëra tjetrën.*
*Konkretisht mund të përmendim zërat që kanë të bëjnë me:*
*- furnizim dhe shtrim kabulli TM dhe TU, furnizim vendosje terminalesh, prishje shtresa betoni, punime gërmimi me krah dhe me ekskavator, punim shtresa betoni, shtrese zhavorri, transport materialesh pajisjesh dhe dherash, demontim pajisjesh dhe konstruksionesh ekzistuese, Autovinça 5 ton per ngritje dhe zbritje pajisje dhe materiale.*
*Nisur nga konstatimet sa më sipër operatori ekonomik 4A-M SHPK nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur ka provuar ngjashmërinë e punimeve midis këtij objekti dhe objektit të tenderit.*

*o V. OSHE FIDERI me objekt: Zëvendësimi i rrjetit ekzistues 6 KV ne rrjet me tension 20KV te fiderit 248 N/stacioni Dinamo Vlera 72.881.602 leke pa TVSh. 4 AM 100% 1. Kontrate 2. Formular vlerësimi 3. Akt kolaudimi 4. Fature 5. Proces verbal marrje ne dorëzim 6. Situacion perfundimtar Nuk konsiderohet pune e ngjashme*
*NË ndryshim nga pretendimet e autoritetit kontraktor ne vlerësojmë se ky objekt ka ngjashmëri me kontratën objekt shqyrtimi. Punimet e kryera për këtë kontratë rezultojnë të jenë të ngjashme me procedurën objekt ankimimi si nga specifikimet teknike, nga kompleksiteti, metodologjia, teknologjia, zërat e punëve që do të bëhen etj. Situacionet e paraqitura dëshmojnë për kryerjen e punimeve edhe në Nënstacion, fakt ky i cili ka lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me natyrën e kontratës që synon të realizojë autoriteti kontraktor në përfundim të procedurës së prokurimit objekt ankimimi. Zërat konkretë të punimeve të përshkruara në situacionet e paraqitura rezultojnë të kenë ngjashmëri me zërat e objektit të prokurimit dhe ky fakt është evident duke qenë se jemi përpara dy kontratave të ngjashme nga natyra me njëra tjetrën. Konkretisht mund të përmendim zërat që kanë të bëjnë me:*
*- furnizim dhe shtrim kabulli TM dhe TU, furnizim vendosje terminalesh, prishje shtresa suvaje, punime gërmimi me krah dhe me ekskavator, punime suvatimi mur tulle dhe fasade, sherbetisje dhe bojatisje me gëlqere, rrethim me rrjete teli, punim shtresa betoni, shtrese zhavorri, FV hekur beton, FV tuba, mur tulle, dyer metalike, hidroizolim, mbushje dhe rrafshim, transport materialesh pajisjesh dhe dherash, demontim pajisjesh dhe konstruksionesh ekzistuese, furnizim dhe instalim transformator fuqie, Autovinç 5 ton per ngritje dhe zbritje pajisje dhe materiale, elektroda tokëzimi, ndarës/shkeputes tokezimi.*

*o VI. OSSH BURREL me objekt: Rikonstruksion i rrjetit TU A.B.C dhe ndërtimin e kabinave shtyllore, ne Agjencine Bulqize Drejtoria Rajonale Burrel Vlera 110.153.870,78 leke pa*

*TVSh. 4 AM 100% 1. Kontrate 2. Formular Vleresimi 3. Akt Kolaudimi 4. Situacion Perfundimtar 5. Fatura 6. Proces Verbal marrje ne dorëzim Nuk konsiderohet pune e ngjashme.*
*NË ndryshim nga pretendimet e autoritetit kontraktor ne vlerësojmë se ky objekt ka ngjashmëri me kontratën objekt shqyrtimi. Punimet e kryera për këtë kontratë rezultojnë të jenë të ngjashme me procedurën objekt ankimimi si nga specifikimet teknike, nga kompleksiteti, metodologjia, teknologjia, zërat e punëve që do të bëhen etj. Situacionet e paraqitura dëshmojnë për kryerjen e punimeve edhe në Nënstacion, fakt ky i cili ka lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me natyrën e kontratës që synon të realizojë autoriteti kontraktor në përfundim të procedurës së prokurimit objekt ankimimi. Zërat konkretë të punimeve të përshkruara në situacionet e paraqitura rezultojnë të kenë ngjashmëri me zërat e objektit të prokurimit dhe ky fakt është evident duke qenë se jem përpara dy kontratave të ngjashme nga natyra me njëra tjetrën. Konkretisht mund të përmendim zërat që kanë të bëjnë me:*
*- furnizim dhe shtrim kabulli TM dhe TU, furnizim vendosje terminalesh, punime gërmimi me krah dhe me ekskavator, punim shtresa betoni, FV tuba, transport materialesh pajisjesh dhe dherash, demontim pajisjesh dhe konstruksionesh ekzistuese, furnizim dhe instalim transformator, Autovinça 5 ton per ngritje dhe zbritje pajisje dhe materiale, elektroda tokëzimi, ndarës/shkeputes tokezimi,*

*o V. OSSH KINOSTUDIO me objekt: Kthim ne 20 kv i nje pjese te fiderit 126 Nenstacioni Kinostudio, Tirane Vlera 180.467.986,78 leke pa TVSh 4 AM 100% 1. Kontrate 2. Formular vlerësimi 3. Akt Kolaudimi 4. Situacion perfundimtar 5. Fatura 6. Certifikate marrje ne dorezim Nuk konsiderohet pune e ngjashme*
*NË ndryshim nga pretendimet e autoritetit kontraktor ne vlerësojmë se ky objekt ka ngjashmëri me kontratën objekt shqyrtimi. Punimet e kryera për këtë kontratë rezultojnë të jenë të ngjashme me procedurën objekt ankimimi si nga specifikimet teknike, nga kompleksiteti, metodologjia, teknologjia, zërat e punëve që do të bëhen etj. Situacionet e paraqitura dëshmojnë për kryerjen e punimeve edhe në Nënstacion, fakt ky i cili ka lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me natyrën e kontratës që synon të realizojë autoriteti kontraktor në përfundim të procedurës së prokurimit objekt ankimimi. Zërat konkretë të punimeve të përshkruara në situacionet e paraqitura rezultojnë të kenë ngjashmëri me zërat e objektit të prokurimit dhe ky fakt është evident duke qenë se jem përpara dy kontratave të ngjashme nga natyra me njëra tjetrën. Konkretisht mund të përmendim zërat që kanë të bëjnë me:*
*- furnizim dhe shtrim kabulli TM dhe TU, furnizim vendosje terminalesh, punime gërmimi me krah dhe me ekskavator, punim shtresa betoni, shtrese zhavorri, FV hekur beton, FV tuba, mbushje dhe rrafshim, transport materialesh pajisjesh dhe dherash, furnizim dhe instalim transformator fuqie, Autovinç 5 ton per ngritje dhe zbritje pajisje dhe materiale, elektroda tokëzimi, ndarës/shkeputes tokezimi.*

*o VII. LINJA 110 KV me objekt: Realizimin e punimeve civile ne nenstacionin 110 KV. Vlera 61.460.882,5 leke pa TVSh. Vlera shtese 195.100.600 leke pa TVSh. 4 AM 100 % 1. Formular vlerësimi kontrate baze 2. Akt kolaudimi baze 3. Kontrata baze 4. Situacion*

*perfundimtar 5. Faturat per kontraten baze Nuk ka certifikate te marrjes ne dorëzim as per bazën as per shtesën Nuk plotëson dokumentacionin*
*Për këtë kontratë shoqëria 4A-Më SHPK ka dorëzuar:*
*1. Formular vlerësimi total per kontraten baze dhe kontratën shtese si dhe formular vleresimi per kontratën baze*
*2. Akt kolaudimi per kontratën baze dhe për kontratën shtese*
*3. Kontrata baze + kontratën shtese*
*4. Situacion perfundimtar per kontratën baze dhe kontratën shtese*
*5. Faturat për kontratën baze dhe kontratën shtese*
*Pra, janë dorëzuar te gjitha dokumentet e kërkuara ne DST. Gjithashtu theksojmë se certifikata e marrjes në dorëzim nuk është kërkese për tu dorëzuar sipas kritereve të tenderit për kontratat e realizuara me sektorin privat.*
*Ky objekt ka ngjashmëri me kontratën objekt shqyrtimi. Punimet e kryera për këtë kontratë rezultojnë të jenë të ngjashme me procedurën objekt ankimimi si nga specifikimet teknike, nga kompleksiteti, metodologjia, teknologjia, zërat e punëve që do të bëhen etj. Situacionet e paraqitura dëshmojnë për kryerjen e punimeve edhe në Nënstacion, fakt ky i cili ka lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me natyrën e kontratës që synon të realizojë autoriteti kontraktor në përfundim të procedurës së prokurimit objekt ankimimi. Zërat konkretë të punimeve të përshkruara në situacionet e paraqitura kanë ngjashmëri me zërat e objektit të prokurimit dhe ky fakt është evident duke qenë se jem përpara dy kontratave të ngjashme nga natyra me njëra tjetrën.*

*o VIII. OSHE RRASHBULL me objekt: Zgjatimi i rrjetit 20 kv nga F.53 Nst shkozet dhe ndertimi i kabinave te reja d rrjetit TU per zonen kantina e veres, tuneli i trenit, laboratori Rrashbull Vlera 93.426.914 leke pa TVSh. 4 AM 100 % 1. Formular vleresimi 2. Akt kolaudimi 3. Kontrata 4. Situacion perfundimtar 5. Faturat 6. Ka nje vertetim per permbushjen e kushteve te garancise Nuk ka certifikatë te marrjes ne dorezim Nuk konsiderohet pune e ngjashme*
*1. Lidhur me mungesën e certifikatës se Marrjes ne Dorëzime, sqarojmë se shoqeria ì4A-Më SHPK ka dorëzuar dokumentin vërtetim për përmbushje te garancisë së punimeve i cili është ekuaivalent i certifikatës se Marrjes ne Dorëzime pasi përmban te gjitha të dhënat e nevojshme dhe specifikon se ky dokument është nënshkruar nga grupi i marrjes përfundimtare në dorëzime. Pra, vertetimi per përmbushje te garancisë së punimeve është dokumenti që lëshohet nga OSHEE Durrës për marrjen përfundimtare në dorëzim të objekteve të ndërtuara. Për këtë arsye, pretendimi i Autoritetit Kontraktor se për këtë kontratë nuk ka certifikatës te Marrjes ne Dorëzime është i pabazë.*

*2. NË ndryshim nga pretendimet e autoritetit kontraktor ne vlerësojmë se ky objekt ka ngjashmëri me kontratën objekt shqyrtimi. Punimet e kryera për këtë kontratë rezultojnë të jenë të ngjashme me procedurën objekt ankimimi si nga specifikimet teknike, nga kompleksiteti, metodologjia, teknologjia, zërat e punëve që do të bëhen etj. Situacionet e paraqitura dëshmojnë për kryerjen e punimeve edhe në Nënstacion, fakt ky i cili ka lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me natyrën e kontratës që synon të realizojë autoriteti kontraktor në përfundim të procedurës së prokurimit objekt ankimimi. Zërat konkretë të*

*punimeve të përshkruara në situacionet e paraqitura rezultojnë të kenë ngjashmëri me zërat e objektit të prokurimit dhe ky fakt është evident duke qenë se jemi përpara dy kontratave të ngjashme nga natyra me njëra tjetrën.*
*Konkretisht mund të përmendim zërat që kanë të bëjnë me:*
*- furnizim dhe shtrim kabulli TM dhe TU, furnizim vendosje terminalesh, prishje shtresa suvaje, punime gërmimi me krah dhe me ekskavator, punime suvatimi mur tulle dhe fasade, sherbetisje dhe bojatisje me gëlqere, rrethim me rrjete teli, punim shtresa betoni, shtrese zhavorri, FV hekur beton, FV tuba, mur tulle, dyer metalike, hidroizolim, mbushje dhe rrafshim, transport materialesh pajisjesh dhe dherash, demontim pajisjesh dhe konstruksionesh ekzistuese, furnizim dhe instalim transformator fuqie, Autovinç 5 ton per ngritje dhe zbritje pajisje dhe materiale, elektroda tokëzimi.*

*o IX. OST Cerrik me objekt : Ndertimi i Linjes se re 110 KV nje qark Cerrik-Kajan-Kucove-Jagodine dhe rehabilitimi i trakteve dalese te linjave 110 KV te N/Stacioneve Cërrik dhe Kuçovë Vlera 570.250.000 leke pa TVSh. 4 AM 98 % dhe Bonus 2% 1. MB + Prokure + tabela e ndarjes se punimeve 2. Akt kolaudimi 3. Kontrata 4. Situacion perfundimtar 5. Faturat 6. Certifikate marrje ne dorëzim 7. Ska Formular vleresimi Nuk plotëson dokumentacionin Referuar kërkesave te kritereve te veçanta shoqëria 4A-Më SHPK ka paraqitur dokumentacion te plote duke paraqitur vërtetime të lëshuara nga autoriteti kontraktor ku provohet permbushja me sukses e kontratës, vlera e kontratës dhe afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë. Lidhur me mungesën e Formularit te Vlerësimit sqarojmë se autoriteti kontraktor OST SHA e lëshon këtë dokument vetëm pas përfundimit të garancisë së defekteve e cila nuk ka përfunduar ende për këtë kontratë. Shoqëria ì4A-Më SHPK ka kërkuar kopje të këtij formulari mej shkresën nr. 103 Prot datë 16.03.2023 dhe si përgjigje ka marrë shkresën nr. 1590/1 prot datë 21.03.2023 ku konstatohet përfundimi i punimeve brenda afatit dhe vlera totale e punimeve të kryera. Dokumentet e paraqitura provojnë plotësisht punën e kryer për këtë kontratë ku vërtetohet janë të ngjashme me procedurën objekt ankimimi si nga specifikimet teknike, nga kompleksiteti, metodologjia, teknologjia, zërat e punëve që do të bëhen etj. Situacionet e paraqitura dëshmojnë për kryerjen e punimeve në Nënstacion, fakt ky i cili ka lidhje të drejtpërdrejtë me natyrën e kontratës që synon të realizojë autoriteti kontraktor në përfundim të procedurës së prokurimit objekt ankimimi. Zërat konkretë të punimeve të përshkruara në situacionet e paraqitura kanë ngjashmëri me zërat e objektit të prokurimit dhe ky fakt është evident duke qenë se jem përpara dy kontratave të ngjashme nga natyra me njëra tjetrën.*

*o X. Godina RSU Tirane me objekt: Ndertim i godines tip RSU Nr. 3 Vlera 305.946.636, leke pa TVSh 4 AM 100% 1. Kontrata 2. Formular vlerësimi 3. Akt Kolaudimi 4. Situacion perfundimtar 5. Fature 6. Certifikate marrje ne dorezim ploteson dokumentacionin Nuk konsiderohet pune e ngjashme*
*NË ndryshim nga pretendimet e autoritetit kontraktor ne vlerësojmë se ky objekt ka ngjashmëri me kontratën objekt shqyrtimi. Punimet e kryera për këtë kontratë rezultojnë të jenë të ngjashme me procedurën objekt ankimimi si nga specifikimet teknike, nga kompleksiteti, metodologjia, teknologjia, zërat e punëve që do të bëhen etj. Situacionet e paraqitura dëshmojnë për kryerjen e punimeve ndërtimore te lidhura me punimet ne godinen*

*e nenstacionit, fakt ky i cili ka lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me natyrën e kontratës që synon të realizojë autoriteti kontraktor në përfundim të procedurës së prokurimit objekt ankimimi. Zërat konkretë të punimeve të përshkruara në situacionet e paraqitura rezultojnë të kenë ngjashmëri me zërat e objektit të prokurimit dhe ky fakt është evident duke qenë se jem përpara dy kontratave të ngjashme nga natyra me njëra tjetrën.*
*Konkretisht mund të përmendim zërat që kanë të bëjnë me punimet ne ndërtesën e re dhe ekzistuese:*
*- Punime gërmimi, mbushje rrafshim, transport dheu dhe materialesh, mbushje me zhavorr, shtrese betoni, mure tulle, kolona betoni, hidroizolim, FV hekur betoni, soleta, suvatim fasade, punime per tarracat, punime fasade, punime shtresash dhe vesheje, shtresa me pllaka, punime dyer dhe dritare, sistemime te jashtme, punime elektrike dhe mekanike brenda godinës, sistem ngrohje-ftohje HVAC, sistem monitorimi me kamera. Punimet ndërtimore lidhur me ndërtesën e re dhe ekzistuese përbëjnë mbi 10% të vlerës së objektit te prokurimit.*

*o XI. OSHE Lezhe: Rikonstruksion i rrjetit elektrik TM TU ne qytetin Lezhe Vlera 136.885.517 leke pa TVSh 4 AM 100% 1. Kontrata 2. Formular vlerësimi 3. Akt Kolaudimi 4. Situacion perfundimtar 5. Fature 6. Certifikate marrie ne dorezim Nuk konsiderohet pune e ngjashme*
*NË ndryshim nga pretendimet e autoritetit kontraktor ne vlerësojmë se ky objekt ka ngjashmëri me kontratën objekt shqyrtimi. Punimet e kryera për këtë kontratë rezultojnë të jenë të ngjashme me procedurën objekt ankimimi si nga specifikimet teknike, nga kompleksiteti, metodologjia, teknologjia, zërat e punëve që do të bëhen etj. Situacionet e paraqitura dëshmojnë për kryerjen e punimeve që kanë lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me natyrën e kontratës që synon të realizojë autoriteti kontraktor në përfundim të procedurës së prokurimit objekt ankimimi. Zërat konkretë të punimeve të përshkruara në situacionet e paraqitura rezultojnë të kenë ngjashmëri me zërat e objektit të prokurimit dhe ky fakt është evident duke qenë se jem përpara dy kontratave të ngjashme nga natyra me njëra tjetrën.*
*Konkretisht mund të përmendim zërat që kanë të bëjnë me:*
*- furnizim dhe shtrim kabulli TM dhe TU, furnizim vendosje terminalesh, prishje shtresa suvaje, punime gërmimi me krah dhe me ekskavator, punime suvatimi mur tulle dhe fasade, sherbetisje dhe bojatisje me gëlqere, punim shtresa betoni, shtrese zhavorri, FV hekur beton, FV tuba, mur tulle, konstruksione metalike, mbushje dhe rrafshim, transport materialesh pajisjesh dhe dherash, demontim pajisjesh dhe konstruksionesh ekzistuese, furnizim dhe instalim transformator fuqie, Autovinç 5 ton per ngritje dhe zbritje pajisje dhe materiale, elektroda tokëzimi, ndarës dhe shkarkues, ndriçim elektrik, kolaudim cela dhe transformator.*

*o XII. OSHE KOMBINAT: Rrjeti 20KV i fiderave T16, T17, T18. T19 nga nenstacioni I ri 110/20 KV Kombinat si dhe rrjeti TU me kabllo me vetembajtje tip ABC ne kabinat e tyre Tirane. Vlera 155.913.305 leke pa TVSh 4 AM 100% 1. Kontrata 2. Formular vleresimi 3. Akt Kolaudim 4. Situacion perfundimtar 5. Fature 6. Certifikate marrje ne dorezim Nuk konsiderohet pune e ngjashme*
*NË ndryshim nga pretendimet e autoritetit kontraktor ne vlerësojmë se ky objekt ka ngjashmëri me kontratën objekt shqyrtimi. Punimet e kryera për këtë kontratë rezultojnë të*

*jenë të ngjashme me procedurën objekt ankimimi si nga specifikimet teknike, nga kompleksiteti, metodologjia, teknologjia, zërat e punëve që do të bëhen etj. Situacionet e paraqitura dëshmojnë për kryerjen e punimeve që kanë lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me natyrën e kontratës që synon të realizojë autoriteti kontraktor në përfundim të procedurës së prokurimit objekt ankimimi. Zërat konkretë të punimeve të përshkruara në situacionet e paraqitura rezultojnë të kenë ngjashmëri me zërat e objektit të prokurimit dhe ky fakt është evident duke qenë se jemi përpara dy kontratave të ngjashme nga natyra me njëra tjetrën.*

*Konkretisht mund të përmendim zërat që kanë të bëjnë me:*

*- punime gërmimi me krah dhe me ekskavator, punim shtresa betoni, shtrese zhavorri, FV hekur beton, FV tuba, konstruksione metalike, mbushje dhe rrafshim, transport materialesh pajisjesh dhe dherash, furnizim dhe instalim transformator fuqie, Autovinç 5 ton per ngritje dhe zbritje pajisje dhe materiale, elektroda tokëzimi, ndarës dhe shkarkues, kolaudim cela dhe transformator.*

*o XIII. OSSH Durrës: Ndërtimi i rrjetit TM 20 KV, Fideri F6, kabinave perkatese dhe rrjetit TU me percjelles ABC, N/ST Gjiri i Lalzit, Loti II. Vera 159.477.902,27 leke TVSh 4AM 95% dhe Iliriada 5% 1. Situacion përfundimtar 2. Kontrata Kontrate bashkëpunimi+ Prokure 4. Ska tabelen e ndarjes se punimeve qe ka marre persiper te kryeje secili operator ekonomik. 5. Formular Vleresimi 6. Akt kolaudimi 7. Fatura 8. Certifikata e marrjes ne dorëzim Nuk konsiderohet pune e ngjashme*

*1. Lidhur me pretendimin e autoritetit kontraktor se për këtë kontratë nuk është paraqitur tabela e ndarjes së punimeve sqarojmë se kjo ndarje është bërë në tekstin e marrëveshjes së bashkëpunimit dhe konkretisht në nenin 3 të saj ku specifikohen zërat e marrë përsipër nga shoqëria "ILIRIADA" SHPK.*

*2. NË ndryshim nga pretendimet e autoritetit kontraktor ne vlerësojmë se ky objekt ka ngjashmëri me kontratën objekt shqyrtimi. Punimet e kryera për këtë kontratë rezultojnë të jenë të ngjashme me procedurën objekt ankimimi si nga specifikimet teknike, nga kompleksiteti, metodologjia, teknologjia, zërat e punëve që do të bëhen etj. Situacionet e paraqitura dëshmojnë për kryerjen e punimeve që kanë lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me natyrën e kontratës që synon të realizojë autoriteti kontraktor në përfundim të procedurës së prokurimit objekt ankimimi. Zërat konkretë të punimeve të përshkruara në situacionet e paraqitura rezultojnë të kenë ngjashmëri me zërat e objektit të prokurimit dhe ky fakt është evident duke qenë se jemi përpara dy kontratave të ngjashme nga natyra me njëra tjetrën.*

*Konkretisht mund të përmendim zërat që kanë të bëjnë me:*

*- furnizim dhe shtrim kabulli TM dhe TU, furnizim vendosje terminalesh, punime gërmimi me krah dhe me ekskavator, punim shtresa betoni, shtrese zhavorri, FV tuba, konstruksione metalike, mbushje dhe rrafshim, transport materialesh pajisjesh dhe dherash, demontim pajisjesh dhe konstruksionesh ekzistuese, furnizim dhe instalim transformator fuqie, Autovinç 5 ton per ngritje dhe zbritje pajisje dhe materiale, elektroda tokëzimi, ndarës dhe shkarkues, kolaudim cela dhe transformator.*

*o XIV. DTL Nenstacioni Vore: Rikonstruksion i N/Stacionit Vorës 35/20/6 KV Vlera 208.993.280.01 leke pa TVSh Vera e modifikimit te kontratës 8.457.007 leke pa TVSh 4AM 100% 1. Kontrata 2. Formular vlerësimi 3. Akt Kolaudimi 4. Situacion përfundimtar 5. Fature 6. Certifikate marre ne dorëzim Shoqëria 4A-M SHPK ka dorëzuar të gjitha dokumentacionin e kërkuar sipas kritereve të tenderit.*

*Pra, referuar legjislacionit të prokurimit publik mjafton që operatorët të paraqesin dokumente ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, të cilat janë dorëzuar nga shoqëria 4A-M SHPK.*
*Punimet e kryera për këtë kontratë janë të ngjashme me procedurën objekt ankimimi si nga specifikimet teknike, nga kompleksiteti, metodologjia, teknologjia, zërat e punëve që do të bëhen etj. Situacionet e paraqitura dëshmojnë për kryerjen e punimeve në Nënstacion, fakt ky i cili ka lidhje të drejtpërdrejtë me natyrën e kontratës që synon të realizojë autoriteti kontraktor në përfundim të procedurës së prokurimit objekt ankimimi. Zërat konkretë të punimeve të përshkruara në situacionet e paraqitura rezultojnë të kenë ngjashmëri me zërat e objektit të prokurimit dhe ky fakt është evident duke qenë se jem përpara dy kontratave të ngjashme nga natyra me njëra tjetrën.*
*Për sa më sipër, shoqëria 4A-M SHPK plotëson kriterin kualifikues lidhur me kontratat e ngjashme si nga natyre e punimeve ashtu edhe ne vlerën totale e cila është 2,533,879,021 LEKE pa TVSH. Kjo vlere është 4 here me e madhe se vlera e fondit limit duke tejkaluar kështu kërkesat e dokumenteve të tenderit".*

II.5.2. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 "Për prokurimin Publik" Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr. 2403/2 prot., datë 03.10.2023 lidhur me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik "4 A-M" SHPK kundërshton me anë të ankimit elektronik me nr. A/2023/3458, dhe me numër protokolli 2403/2023, datë 02.10.2023.

II.5.3. Në datën 04.10.2023, operatori ekonomik "4 A-M" SHPK, ka dorëzuar në protokoll, dokumentacion në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar, në formë CD., të protokolluar me nr. 2403/3 prot., datë 04.10.2023.

II.5.4. Nëpërmjet shkresës me nr. 760/27 prot., datë 09.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 2403/4 prot., datë 10.10.2023 me objekt "*Dërgim dokumentacioni*", është depozituar nga autoriteti kontraktor shkresa (nr. 760/25 prot., datë 09.10.2023) e "Kthimit të përgjigjes" së trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet se e ka refuzuar atë.

II.5.5. Me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 115 të LPP-së, në datën 25.10.2023 Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua me shkresën me nr. 2403/5 prot., datë 25.10.2023, autoritetit kontraktor, që të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i

shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, si dhe të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik “4 A-M” SHPK dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “ENBI POWER” SHPK & “Aci Enginnering” SHPK.

II.5.6. Nëpërmjet shkresës me nr. 760/30 prot., datë 27.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 2403/6 prot., datë 30.10.2023, me objekt “*Kthim-përgjigje tuajës nr.2403/5 prot., datë 25.10.2023*”, është depozituar nga autoriteti kontraktor akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues“4 A-M” SHPK, ku konstatohet, se e ka refuzuar atë.

II.6. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “ENBI POWER” SHPK & “Aci Enginnering” SHPK rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për arsyet si më poshtë:

*“• Në pikën 2/1/a të kritereve të veçanta është kërkuar: ‘’Ofertuesi duhet të paraqesë: Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8’’.*

*Referuar nenit 84/3 dhe 84/4 të LPP dhe nenit 90/2 të VKM nr. 285, detyrimin e paraqitjes së këtij formulari e kanë edhe subjektet mbështetëse të një ofertuesi në një procedurë prokurimi. Kjo gjë është specifikuar edhe në kriteret e përgjithshme të pranimit, ku është cilësuar se ‘’ Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.*
*Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur. Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës’’.*
*Në rastin konkret, BOE “Aci engineering” ShPK & ENBI POWER kanë deklaruar 2 subjekte mbështetës (AM RENTALS dhe Mimoza Gjani), por për asnjë prej tyre nuk është paraqitur shtojca nr. 8, për të vërtetuar plotësimin e nenit 84/4 të LPP dhe nenit 90/2 të VKM nr. 285.*

*• Në kriteret të veçanta është kërkuar: Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim të prodhuesit/Distributorit të autorizuar.*
*Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.*
*a) Shënim: Operatori ekonomik /Bashkimi i operatorëve, duhet të ofertojë vetëm me një prodhues për secilin artikull, rastet kur paraqiten autorizime nga dy ose më shumë prodhues për të njëjtin artikull, përbëjnë objekt skualifikimi.*
*b) Autorizimi i prodhuesit duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe.*

*Referuar ndarjes së punimeve në marrëveshjen e bashkëpunimit, subjekti “Aci engineering” ShPK ka marrë përsipër 100% të furnizimit me cela 12 KV dhe Cela të brendshme TM 40 5KV dhe duhet të kishte paraqitur autorizim prodhuesi për këto mallra, por autorizimi i kompanisë Schneider elektrik është lëshuar për Enbi Power, në kundërshtim me nenin 88/3 të VKM NR. 285 ku parashikohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato*

*teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje'.*

*• Në kriteret të veçanta është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij ose me kontratë shërbimi të paktën 1 (Një) Inxhinier Elektrik të certifikuar nga (prodhuesi ose ekuivalentët) për instalimin dhe komisionin e pajisjeve diagnostifikuese, analizuese të gazrave DGA (të Transformatorët e fuqisë), i cili do të realizoje këtë shërbim.*
*Për të provuar plotesimin e këtij kushti duhet të paraqitet:*
*- Kontrata e punës*
*- Diplomë, CV*
*- Librezat e punës*
*- Certifikata përkatëse e Inxhinierit Elektrik të certifikuar nga prodhuesi ose ekuivalente i pajisjeve DGA (Diagnostifikim, Analizim i Gazrave të Transformatorët e fuqisë).*
*- Listepagesat E-sig 25 ku të jenë te pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë për një periudhë 3 muajsh nga dita e shpalljes se tenderit.*

*Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8. Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*
*ENBI POWER ka deklaruar një inxhinier kinez të shoqërisë prodhuese, ndërkohe duhet ta kishte staf të vetin dhe dokumentacioni shoqërues,*

*Kontratat ACI INGEENERING*
*Shuma aritmetike e kontratave të ngjashme nuk përmbush vlerën në 18.2% të dyfishit të fondit limit.*

*KONTRATAT ENBI*
*I. K4_12 NENSTACIONET 62%*
*1. Certifikate përfundimi*
*2. Faturat*
*3. Situacione nuk ka, ka fatura blerje dhe konfigurimi, projektimi (Ska ndërtim duhet parë në zëra nëse konsiderohet kontratë e ngjashme teknikisht).*
*4. Marrëveshja e bashkëpunimit e papërkthyer dhe nuk ka ndarjen e zërave që merr përsipër të realizojë secili operator ekonomik*
*5. Kontratë*
*6. Akt kolaudimi*
*7. Ka vërtetim realizimi kontrate jo formular vlerësimi se nuk është kontratë pune*

*II. K 7- Fuqizimi i traktit të ri TR-4 NST 110/20 kv 1x20/25 MVA Plasmas Lushnje*
*1. Situacion përfundimtar e ka me objekt Fuqizimi i traktit të ri TR-4 NST 110/20 kv 1x20/25 MVA Plasmas Lushnje*
*2. Proces verbal marrje në dorëzim objektin e ka Rikonstruksion i nënstacionit plasmas 110/35/20/6 KV pra ska përputhje me objektin tek situacionet*

*3. Faturat*
*4. Akt kolaudimi*
*5. Kontrata*
*6. Ska formular vlerësimi*

*III. K-3 Nënstacioni Sallmone-Gjiri i Lalzit (ENBI&ONYX)*
*1. Situacion përfundimtar*
*2. Ka vërtetim realizimi jo formular vlerësimi sipas standardit sikundër kërkuar*
*3. Faturat*
*4. Akt kolaudimi*
*5. Kontratë*
*6. Ka Marrëveshje bashkëpunimi dhe prokurë por nuk ka tabelën e ndarjes së punëve*
*7. Certifikatë marrje në dorëzim*

*Vlera e realizuar nga ENBI POWER 156.268.465 lekë pa TVSh IV.*
*K-8 Kolektori kabllor 20 kv kombinat*
*1. Certifikatë marrje në dorëzim*
*2. Ka paraqitur vetëm një faturë tatimore në vlerë 3.548.729 lekë pa TVSh*
*3. Kontrata*
*4. Akt kolaudimi*
*5. Vërtetim për përmbushjen e kushteve të garancisë*
*6. Ska formular vlerësimi*
*7. Ska situacion përfundimtar*

*V. K-5 Rikonstruksion dhe fuqizim nënstacioni Selitë (kontrata furnizim malli)*
*1. Situacion përfundimtar*
*2. Fatura*
*3. Akt Kolaudimi*
*4. Kontrata*
*5. Certifikatë e pranimit të mallit*
*6. Ska formular vlerësimi as vërtetim realizimi të lëshuar nga autoriteti kontraktor*

*VI. K-1 Dizajnimi furnizimi dhe instalimi i nënstacionit 110.20kv kombinat (ENBI&JACOBSON) 60%*
*1. Kontrata*
*2. Certifikatë marrje në dorëzim*
*3. Formular Vlerësimi*
*4. Situacion përfundimtar*
*5. Ka marrëveshje bashkëpunimi dhe prokurën e posaçme por nuk ka paraqitur tabelën e ndarjes së punimeve që ka marrë përsipër të realizojë secili operator*
*6. Akt kolaudimi*
*7. Fatura ka vetëm një faturë për situacionin përfundimtar*

*VII. K-9 Sallmone Loti I (ENBI&ALKOIMPEX) 63%*

*1. Marrëveshje bashkëpunimi dhe tabelën e ndarjes së punëve dhe prokurë*
*2. Situacion përfundimtar*
*3. Faturat*
*4. Kontrata*
*5. Ska formular vlerësimi*
*6. Ska certifikatë marrje në dorëzim të punimeve*
*7. Ska akt kolaudimi*

*VIII. K-6 Nënstacioni Himara*
*1. Akt kolaudimi*
*2. Certifikatë e marrjes në dorëzim të objektit ska firmë mbikqyrësi.*
*3. Fatura*
*4. Kontrata*
*5. Situacion përfundimtar*
*6. Ska formular vlerësimi*

*IX. K2-OST Rehabilitim i impiantit 110 KV RUBIK*
*1. Faturat tatimore*
*2. Kontrata*
*3. Akt Kolaudimi*
*4. Certifikatë marrje në dorëzim të punimeve*
*5. Situacion përfundimtar*
*6. Ka vërtetim realizimi ska formular vlerësimi sikundër kërkuar në dst*

*2. Duhen formularët e vlerësimit për subjektet mbështetëse të cilët nuk janë ngarkuar në dokumentet e tenderit.*

*3. Nuk ka teknikun e ndërtimit të deklaruar në shtojcën 8 për asnjë nga operatorët ekonomikë.*

*4.Mjeku është kërkuar në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë të paraqitet nga të dy anëtarët e bashkimit dhe nga OE ACI nuk ka paraqitur në vetedeklarim mjekun e shoqërisë".*

II.6.1. Në datën 03.10.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3462 dhe me nr. 2425/2023 prot., datë 03.10.2023, e bashkimit të operatorëve ekonomikë "ENBI POWER" SHPK & "Aci Enginnering" SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "ENBI POWER" SHPK & "Aci Enginnering" SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Pretendimet janë si më poshtë vijon:

“*Argumente mbi shkeljet e pretenduara 1. Autoriteti kontraktor ka parashtruar si arsye per refuzim: ì Ne piken 2/1/a te kritereve te veçantë është kërkuar: Ofertuesi duhet te paraqesë : Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit, sipas shtojces 8 Referuar nenit 84/3 dhe 84/4 te LPP dhe nenit 90/2 te VKM nr, 285, detyrimin e paraqitjes se ketij formulari e kane edhe subjektet mbeshtetese te nje ofertuesi ne nje procedure prokurimi. Kjo gje eshte specifikuar edhe ne kriteret e pergjithshme te pranimit, ku eshte cilesuar se Keto kritere duhet te permbushen me paraqitjen e Formularit Permbledhes te Vetedeklarimit te operatorit ekonomik ne diten e hapjes se Ofertes, sipas Shtojces 8. Ne rast te bashkimit te operatoreve ekonomike, secili anetar i grupit duhet te paraqese Vetedeklarimin e lartpermendur. Ne rast se, operatori ekonomik ofertues do te mbeshtetet ne kapacitetet e subjekteve te tjera, vetdeklarimi i lartpermendur duhet te paraqitet edhe nga subjekti mbeshtetes Ne rastin konkret, BOE 'Aci engineering Shpk & ENBI POWER kane deklaruar 2 subjekte mbeshtetes (AM RENTALS dhe Mimoza Gjani), por per asnje prej tyre nuk eshte paraqitur shtojca nr. 8 , per te vertetuar plotesimin e nenit 84/4 te LPP dhe nenit 90/2 te VKM nr, 285.*

*Ne konsiderojme qe kjo pike nuk perben pike per refuzim: Se pari : Referuar LPP Neni 84/3 qe eshte marre si baze edhe nga AK, ky nen parashikon: ìKur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim Argument: BOE ka ngarkuar ne tender, letrat e Angazhimit per secilin nga subjektet AM RENTALS dhe Mimoza Gjani jane pjese e dosjes se tenderit. Pra kry kriter eshte plotesuar. Bashkelidhur dokumenti mbeshtetes me Nr. 1. Shtojca 8 e te dy anetareve te BOE, e ngarkuar ne tender. Se dyti: Referuar LPP Neni 84/4, citon: ìAutoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet ti kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit Ky nen I LPP per percaktimin e menyre se provueshmerise si kuptim zgjerohet me tej ne vendimin Nr. 285, datë 19.5.2021 ìPËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK ku percaktohet si me poshte: Neni 90 Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjerë, ì2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ti provoje autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.*

*Argument: Sa me siper Operatori ekonomik qe deshiron te mbeshtetet ne kapacitet e subjekteve te tjera duhet ti provoje autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së. Kjo është paraqitur ne Vetedeklarimin e Vete Operatoreve Ekonomik Enbi Power ShPK dhe ACI Engineerin ne Vetdeklarimet e tyre sipas shtojces 8 te paraqitur ne tender. Vetedeklarimi Shtojca 8, pika B. Pra BOE sipas kerkesave te Nenit 90/2 i ka provuar autoritetit kontratkor ne vetdeklarimin e tyre sipas shtojces 8 qe subjektet aftesine e te cileve po shfrytezojne nuk nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin.*

*Se treti: VKM 285, datë 19.5.2021 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, Neni 26 Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, pika 1 citon: Bashkë me*

*dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetë deklarimit, sipas përcaktimit ne nenin 82, te LPP-së, dhe ne këto rregulla Pika 3 citon, Ne çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet ti kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetë deklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Gjithashtu pika 7 sqaron: Ne çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose ti kërkoje operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime Argument: BOE Enbi Power ShPK & ACI Engineering kane dorezuar Shtojcen 8 formularin e Vetdelarimit ku ne baze te nenit 84/4 LPP dhe nenit 90 VKM 285 është provuar plotësimi i kriterit se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së. Ne çdo rast Autoriteti kontraktor kishte detyrimin qe te kerkonte dorezimin e dokumenteve provuese per deklarimin e bere ne formularin permbledhes sipas shtojces 8. Gjithashtu, Autoriteti Kontraktor sipas pikes 7 ka te drejte te beje vete verifikimet e nevojshme apo te kerkoje sqarime. Theksojme ketu qe kemi marre nje kerkese per sqarim nga autoriteti kontraktor ne kete procedure dhe nuk eshte kerkuar asnje sqarim per kete pike qe tani AK e perdor si arsyetim per refuzimin e ofertes.*
*Si konkluzion Kriteri eshte plotesuar nga BOE Enbi Power shpk dhe ACI Engineering.*

*2. Autoriteti kontraktor ka parashtruar si arsye per refuzim: Ne kriteret e vecanta eshte kerkuar: Operatori Ekonomik ofertues duhet te paraqese Autorizim teprodhuesit/Distributorit te autorizuar Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëebsite, Igo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij. a) Shenim: Operatori ekonomik /Bashkimi i operatoreve, duhet te ofertoje vetem me nje prodhues per secilin artikull, rastet kur paraqiten autorizime nga dy ose me shume prodhues per te njejtin artikull, perbejne objekt skualifikimi. b) Autorizimi i prodhuesit duhet te jete i perkthyer ne gjuhen shqipe. Referuar ndarjes se punimeve ne marreveshjen e bashkepunimit, subjekti 'Aci engineering Shpk ka marre persiper 100% te furnizimit me cela 12 KV dhe Ce/a te brendshme TM 40 5KV dhe duhet te kishte paraqitur autorizim prodhuesi per keto mallra, por autorizimi i kompanise Schneider electrik eshte leshuar per Enbi Power, ne kundershtim me nenin 88/3 te VKM NR. 285 ku parashikohet se: Secili prej anetareve te ketij bashkimi duhet te permbushe kerkesat e parashikuara ne nenin 76, te LPP-se, dhe ato te percaktuara ne dokumentet e tenderit. Kerkesat per kualifikim: ekonomike, .financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet te permbushen nga i gjithe bashkimi, neperputhje me perqindjen dhe/ose natyren e pjesemarrjes nepune, sherbim apo furnizim, te percaktuara ne aktmarreveshje*
*Ne konsiderojme qe kjo pike nuk perben pike per refuzim: Argument:*
*Se pari: Furnizmi me cela nuk eshte 100% I marre persiper nga ACI Engineering. Tre module te parashikuara nga preventivi mbi furnzimin e celave qe to do merren nga prodhuesi Schneider. Dy prej tyre jane marre persiper nga ACI Engineering dhe nje prej tyre nga Enbi Power shpk. Bashkelidhur Dokument mbeshtetes nr. 2 Marreveshja e Bashkepunimin me ndarjen perkatese te objektit.*

*Se dyti: 88/3 te VKM NR. 285 Secili prej anetareve te ketij bashkimi duhet te permbushe kerkesat e parashikuara ne nenin 76, te LPP-se, dhe ato te percaktuara ne dokumentet e tenderit. Kerkesat per kualifikim: ekonomike, .financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet te permbushen nga i gjithe bashkimi, Ne lidhje me Kerkesat Ligjore- Ne lidhje me kerkesen e nenit 88/3 per permbushjen e nenit 76, te LPP-se secili nga operatoret pjese e bashkimit Enbi Power dhe ACI Engineering ka paraqitur vetedeklarimin perkates si rrjedhoje kjo kerkese eshte plotesuar, referuar dokumentit mbeshtetes nr.1.*

*Se treti: Ne lidhje me kerkesat Teknike- Ne lidhje me pjesen e nenit 88/3 Kerkesat per kualifikim: ekonomike, .financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet te permbushen nga i gjithe bashkimi.*

*Pra sa me siper Bashkimi i Operatoreve Enbi Power shpk dhe ACI Engineering nepermejt marrveshjes ka caktuar si perfaqesues te BO shoqerine Enbi Power shpk e cila e perfaqeson bashkimin gjate procedures me palet e treta duke garantuar autorizimet perkatese te prodhuesve si dhe sigurimin e ofertes dhe cdo gje tjeter qe i sherben Bashkimit te Operatoreve ne kete procedure. Ky kriter eshte plotesuar nga BOE ne kete procedure.*

*3. Autoriteti kontraktor ka parashtruar si arsye per refuzim:*

*Ne kriteret te vecanta eshte kerkuar: Operatori ekonomik duhet te kete ne stafin e tij ose me kontrate sherbimi të paktën 1 (Nje) Inxhinier Elektrik te certifikuar nga (prodhuesi ose ekuivalentet) per instalimin dhe komisionimin pajisjeve diagnostifikuese, analizuese te gazrave DGA (te Transformatoret efuqise), i cili do te realizoje kete sherbim.*

*Per te provuar plotesimin e ketij kushti duhet te paraqitet:*

*- Kontrata punës*

*- Diplome CV*

*- Librezat punës*

*- Certifikata perkatese e Inxhinierit Elektrik te certifikuar nga prodhuesi ose ekuivalente i pajisjeve DGA (Diagnostifikim, Analizim i Gazrave te Transformatoret e fuqisë).*

*- Listpagesat E-sig 25 ku te jenë te pasqyruar ne listepagesat e shoqerise per një periudhë 3 muajsh nga dita e shpalljes se tenderit.*

*Per piken si me siper operatoret ekonomik ofertues duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces Nr. 8. Ndersa operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, te gjithe dokumentacionin provues te kerkuar si me siper ENBI POWER ka deklaruar nje inxhinier kinez te shoqerise prodhuese, nderkohe duhet ta kishte staf te vetin dhe dokumentacioni shoqerues.*

*Ne konsiderojme qe kjo pike nuk perben pike per refuzim:*

*Se pari: Prodhuesi per pajisjeve diagnostifikuese, analizuese te gazrave DGA (te Transformatoret e fuqisë) per Enbi Power ShPK dhe se bashku me Autorizimin e Prodhuesit ka derguar edhe Deklaraten per dergimin e specialistit te certifikuar per montimin e trajnimin e paisjes DGA me referencat perkatese qe e lidhin me procedure konkrete ( Numer Reference Prokurimi, Autoritet Kontraktor, dhe objekti Nenstacioni Kucove).*

*Pra me kete deklarate Autoriteti garantohet per prezencen e specialistit perkatese per montimin e pajisjes DGA te procedure perkatese nga Enbi Power ShPK.*

*Gjithashtu Enbi Power e ka deklaruar kete ne Vetedeklarim sipas Shtojces 8. Kriteri kerkon vetem shtojcen 8 per permbushjen e tij.*
*Se dyti: VKM 285, datë 19.5.2021, PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, Neni 26 Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, pika 1 citon: Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetë deklarimit, sipas përcaktimit ne nenin 82, te LPP-sË, dhe ne keto rregulla Pika 3 citon, Ne çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet ti kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetë deklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Gjithashtu pika 7 sqaron: Ne çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose ti kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.*
*Argument:*
*BOE Enbi Power ShPK & ACI Engineering kane dorezuar Shtojcen 8 formularin e Vetdelarimit ku eshte deklaruar specialistin perkates (referuar Dokument mbeshtetes nr.1) si dhe ka dorezuar certifikaten perkatese per si nga prodhuesi ose ekuivalente i pajisjeve DGA dhe Deklaraten perkatese per pranine e specialistit.*
*Gjithashtu Autoriteti Kontraktor sipas pikes 7 ka te drejte te kerkoje sqarime operatorit dhe dokumente mbeshtetese ne lidhje me keto sqarime. Sipas kesaj pike kemi marre ne sistem kerkese nga AK ne date 21.09.2023 kërkesë per Informacion shtesë, me përmbajtje: ì Pasi u shqyrtuan dokumentet e ngarkuara në sistem, në lidhje me specialistin z.Xiong Yang i cili është i angazhuar për instalimin dhe komisionimin e sistemit të monitorimit të gazrave të transformatorëve (DGA), nevojitet informacion shtesë:*
*A keni mbajtur një marrëveshje midis jush si OE dhe specialistit z.Xiong Yang i cili do të angazhohet për instalimin dhe komisionimin e sistemit të monitorimit të gazrave të transformatorëve (DGA) dhe për periudhën e garancisë 2 (dy) vjeçare?*
*Gjatë periudhës së garancisë në qoftë se do të shfaqen problematika në funksionimin e sistemit (DGA), sa kohë pas njoftimit mund të paraqitet specialisti në objekt për verifikimin dhe eliminimin e problematikës?*
*A keni mundësi dhe kapacitete për integrimin e sistemit lokal te DGA në sistemin e monitorimit qendror pranë Dispecerisë së Tensionit të Larte ashtu sic janë të gjithë nënstacionet ku janë instaluar këto sisteme?*
*Ju lutemi të na ktheni një përgjigje për kërkesat e mësipërme brenda një afati prej 3(tre) ditë punë kalendarike.*
*Kesaj kerksese per informacion shtese BOE i eshte pergjigjur sipas afatit te lene ne dispozicion ne date 26.09.2023 ku kemi sqaruar se:*
*Sqarim OE: Po, OE Enbi Power ShPK ka marrëveshje me prodhuesin e Transformatorit dhe specialistin Z. Xiong Yang per angazhimin e tij per instalimin dhe komisionimin e sistemit te mont sistemit të monitorimit të gazrave të transformatorëve (DGA). Gjithashtu ne marrëveshje është perfshire edhe periudha 2 vjecare e garancise. Per me teper ne marveshjen perkatese eshte percaktuar edhe intervali kohor per nevojshmerine e prezences*

se tij per inspektimet perkatese. Bashkelidhur gjeni dhe marrveshjen perkatese te cilen OE ka nenshkruar per kete rast.
Sqarimi OE: Sqarojme se OE i ka mundesite per integrimin e kerkuar sic vertetohet nga dokumentacionet e dosjes se tenderit ku OE eshte rishites i autorizuar si partner i kompanive nderkombetare per keto sisteme. Referuar- Dokumenti Rishites i autorizuar GE. Bashkelidhur Dokument mbeshtetes Nr.3 Sqarimi i BOE dhe dokumentet perkatese.
Si konklukizon duke konsideruar qe kriteri kerkon per plotesim Shtojcen 8 e cila eshte ngarkuar ne sistem nga BOE si dhe kerkesen per sqarim nga AK dhe sqarimin perkates te dhene nga BOE ku i përgjigjet plotesisht kerkeses per sqarim, AK krijon pritshmerine e ligjshme qe ky kriter eshte plotesuar dhe arsyeja e perdorur per refuzim nuk qendron.

4.Autoriteti kontraktor ka parashtruar si arsye per refuzim:
Kontratat ACI Engineering shume arimetike e kontratave te ngjashme nuk permbush vleren ne 18.2% te dyfishit te fondit limit.
Ne konsiderojme qe kjo pike nuk perben pike per refuzim:
Kontratat e ACI Engineering kane vlerat e meposhtme:
Aci engineering

| vlera e realizuar e kontrates | vlera sipas perqindjes se pjesemarrjes |
|---|---|
| NST Ibe 50,156,737.20 | 50,156,737.20 |
| F.Arrez 188,329,307.00 | 133,713,807.97 |
| Linja kabllore 110kV 62,964,704.40 | 47,003,151.83 |
| SS Fier 49,142,000.00 25,553,840.00 | 256,427,537.00 |

Si rrjedhoje shume aritmetike e kontratave te ngjashme e permbush vleren prej 18.2% te dyfishit te fondit limit. Pra kriteri eshte i plotesuar. Referuar kontratave te dorezuar ne procedure.

5. Autoriteti kontraktor ka parashtruar si arsye per refuzim: Kontratat Enbi

K4- 12 Nenstacionet 62%
3. Situacione nuk ka, ka fatura blerje dhe konfigurimi, projektimi (Ska ndertim duhet pare ne zera nese konsiderohet kontrate e ngjashme teknikisht).
4. Marreveshja e bashkepunimit e paperkthyer dhe nuk ka ndarjen e zerave qe merr persiper te realizoje secili operator ekonomik
7. Ka vertetim realizimi kontrate jo formular vleresimi se nuk eshte kontrate pune. K 7 ñ fuqizimi I traktit te ri TR-4 NST 110/20 kv 1x20/25 MVA Plasmas Lushnje
1. Situacion perfundimtar e ka me objekt Fuqizimi traktit te ri TR-4 NST 110/20 kv x20/25 MVA Plasmas lushnje
2. Proces verbal marrje ne dorezim objektin e ka Rikonstruksion inenstacionit plasmas 110/35/20/6 KV pra ska perputhje me objektin tek situacionet
6. Ska formular vleresimi

K-3 Nenstacioni Sallmone- Gjiri I Lalzit ( Enbi & ONYX)
2. Ka vertetim realizimi jo formular vleresimi sipas standardit sikunder kerkuar

*6. Ka Marreveshje bashkepunimi dhe prokure por nuk ka tabelen e ndarjes se puneve.*
*7. Certifikate marrje ne dorezim vlera e realizuar nga Enbi Power 156 268 465 lek pa TVSH*

*K ñ 8 Kolektori Kabllor 20 kV Kombinat*
*2. Ka paraqitur vetem nje fature tatimore ne vlere 3.548.729 leke pa tvsh*
*6. Ska formular vleresimi*
*7. Ska situacion perfundimtar*

*K-5 Rikonstruksion dhe fuqizim nenstacioni Selite (kontrata furnizim malli}*
*5.Ska formular vleresimi as vertetim realizimi te leshuar nga autoriteti kontraktor*

*K-1 Dizajnimi, furnizim dhe instalimi i nenstacionit 110/20 Kombinat (Enbi & Jacobsen ) 60%*
*5. Ka marreveshje bashkepunimi dhe prokuren e posacme por nuk ka paraqitur tabelen e ndarjes se punimeve qe ka marre persiper te realizoje secili operator*
*7. Fatura ka vetem nje fature per situacionin perfundimtar*

*K-9 Sallmone Lot 1 (Enbi &Alkoimpex) 63%*
*5. Ska formular vleresimi*
*6. Ska certificate marrje ne dorezim te punimeve*
*7. Ska akt kolaudimi*

*K-6 Nenstacioni Himara*
*2. Certifikate e marrjes ne dorezim te objektit ska firme mbikqyresi.*
*6. Ska formular vleresimi*

*K2-0ST Rehabilitimi impiantit 110 KV RUBIK*
*6.Ka vertetim realizimi ska formular vleresimi sikunder kerkuar ne dst*
*Argument:*
*Se pari: Ne lidhje me pretendimin per perkthimin e ndonje dokumenti sqarojme se: Dokument Standarte te Tenderit per procedure ne fjale, pika 4.7 citon se: Gjuha (Ët) në të cilat mund të hartohen ofertat: Shqip X Anglisht xë Pra gjuha perdorur Anglisht ne dokumente te ndryshme te ofertes ploteson kushtet e percaktuara ne procedure pervec dokumenteve qe kerkohen specifikisht te perkthyera ne shqip sic jane Autorizimi i Prodhuesit, Katalogu apo test reporte pajisjeve te cilat jane dorezuar te tilla nga BO.*
*Se dyti: ne lidhje me pretendimin per mungese te formularit te vleresimit apo ndonje dokumentacioni per kontratën e ngjashme sqarojme se: Kriteri ne DST sipas specifikimeve ne VKM 285, Neni 39/ 5 Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve Edhe ne DST ne fjale kriteri kërkon: Ne rastin e përvojës se meparshme te realizuar me sektorin publik, duhet te paraqiten vertetime te leshuara nga nje ent puhlik, per permhushjen me sukses te kontrates, ku te shenohen vlera, afati i perfundimit te kontrates dhe natyra e punes se bere. Dokumentacioni i dorezuar ne*

*dosjen e tenderit ne lidhje me punet e ngjashme perkatesisht verteton per secilen pune vleren, afatin e perfundimit, natyren e punes se kryer.*
*Se treti: Nese do te analizojme kontrata vecmas:*
*Pretendimi i AK:*
*K4- 12 Nenstacionet 62%*
*3. Situacione nuk ka, ka fatura blerje dhe konfigurimi, projektimi (Ska ndertim duhet pare ne zera nese konsiderohet kontrate e ngjashme teknikisht).*
*4. Marreveshja e bashkepunimit e paperkthyer dhe nuk ka ndarjen e zerave qe merr persiper te realizoje secili operator ekonomik*
*7. Ka vertetim realizimi kontrate jo formular vleresimi se nuk eshte kontrate pune.*
*Argument BOE:*
*3 . Situacionet jane dorezuar dhe jane sipas formatit te kerkuar nga kontrata perkatese e cila eshte prokuruar sipas rregullave te prokurimit te Bankes Boterore. Punime ka duke perfshire ketu punime civile per bazamentet e shelterave, punime instalimi, kabllime, ne te 12 Nenstacionet.*
*4.Per ceshtjen e perkthimit e sqaruam ne piken me siper. Gjithashtu shtojme se Marrveshja e Bashkepuniimit eshte hartuar sic kerkohen nga rregullat e prokurimit te bankes boterore ku percaktohet % e pjesmarrjes. Prandaj kjo marrveshje eshte pranuar nga Autoriteti Kontaktor i kontrates perkatese dhe eshte bere baze per lidhje e kontrates .*
*7.Formular i vleresimit pervec sa sqaruam me siper, shtojme se kjo kontrate eshte kontrate pune por eshte e prokuruar sipas rregullave te prokurimit te bankes boterore e si rrjedhoje nuk perfshihet formulari i vleresimit.*
*Dokumentacioni i dorezuar per kete kontrate i paraqet te gjithe informacionin e nevojshme ne lidhje me vleren, afatin e realizimit dhe natyren e punes se kryer sic kerkohen nga kriteri perkates*
*Dokumentacioni aty ku referohet eshte pjese e dosjes se tenderit.*
*Pretendimi i AK:*
*K 7 ñ fuqizimi i traktit te ri TR-4 NST 110/20 kv 1x20/25 MVA Plasmas Lushnje*
*1. Situacion perfundimtar e ka me objekt Fuqizimi traktit te ri TR-4 NST 110/20 kv x20/25 MVA Plasmas lushnje*
*2. Proces verbal marrje ne dorezim objektin e ka Rikonstruksion inenstacionit plasmas 110/35/20/6 KV pra ska perputhje me objektin tek situacionet*
*6. Ska formular vleresimi*
*Argument BOE:*
*Ne lidhje me pikat 1 dhe 2 eshte e qarte nga Kontrata perkatese e dorezuar dhe pjese e dosjes se tenderit ka bashkelidhur edhe preventivin fitues te kesaj kontrate ne titullin te cilit eshte percaktuar ìFuqizimi traktit te ri TR-4 NST 110/20 kv x20/25 MVA Plasmasë, situacionet behen ne baze te këtij preventivi dhe mbajnë te njejtin titull me te.*
*Nderkohe provcesvebali i marrjes ne dorezim mban titullin e kontrates Rikonstruksion i nenstacionit plasmas 110/35/20/6 KVë pra nese i referohemi kontrates se dorezuar vertetohet lidhja midis kontrates, situacioneve, procesverbalit te marrje ne dorezim. Ne thelb teknikisht objekti ì Rikonstruksion i nenstacionit plasmas 110/35/20/6 KV konsiston pikerisht ne Fuqizimin e traktit te ri TR-4 NST 110/20 kv x20/25 MVA Plasmas.*

*Theksojme gjithashtu qe kjo kontrate eshte kontrate e prokuruar, hartuar, ndjekur dhe marre ne dorezim nga i një̈jti Autoritet Kontraktor i kesaj procedure ne fjale.*
*Ne lidhje me piken 6 Ne kriterin e cituar ne DST nder dokumentet e kerkuar edhe Certifikata e marrjes ne dorezim te perkohshem/perfundimtar.*
*Pra Autoriteti pranon edhe objekte te cilat kane Certifikate te marrjes ne dorezim te perkohshem te cilat si te tilla do te thote qe jane afat garancise dhe autoritet kontraktore nuk leshojne formular vleresimi. Pra objektet e marra ne dorezim te perkohshem pranohen si rrjedhoje duhet pranuar edhe mungesa e formularit te vleresimit. Dokumentacioni i dorezuar per kete kontrate i paraqet te gjithe informacionin e nevojshme ne lidhje me vleren, afatin e realizimit dhe natyren e punes se kryer sic kerkohen nga kriteri perkates. Theksojme gjithashtu qe kjo kontrate eshte kontrate e prokuruar, ndjekur dhe marre ne dorezim nga i njejti Autoritet Kontraktor i kesaj procedure ne fjale.*
*Pretendimi i AK:*
*K-3 Nenstacioni Sallmone- Gjiri i Lalzit ( Enbi & ONYX)*
*2. Ka vertetim realizimi jo formular vleresimi sipas standartit sikunder kerkuar*
*6. Ka Marreveshje bashkepunimi dhe prokure por nuk ka tabelen e ndarjes se puneve. 7.Certifikate marrje ne dorezim vlera e realizuar nga Enbi Power 156 268 465 lek pa TVSH*
*Argument BOE:*
*Dokumentacioni i dorezuar per kete kontrate i paraqet te gjithe informacionin e nevojshme ne lidhje me vleren, afatin e realizimit dhe natyren e punes se kryer sic kerkohen nga kriteri perkates.*
*Ne lidhje me piken 6, theksojme qe kjo kontrate eshte prokuruar sipas ligjit te prokurimit public dhe si rrjedhoje ndarja e punimeve eshte paraqitur tek Autoriteti Perkates. BOE kemi marre nje kerkese per sqarim nga autoriteti kontraktor ne kete procedure dhe nuk eshte kerkuar asnje sqarim per kete pike qe tani AK e perdor si arsyetim per refuzimin e ofertes.*
*Pretendimi i AK:*
*K ñ 8 Kolektori Kabllor 20 kV Kombinat*
*2. Ka paraqitur vetem nje fature tatimore ne vlere 3.548.729 leke pa tvsh*
*6. Ska formular vleresimi*
*7. Ska situacion perfundimtar*
*Argument BOE:*
*Ne DST kerkohet si dokumentacion mbeshtete nder te tjera:*
*Per sektorin public:*
*- Situacioni perfundimtar i objektit*
*- Fatura Tatimore Per sektorin privat:*
*- Situacionin perfundimtar;*
*- Fatura tatimore per situacionin perfundimtar.*
*Sic shihet nga kerkesa e Autoriteti kemi te bejme me nje fature tatimore e cila eshte ajo e situacionit perfundimtar e cila eshte dorezuar nga BO.*
*6. Ska formular vleresimi*
*7. Ska situacion perfundimtar*
*Dokumentacioni i dorezuar per kete kontrate i paraqet te gjithe informacionin e nevojshme ne lidhje me vleren, afatin e realizimit dhe natyren e punes se kryer sic kerkohen nga kriteri perkates si kontrata, akti I kolaudimit, marrja ne dorezim etj.*

*Per sa kohe Akt Kolaudimi eshte pjese e dosjes atëherë situacionet jane te përmendura ne te dhe jane pranuar nga Autoritet perkates dhe mund te kerkohen si sqarim.*
*Pretendim AK:*
*K-5 Rikonstruksion dhe fuqizim nenstacioni Selite (kontrata furnizim malli}*
*6.Ska formular vleresimi as vertetim realizimi te leshuar nga autoriteti kontraktor Dokumentacioni i dorezuar per kete kontrate i paraqet te gjithe informacionin e nevojshme ne lidhje me vleren, afatin e realizimit dhe natyren e punes se kryer sic kerkohen nga kriteri perkates si kontrata, akti i kolaudimit, marrja ne dorezim etj. Shtojme qe objekti i kontrates eshte fuqizimi i Nenstacionit Selite pasi pervec mallit ka punime dhe instalime perkatese ndaj Autoritet ka vendosur kete titull kontrate dhe jo thjeshte furnizimin. Theksojme gjithashtu qe kjo kontrate eshte kontrate e prokuruar, ndjekur dhe marre ne dorezim nga i njejti Autoritet Kontraktori i kesaj procedure ne fjale.*
*Pretendim AK:*
*K-1 Dizajnimi, furnizim dhe instalimi i nenstacionit 110/20 Kombinat (Enbi & Jacobsen ) 60%*
*5. Ka marreveshje bashkepunimi dhe prokuren e posacme por nuk ka paraqitur tabelen e ndarjes se punimeve qe ka marre persiper te realizoje secili operator*
*7. Fatura ka vetem nje fature per situacionin perfundimtar*
*Argument BOE:*
*5. Marrveshja e Bashkepuniimit eshte hartuar sic kerkohen nga rregullat e prokurimit te bankes boterore ku percaktohet % e pjesmarrjes. Prandaj kjo marreveshje eshte pranuar nga Autoriteti Kontaktor i kontrates perkatese dhe eshte bere baze per lidhje e kontrates.*
*7. Ne lidhje me faturen:*
*Ne DST kerkohet si dokumentacion mbeshtetet nder te tjera:*
*Per sektorin publik:*
*- Situacioni perfundimtar i objektit*
*- Fatura Tatimore*
*Per sektorin privat:*
*- Situacionin perfundimtar;*
*- Fatura tatimore per situacionin perfundimtar*
*Sic shihet nga kerkesa e Autoriteti kemi te bejme me nje fature tatimore e cila eshte ajo e situacionit perfundimtar e cila eshte dorezuar nga BO.*
*Dokumentacioni i dorezuar per kete kontrate i paraqet te gjithe informacionin e nevojshme ne lidhje me vleren, afatin e realizimit dhe natyren e punes se kryer sic kerkohen nga kriteri perkates si kontrata, akti i kolaudimit, marrja ne dorezim etj.*
*Pretendim AK:*
*K-9 Sallmone Lot i (Enbi &Alkoimpex) 63%*
*5. Ska formular vleresimi*
*6. Ska certifikate marrje ne dorezim te punimeve*
*7. Ska akt kolaudimi*
*Argument BOE:*
*Ne kriterin e cituar ne DST nder dokumentet e kerkuar edhe Certifikata e marrjes ne dorezim te perkohshem/perfundimtar*

*Pra Autoriteti pranon edhe objekte te cilat kane Certifikate te marrjes ne dorezim te perkohshem ti cilat si te tilla do te thote qe jane afat garancise dhe autoritet kontraktore nuk leshojne formular vleresimi. Pra objektet te marra ne dorezim te perkohshem pranohen si rrjedhoje duhet pranuar edhe mungesa e formularit te vleresimit.*
*Dokumentacioni i dorezuar per kete kontrate i paraqet te gjithe informacionin e nevojshme ne lidhje me vleren, afatin e realizimit dhe natyren e punes se kryer sic kerkohen nga kriteri perkates dhe mund te kerkohet kerkese per sqarim.*
*Prentendim AK:*
*K-6 Nenstacioni Himara*
*2. Certifikate e marrjes ne dorezim te objektit ska firme mbikqyresi.*
*6. Ska formular vleresimi*
*Argument BOE:*
*2. Certifikate e marrjes ne dorezim te objektit ska firme mbikqyresi. Certifikata e marrjes ne dorezim firmoset nga personat e Autorizuar me urdher nga Titullari i Institucionit te cilet ngarkohen per marrjen ne dorezim te objektit pas kolaudimit. Supervizori nuk eshte pale ne proces dhe jo nuk ka firmosur sic thuhet me siper ne piken 2.*
*6. Ska formular vleresimi*
*Ne kriterin e cituar ne DST nder dokumentet e kerkuara edhe Certifikata e marrjes ne dorezim te perkohshem/perfundimtar*
*Pra Autoriteti pranon edhe objekte te cilat kane Certifikate te marrjes ne dorezim te perkohshem ti cilat si te tilla do te thote qe jane afat garancise dhe autoritet kontraktore nuk leshojne formular vleresimi. Pra objektet te marra ne dorezim te perkohshem pranohen si rrjedhoje duhet pranuar edhe mungesa e formularit te vleresimit.*
*Dokumentacioni i dorezuar per kete kontrate i paraqet te gjithe informacionin e nevojshme ne lidhje me vleren, afatin e realizimit dhe natyren e punes se kryer sic kerkohen nga kriteri perkates. Theksojme gjithashtu qe kjo kontrate eshte kontrate e prokuruar, ndjekur dhe marre ne dorezim nga i njejti Autoritet Kontraktor i kesaj procedure ne fjale.*
*Pretendim AK:*
*K2-0ST Rehabilitimi impiantit 110 KV RUBIK*
*6. Ka vertetim realizimi ska formular vleresimi sikunder kerkuar ne dst*
*Argument BOE:*
*Ne lidhje me formularin e vleresimit sic eshte sqaruar ne fillim te analizes si dhe dokumentacioni i dorezuar ne dosjen e tenderit ne lidhje me punet e ngjashme perkatesisht verteton per secilen pune vleren, afatin e perfundimit, natyren e punes se kryer.*
*7. Autoriteti kontraktor ka parashtruar si arsye per refuzim: Duhen formularet e vleresimit nga subjektet mbeshtetese te cilat nuk jane ngarkuar ne dokumentet e tenderit.*
*Ne konsiderojme qe kjo pike nuk perben pike per refuzim: Nuk eshte e qarte ky arsyetim. Nuk ka nje kerkese te tille per formular vlersimi per subjektet mbeshtese.*
*8. Autoriteti kontraktor ka parashtruar si arsye per refuzim:*
*Nuk ka teknikun e ndertimit te deklaruar ne shtojcen 8 per asnje nga operatoret ekonomik.*

*Ne konsiderojme qe kjo pike nuk perben pike per refuzim: BO konkretisht OE Enbi Power ne shtojcen 8 ka paraqitur Inxhnier Ndertimi per kete qellim. Theksojme se kriteret e tenderit*

*jane kerkesa minimale dhe nese OE vjen me plotesim kerkese te nje shkalle me te larte profesionale sic eshte Inxhinieri ne vend te teknikut kriteri eshte i plotesuar.*

*9. Autoriteti kontraktor ka parashtruar si arsye per refuzim: Mjeku eshte kerkuar ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik te paraqitet nga te dy anetaret e bashkimit ACI nuk ka paraqitur ne vetdeklarim mjekun e shoqerise.*
*Ne konsiderojme qe kjo pike nuk perben pike per refuzim:*
*Argument: ne DST thuhet qe Operatori Ekonomik duhet te kete te punesuar ose me kontrate shërbimi, mjekun e shoqerise te pajisur me licencË profesionale nga Ministria e Shëndetësisë, sipas parashikimeve te VKM-se Nr.692 date 13.12.2001 ndryshuar me VKM Nr. 742 date 06.11.2003. (NË rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet te plotesoje kete kerkese duke pasur ne konsiderate edhe parashikimin e pikes 3 të nenit 88 te VKM-se Nr. 285 date 19.05.2021, i ndryshuar). Parashikimi I VKM Nr. 285 date 19.05.2021, Neni 88 pika 3 thuhet qe Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. E Pra ky kriter duhet te bazohet edhe ne Marrëveshjen e BO dhe ndarjen përkatëse te pjesmarrjes ne bashkepunim si % dhe si natyre. Ndarje e cila i bashkelidhet marrveshjes. Bazuar ne Marrveshjen e BO midis Enbi Power dhe ACI Engineering shoqeria ACI Engineering do te kete vetem furnizime mallrash dhe nuk do te angazhoje mjekun e tij ne kete projekt nderkohe te gjithe punimet do te kryhen nga Enbi Power shpk si rrjedhoje mjeku i deklaruar nga Shtojcen 8 te Enbi Power shpk do te jete pjese e ketij projekti perkatesisht. Pavarsisht se te dy shoqerite e kane mjekun sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi mjeku qe do angazhohet ne kete projekt eshte ai i Enbi Power bazuar ne Marveshjen e BO dhe ndarjen e punimeve dhe deklaruar shtojcen 8 perkatese.*
*BOE kemi marre nje kerkese per sqarim nga autoriteti kontraktor ne kete procedure dhe nuk eshte kerkuar asnje sqarim per kete pike qe tani AK e perdor si arsyetim per refuzimin e ofertes".*

II.6.2. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 "Për prokurimin Publik" Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr. 2425/2 prot., datë 04.10.2023 lidhur me arsyet e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë "ENBI POWER" SHPK & "Aci Enginnering" SHPK, që kundërshtohen me anë të ankimit elektronik me nr. A/2023/3462, dhe me numër protokolli 2425/2023, datë 03.10.2023.

II.6.3. Nëpërmjet shkresës me nr. 760/28 prot., datë 09.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 2425/4 prot., datë 10.10.2023 me objekt "*Dërgim dokumentacioni*", është depozituar nga autoriteti kontraktor shkresa (nr. 760/26 prot., datë 09.10.2023) e "Kthimit të përgjigjes" së trajtimit të ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, ku konstatohet se e ka refuzuar atë.

II.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore apo në sistemin e ankesave elektronike.

## III

## Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

## Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "4 A-M" SHPK se*"• Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik, dy inxhinier elektrike. Për të provuar plotesimin e këtij kushti duhet të paraqitet:*

*- Kontratë pune të vlefshme*

*- Diplome, CV*

*- Librezat e punës*

*- Listëpagesat E-sig 25 ku të jenë të pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë për një periudhë 3 muajsh nga dita e shpalljes se tenderit.*

*OE ''4AM'' ShPK ka deklaruar ne shtojcën nr. 8 disponimin e ketyre inxhiniereve, por nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar për të (Kontratë pune të vlefshme)*

*- Diplomë, CV*

*- Librezat e punës*

*- Certifikata perkatese e Inxhiniereve Elektrik te certifikuar nga prodhuesi i mbrojtjes rele dhe komandimit.*

*Ndërkohë, për këtë kriter nuk është lejuar përmbushja me vetdeklarim, po është kërkuar paraqitja e dokumentacionit në fjalë",* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 "Kriteret e veçanta të kualifikimit", "Kapaciteti Teknik", pika 4 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

*4.Operatori Ekonomik ofertues duhet te ketë të punësuar si staf teknik, dy inxhinier elektrike.*

*Për të provuar plotesimin e këtij kushti duhet të paraqitet:*

- *Kontratë pune të vlefshme*
- *Diplome, CV*

- *Librezat e punes*
- *List pagesat E-sig 25 ku të jenë te pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë për një periudhë 3 muajsh nga dita e shpalljes se tenderit.*

III.1.2. Në shtojcën 8 të dokumenteve standarde të tenderit autoriteti kontraktor ka parashikuar:

***Shtojca 8***

*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)*

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _______________ në cilësinë e ________________të operatorit ekonomik ______________________ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. **INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK**

| **Identifikimi** | **Përgjigjja** |
|---|---|
| Emri i operatorit ekonomik:<br>(Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE) | ------------------------------------------------ |
| Numri NIPT/et: | --------------------------------------------------- |
| Adresa postare:<br>Qyteti / qyteti; Kodi postar | ------------------------------------------------------ |
| Përfaqësuesi (emri): | -------------------------------------------- |
| Telefoni: | ----------------------------------------------------- |
| E-mail: | ---------------------------------------------------------- |

**B: DEKLARATË**
**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

| **Emri i nënkontraktorit të propozuar** | **NIPT –i** | **Përqindja e nënkontraktimit** | **Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar** |
|---|---|---|---|

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

| **Emri (at) e subjekteve** | **NIPT-i** | **Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik** | **Specifiko konkretisht kapacitetin/et** |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

**Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**
**A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

| **Deklarata** |
|---|
| Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ______________________________________________ |
| Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ______________________________________________ |
| Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:<br>______________________________________________<br>______________________________________________<br>etj.<br>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ______________________________________________ |

| |
|---|
| Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ____________________________________________________ |
| Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ____________________________________________________ |
| Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ____________________________________________________ |
| Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.<br><br>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ____________________________________________________ |
| Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ____________________________________________________ |
| Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.<br><br>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ____________________________________________________ |

## B: DEKLARATA

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklarim dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;

2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;

3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;

4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës,është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;

5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:

   a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
   b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):

   a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
      
   b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).

      

7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:

   a) çmimet ;
   b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
   c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
   d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).

9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

## C: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

| Deklarata |
|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:<br>Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike. |
| Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:<br>Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose |

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivit dhe pasivit.*

*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*

*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*

*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve."*

Në nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" pika 1 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", parashikohet shprehimisht : *"1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik."*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *"3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji..."*

III.2.5. Në nenin 26 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, parashikohet se: "1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

*2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:*

*a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*

*b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

*c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

*ç)operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;*

*d)operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;*

*dh)operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve [3]të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;*

*e)operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;*

*ë)operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit te interesit, sipas legjislacionit në fuqi;*

*f)operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;*

*g)operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;*

*gj)operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;*

*h)operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);*

*i)operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;*

*j)informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;*

*k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.*

*3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

*4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.*

*5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.*

*6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të nenit 26 të*

[3] Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

*V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike*[4]*. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

*Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.*

*Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.*

*Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.*

*7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t´i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.*"

III.2.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.7. Në rastin konkret, nga verifikimi në SPE vihet re, se në përmbushje të kriterit më sipër ankimuesi ka dorëzuar "Listëpagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të ardhurat nga Punësimi" për periudhën maj 2023-korrik 2023 si dhe formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik, të cilin në zbatim të

[4] Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

parashikimeve ligjore në fuqi autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontrator të kryejë verifikime në rast nevoje apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “4 A-M” SHPK rezulton, se në përmbushje të kriterit më sipër ka dorëzuar listëpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, si dhe formularin përmbledhës të vetëdeklarimit ku në Pjesën III; “*Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit*” seksioni “**B***: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate*” operatori ekonomik “4 A-M” SHPK ka deklaruar burimet njerëzore në total prej 522 punonjësish dhe ato specifike që lidhen konkretisht për procedurën e prokurimit si më poshtë:
*“Z. I.M. me profesion inxhinier elektrik, i punësuar pranë shoqërisë, inxhinier elektrik i certifikuar nga prodhuesi ose ekuivalent i releve të mbrojtjes”.*

Në këtë kuadër KPP gjykon, se operatori ekonomik ankimues ka dhënë indicie, se ka në dispozicion për kohën e realizimit të kontratës punonjësit e duhur sipas profileve që ka kërkuar duke specifikuar numrin dhe llojin e certifikatës për secilën prej profileve të kërkuara. Akoma më tej operatori ekonomik me listëpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat për periudhën maj 2023- korrik 2023 (tre muaj nga data e dorëzimit të ofertës) të paraqitura në SPE vërteton, se punonjësit e specifikuar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas profileve të kërkuara i disponon në mënyrë të plotë shteruese dhe ligjore përmes listëpagesave të paraqitura si më sipër dhe çdo dokument tjetër në mbështetje të provës që operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore të nevojshme (në rastin konkret kërkesa për paraqitjen e kontratave të punës) për operatorin ekonomik të kualifikuar i pari janë objekt i verifikimit në një moment tjetër procedural, siç është faza përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontrator të kryejë verifikime në rast nevoje apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë, pasi legjislacioni i prokurimit publik i njeh të drejtën autoritetit kontraktor, por dhe vetë ky i fundit ka rezervuar në dokumentet standarde të tenderit edhe të drejtën e verifikimit apo sqarimit nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës lidhur me vërtetësinë dhe saktësinë e informacionit që përmbajnë dokumentet e paraqitura nga ata dhe më pas të marrë vendim lidhur me to. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se skualifikimi i operatorit ekonomik ankimues për asyet më sipër për mospërmbushje të pikës 5 të kritereve të veçanta, lidhur me paraqitjen e dokumentacionit të kërkuar për punonjësin e specifikuar në DST dhe kontratave të punës nuk është i drejtë. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht

autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t'u siguruar nëse cilësia e mallrave, shërbimeve apo punëve është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm për këtë fazë.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "4 A-M" SHPK se: *I.OSSH FIER objekti "Rikonstruskion i kabinave 6/0.4 KV te fiderit 26,6 KV, Nenstacioni Fier" Vlera 91.539.798,86 leke pa TVSh.*

*Iliriada 20% dhe 4 AM 80%*

*1. Situacioni perfundimtar i punimeve*

*2. Cerifikate marrje ne dorezim*

*3. Kontrata*

*4. Kontrate bashkepunimi+ Prokure*

*5. Ska tabelen e ndarjes se punimeve qe ka marre persiper te kryeje secili operator ekonomik.*

*6. Formular Vleresimi*

*7. Akt kolaudimi*

*8. Ska paraqitur faturat*

*Nuk ploteson dokumentacion*

*II.OSHE SELITE objekti: "Ndërtim i fiderit 20 KV S1 dhe S2 te Nenstacionit 110.20.10 KV Selite, kabina te reja dhe kabina rikonstruksion si dhe linja TU me kabell ABC" (Punetori) Vlera 34.654.664 leke pa tvsh.*

*4 AM 100%*

*1. Cerifikate marrje ne dorezim*

*2. Faturat*

*3. Kontrate*

*4. Formular Vleresimi*

*5. Akt kolaudimi*

*6. Situacion perfundimtar*

*Nuk konsiderohet pune e ngjashme*

*III.OSHE ZEJMEN objekti: "Rikonstruksion i disa kabinave elektrike dhe zhvillimi i rrjetit TU me kabull ABC ne fidrin e Zejmenit, nenstacioni Lezhe" Loti II " Rikonstruksion I rrjetit*

*ajror TM, rikonstruksion i tete kabinave dhe ndertimi I dy kabinave shtyllore fidri 10 KV zejmen Nenstacionib110/10 KV Lezhe*

*Vlera 36.988.563 leke pa TVSh.*

*4 AM 100%*

*1. Cerifikate marrje ne dorezim*

*2. Faturat*

*3. Kontrate*

*4. Formular Vleresimi*

*5. Akt kolaudimi*

*6. Situacion perfundimtar*

*Nuk konsiderohet pune e ngjashme*

*IV.OSSH Elbasan me objekt: "Rikonstruksion i rrjetit TU me kabull ABC ne Belsh si dhe kabinave gjate rruges kryesore Elbasan-Peqin"*

*Vlera 232.988.238 leke pa TVSh.*

*Iliriada 40% dhe 4 AM 60%*

*1. Situacion perfundimtar*

*2. Kontrata*

*3. Kontrate bashkepunimi+ Prokure*

*4. Ska tabelen e ndarjes se punimeve qe ka marre persiper te kryeje secili operator ekonomik.*

*5. Formular Vleresimi*

*6. Akt kolaudimi*

*7. Fatura*

*8. Certifikata e marrjes ne dorezim*

*9. Nuk konsiderohet pune e ngjashme*

*V.OSHE FIDERI me objekt: " Zevendesimi i rrjetit ekzistues 6 KV ne rrjet me tension 20KV te fiderit 248 N/stacioni Dinamo"*

*Vlera 72.881.602 leke pa TVSh.*

*4 AM 100%*

*1. Kontrate*

*2. Formular vleresimi*

*3. Akt kolaudimi*

*4. Fature*

*5. Proces verbal marrje ne dorezim*

*6. Situacion perfundimtar*

*Nuk konsiderohet pune e ngjashme*

*VI.OSSH BURREL me objekt: " Rikonstruksion i rrjetit TU A.B.C dhe ndertimin e kabinave shtyllore, ne Agjencine Bulqize Drejtoria Rajonale Burrel"*

*Vlera 110.153.870,78 leke pa TVSh.*

*4 AM 100%*

*1. Kontrate*

*2. Formular Vleresimi*

*3. Akt Kolaudimi*

*4. Situacion Perfundimtar*

*5. Fatura*

*6. Proces Verbal marrje ne dorezim*

*Nuk konsiderohet pune e ngjashme*

*V.OSSH KINOSTUDIO me objekt: "Kthim ne 20 kv i nje pjese te fiderit 126 Nenstacioni Kinostudio, Tirane"*

*Vlera 180.467.986,78 leke pa TVSh.*

*4 AM 100%*

*1. Kontrate*

*2. Formular vleresimi*

*3. Akt Kolaudimi*

*4. Situacion perfundimtar*

*5. Fatura*

*6. Certifikate marrje ne dorezim*

*Nuk konsiderohet pune e ngjashme*

*VII.LINJA 110 KV me objekt: Realizimin e punimeve civile ne nenstacionin 110 KV.*

*Vlera 61.460.882,5 leke pa TVSh.*

*Vlera shtese 195.100.600 leke pa TVSh.*

*4 AM 100 %*

*1. Formular vleresimi kontrate baze*

*2. Akt kolaudimi baze*

*3. Kontrata baze*

*4. Situacion perfundimtar*

*5. Faturat per kontraten baze*

*1. Formular vleresimi kontrate baze*

*2. Akt kolaudimi baze*

*3. Kontrata baze*

*4. Situacion perfundimtar*

*5. Faturat per kontraten baze*

*Nuk ka certifikate te marrjes ne dorezim as per bazen as per shtesen*

*Nuk ploteson dokumentacionin*

*VIII.OSHE RRASHBULL me objekt: Zgjatimi i rrjetit 20 kv nga F.53 Nst shkozet dhe ndertimi i kabinave te reja dhe rrjetit TU per zonen kantina e veres, tuneli i trenit, laboratori Rrashbull"*

*Vlera 93.426.914 leke pa TVSh.*

*4 AM 100 %*

*1. Formular vleresimi*

*2. Akt kolaudimi*

*3. Kontrata*

*4. Situacion perfundimtar*

*5. Faturat*

*6. Ka nje vertetim per permbushjen e kushteve te garancise*

*Nuk ka certifikatë te marrjes ne dorezim*

*Nuk konsiderohet pune e ngjashme*

*IX.OST Cerrik me objekt : Ndertimi i Linjes se re 110 KV me nje qark Cerrik-Kajan-Kucove-Jagodine dhe rehabilitimi i trakteve dalese te linjave 110 KV te N/Stacioneve Cerrik dhe Kucove Vlera 570.250.000 leke pa TVSh.*

*4 AM 98 % dhe Bonus 2%*

*1. MB + Prokure + tabela e ndarjes se punimeve*

*2. Akt kolaudimi*

*3. Kontrata*

*4. Situacion perfundimtar*

*5. Faturat*

*6. Certifikate marrje ne dorezim*

*7. Ska Formular vleresimi*

*Nuk ploteson dokumentacionin*

*X.Godina RSU Tirane me objekt: Ndertim i godines tip RSU Nr.3*

*Vlera 305.946.636,93 leke pa TVSh*

*4 AM 100%*

*1. Kontrata*

*2. Formular vleresimi*

*3. Akt Kolaudimi*

*4. Situacion perfundimtar*

*5. Fature*

*6. Certifikate marrje ne dorezim*

*Ploteson dokumentacionin*

*Nuk konsiderohet pune e ngjashme*

*XI.OSHE Lezhe: Rikonstruksion i rrjetit elektrik TM TU ne qytetin Lezhe*

*Vlera 136.885.517 leke pa TVSh*

*4 AM 100%*

*1. Kontrata*

*2. Formular vleresimi*

*3. Akt Kolaudimi*

*4. Situacion perfundimtar*

*5. Fature*

*6. Certifikate marrje ne dorezim*

*Nuk konsiderohet pune e ngjashme*

*XII.OSHE KOMBINAT: Rrjeti 20KV i fiderave T16, T17, T18. T19 nga nenstacioni i ri 110/20 KV Kombinat si dhe rrjeti TU me kabllo me vetembajtje tip ABC ne kabinat e tyre Tirane.*

*Vlera 155.913.305 leke pa TVSh*

*4 AM 100%*

*1. Kontrata*

*2. Formular vleresimi*

*3. Akt Kolaudimi*

*4. Situacion perfundimtar*

*5. Fature*

*6. Certifikate marrje ne dorezim*

*Nuk konsiderohet pune e ngjashme*

*XIII.OSSH Durres: Ndertimi i rrjetit TM 20 KV, Fideri F6, kabinave perkatese dhe rrjetit TU me percjelles ABC, N/ST Gjiri i Lalzit, Loti II.*

*Vlera 159.477.902,27 leke pa TVSh*

*4AM 95% dhe Iliriada 5%*

*1. Situacion perfundimtar*

*2. Kontrata*

*3. Kontrate bashkepunimi+ Prokure*

*4. Ska tabelen e ndarjes se punimeve qe ka marre persiper te kryeje secili operator ekonomik.*

*5. Formular Vleresimi*

*6. Akt kolaudimi*

*7. Fatura*

*8. Certifikata e marrjes ne dorezim*

*Nuk konsiderohet pune e ngjashme*

*XIV.DTL Nenstacioni Vore: Rikonstruksion i N/Stacionit Vores 35/20/6 KV*

*Vlera 208.993.280.01 leke pa TVSh*

*Vlera e modifikimit te kontrates 8.457.007 leke pa TVSh*

*4 AM 100%*

*1. Kontrata*

*2. Formular vleresimi*

*3. Akt Kolaudimi*

*4. Situacion perfundimtar*

*5. Fature*

*6. Certifikate marrje ne dorezim*

*Ploteson dokumentacionin",* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7 "Kriteret e veçanta të kualifikimit", "Kapaciteti Teknik", pika 2.3 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

***2.3.1 Përvojë e suksesshme** në realizimin e të paktën:*

**a)** *Punë të ngjashme e realizuar për një objekt të vetëm në një vlere jo më e vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës të procedurës së prokurimit.*

*Ose*

**b)** *Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e kontratave të punëve të kryera dhe të realizuara, të marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit nga data e*

*shpalljes së njoftimit të kontratës të procedurës së prokurimit është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

*Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.*

*Puna e ngjashme duhet te jete ne nenstacione elektrike me nivel tensioni jo me te vogel se 110kV.*

**2.3.1/a** *Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:*

**a)** *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.*

- *Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:*

- *Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;*
- *Kontratë Sipërmarrje;*
- *Situacionin përfundimtar te objektit;*
- *Fatura tatimore;*
- *Aktin e kolaudimit te objektit;*
- *Certifikaten e marrjes ne dorezim te perkohshem/perfundimtar*

**b)** *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.*

- *Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:*

- *Vërtetim per realizimin e punimeve ku të përcaktohet dhe përqindja e pjesëmarrjes së punës së realizuar në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik;*
- *Kontrate Sipërmarrje;*
- *Situacionin përfundimtar;*
- *Fatura tatimore per situacionin perfundimtar.*

- *Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues krahas dokumentacionit te sipercituar per secilin rast, respektivisht duhet te paraqese duhet te paraqesë: Kontraten e Bashkimit te operatoreve dhe Prokuren e Posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit shoqeruar me tabelen e ndarjes se punimeve qe ka marre persiper te kryeje secili anetar e i BOE.*

- *Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor si dhe Miratimi zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.*

III.3.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik në përmbushje të kriterit të mësipërm operatori ekonomik ”4 A-M” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

1. Kontratë pune me nr. 874/24 prot., datë 18.03.2021 me objekt “Rikonstruksion i kabinave 6/0.4 KV dhe linjave TU, 0.4Kv te fiderit 26, 6 KV, Nenstacioni Kafaraj” , lidhur midis bashkimit të operatorëve ekonomikë “Iliriada” SHPK 20% dhe “4 A-M” SHPK 80% dhe autoriteti kontraktor OSSH Sha Drejtoria Rajonale Fier, me vlerë xxxxxxxxxxx lekë me TVSh.
2. Kontratë për bashkimin e përkohshëm të shoqërive, nr. 36 Rep., Nr.6 kol., datë 05.01.2021, ndërmjet operatorëve ekonomikë “Iliriada” SHPK 20% dhe “4 A-M” SHPK 80%. Ku shoqëria “4 A-M” SHPK do të kontribuojë në masën 80 % në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indekset përkatëse, këto zëra punimesh [...].(neni 3 ndarja e punimeve), Prokurë e posaçme Nr.37 Rep., Nr.7 Kol. Datë 05.01.2021.
3. Certifikatë marrje në dorëzim me nr. 874/52, datë 08.04.2022.
4. Situacioni përfundimtar i punimeve.
5. Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor OSSH Sha Drejtoria Rajonale Fier për bashkimit të operatorëve ekonomikë “Iliriada” SHPK dhe “4 A-M” SHPK për objektin e kontratës “Rikonstruksion i kabinave 6/0.4 KV dhe linjave TU, 0.4Kv te fiderit 26, 6 KV, Nenstacioni Kafaraj”, data e fillimit të kontratës 26.07.2021, data e mbarimit të punimeve të kontratës 04.02.2022, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga shoqëria ekonomikë “Iliriada” SHPK 20% dhe “4 A-M” SHPK 80%; Vlerësimi: Kontrata e përmbushur sipas specifikimeve teknike, preventivit dhe projektit përkatës.
6. Akt kolaudimi me nr. 874/50 prot., datë 09.03.2022
7. Fatura tatimore nr. 4/2022 datë 11.02.2022 (Situacion përfundimtar)
8. Licencë për mbikëqyrje MK 0013/1, për inxhinier elektrik për industri, regjistruar në regjistrin themeltar që nga data 25.02.2016 për Z. V. G.

..................

1. Kontratë pune me nr. 2073/22 prot., datë 01.06.2018 me objekt “Ndërtim i Fiderit 20 KV S1 dhe S2 të Nënstacionit 110/20/10 KV Selitë, Kabina të reja dhe kabina rikonstruksion si dhe Linja TU me kabull ABC” (Punëtori), lidhur midis operatorit ekonomik “4 A-M” SHPK dhe autoriteti kontraktor OSHEE Sha Drejtoria Rajonale Tiranë, me vlerë xxxxxxxxxxx lekë me TVSh.
2. Certifikatë marrje në dorëzim me nr. 874/52, datë 08.04.2022.
3. Situacioni përfundimtar i punimeve.
4. Situacion nr. 1
5. Situacion nr. 2.
6. Situacion nr. 3.
7. Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor OSHEE Sha Drejtoria Rajonale Tiranë për operatorit ekonomik “4 A-M” SHPK për objektin e kontratës “Ndërtim i Fiderit

20 KV S1 dhe S2 të Nënstacionit 110/20/10 KV Selitë, Kabina të reja dhe kabina rikonstruksion si dhe Linja TU me kabull ABC" (punëtori), data e fillimit të kontratës 10.07.2018, data e mbarimit të punimeve të kontratës 10.10.2018, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga shoqëria "4 A-M" SHPK 100%; Vlerësimi: Objekti është realizuar në përputhje me kushtet teknike të zbatimit dhe të projektimit.

8. Akt kolaudimi me nr. 7771/8 prot., datë 31.10.2018.
9. Fatura tatimore nr. 2218/2022 datë 03.10.2022
10. Fatura tatimore nr. 2524/2022 datë 10.11.2022
11. Fatura tatimore nr. 15, datë 22.10.2020.
12. Fatura tatimore nr. 28, datë 03.09.2018. (situacion nr.1).
13. Fatura tatimore nr. 21, datë 10.10.2018 (Situacion përfundimtar)
14. Procesverbal marrje në dorëzim objekti, nr. 9261/1 prot., datë 08.11.2018.
15. Vërtetim nr. 1870/3 prot., datë 02.08.2021 për përmbushjen e kushteve të garancisë së punimeve.

......................

1. Kontratë pune me nr. 1520/7 prot., datë 20.09.2018 me objekt "Loti II: Rikonstruksion i rrjetit ajror TM, rikonstruksion i tete Kabinave dhe ndërtim i dy kabinave Fidri 10Kv Zejmen Nënstacioni 110/10kv Lezhë)", lidhur midis operatorit ekonomik "4 A-M" SHPK dhe autoriteti kontraktor OSHEE Sha Drejtoria Rajonale Shkodër, me vlerë xxxxxxxxxxx lekë me TVSh.
2. Formulari i sigurimit të kontratës.
3. Situacioni i përgjithshëm i punimeve.
4. Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor OSHEE Sha Drejtoria Rajonale Shkodër për operatorit ekonomik "4 A-M" SHPK për objektin e kontratës "Loti II: Rikonstruksion i rrjetit ajror TM, rikonstruksion i tete Kabinave dhe ndërtim i dy kabinave Fidri 10Kv Zejmen Nënstacioni 110/10kv Lezhë)", data e fillimit të kontratës 03.10.2018, data e mbarimit të punimeve të kontratës 01.12.2018, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga shoqëria "4 A-M" SHPK 100%; Vlerësimi: Objekti është realizuar në përputhje me kushtet teknike të zbatimit dhe të projektimit.
5. Akt kolaudimi me nr. 38 prot., datë 04.01.2019.
6. Fatura tatimore nr. 02, datë 04.01.2019 (Situacion përfundimtar)
7. Certifikate marrje në dorëzim të punimeve, nr. 1520/30 prot., datë 24.01.2019.
8. Vërtetim nr. 1330/3 prot., datë 23.07.2021 për përmbushjen e kushteve të garancisë.
9. Akt-Kontrolli përfundimtar. 1330/2 prot., datë 23.07.2021 për përmbushjen e kushteve të garancisë së punimeve.

..........................

1. Kontratë pune me nr. 7/15 prot., datë 07.12.2020 me objekt "Rikonstruksion i rrjetit TU me kabull ABC në Belsh si dhe kabinave gjatë rrugës kryesore Elbasan-Peqin", lidhur midis bashkimit të operatorëve ekonomikë "Iliriada" SHPK & "4 A-M" SHPK dhe autoriteti kontraktor OSSH Sha Drejtoria Rajonale Elbasan, me vlerë xxxxxxxxxxx lekë me TVSh.
2. Kontratë për bashkimin e përkohshëm të shoqërive, nr. 7060 Rep., Nr.1268 kol., datë 28.10.2020, ndërmjet operatorëve ekonomikë "Iliriada" SHPK 40% dhe "4 A-M" SHPK

60%. Ku shoqëria “4 A-M” SHPK do të kontribuojë në masën 60 % në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indekset përkatëse, këto zëra punimesh [...].(neni 3 ndarja e punimeve), Prokurë e posaçme Nr. Rep., Nr.7061 Kol.1269 Datë 28.10.2020.

3. Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor OSSH Sha Drejtoria Rajonale Elbasan për bashkimin e operatorëve ekonomikë “Iliriada” SHPK & “4 A-M” SHPK për objektin e kontratës “Rikonstruksion i rrjetit TU me kabull ABC në Belsh si dhe kabinave gjatë rrugës kryesore Elbasan-Peqin”, data e fillimit të kontratës 30.12.2020, data e mbarimit të punimeve të kontratës 12.07.2021, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Iliriada” SHPK & “4 A-M” SHPK 100%; Vlerësimi: Objekti është realizuar në përputhje me kushtet teknike të zbatimit dhe të projektimit.
4. Akt kolaudimi me nr. 559/2 prot., datë 11.08.2021.
5. Fatura tatimore nr. 10/2021, datë 05.10.2021
6. Fatura tatimore nr. 09, datë 16.04.2021 (situacion nr. 1)
7. Fatura tatimore nr. 18, datë 30.06.2021 (situacion nr. 2)
8. Situacion punimesh nr. 1
9. Situacion punimesh nr. 2
10. Situacion progresiv përfundimtar punimesh
11. Certifikate nr. 559/4 prot., datë 27.08.2021 e marrjes në dorëzim të punimeve.

..............................

1. Kontratë pune me nr. 685/16 prot., datë 05.04.2019 me objekt “Zëvendësimi i rrjetit ekzistues 6KV në rrjet me tension 20 Kv të Fiderit 248 N/Stacionit Dinamo”, lidhur midis operatorit ekonomik “4 A-M” SHPK dhe autoriteti kontraktor OSHEE Sha Drejtoria Rajonale Tiranë, me vlerë xxxxxxxxxxx lekë me TVSh.
2. Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor OSHEE Sha Drejtoria Rajonale Tiranë për operatorit ekonomik “4 A-M” SHPK për objektin e kontratës “Zëvendësimi i rrjetit ekzistues 6KV në rrjet me tension 20 Kv të Fiderit 248 N/Stacionit Dinamo”, data e fillimit të kontratës 22.05.2019, data e mbarimit të punimeve të kontratës 02.10.2019, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik “4 A-M” SHPK 100%; Vlerësimi: Objekti është realizuar në përputhje me kushtet teknike të zbatimit dhe të projektimit.
3. Akt kolaudimi nr. 695/29 prot., datë 22.10.2019.
4. Situacion i punimeve rezervë
5. Preventiv nr. 1
6. Preventiv nr. 2
7. Preventiv nr. 3
8. Situacion nr. 2
9. Faturë tatimore nr. 40, datë 16.10.2019 (situacion nr.2)
10. Faturë tatimore nr. 38, datë 04.07.2019 (situacion nr.1)
11. Procesverbal nr. 695/31 prot., dat 31.10.2019 i marrjes në dorëzim të punimeve.
12. Vërtetim nr. 3067/3 prot., datë 23.11.2021 për përmbushjen e kushteve të garancisë.
13. Akt-kontrolli përfundimtar nr. 3067/2 prot., datë 15.11.2021 i veprës për përmbushjen e kushteve të garancisë së punimeve.

.........................................

1. Kontratë pune me nr. 855/14 prot., datë 12.03.2021 me objekt "Rikonstruksioni i rrjetit TU ABC dhe ndërtim i kabinave shtyllore, në Agjencinë e Bulqizë Drejtoria Rajonale Burrel", lidhur midis operatorit ekonomik "4 A-M" SHPK dhe autoriteti kontraktor OSSH Sha Drejtoria Rajonale Burrel, me vlerë xxxxxxxxxxx lekë me TVSh.
2. Amendim kontrate referuar me nr. 855/14 prot., datë 12.03.2021 me objekt "Rikonstruksioni i rrjetit TU ABC dhe ndërtim i kabinave shtyllore, në Agjencinë e Bulqizë Drejtoria Rajonale Burrel"
3. Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor OSSH Sha Drejtoria Rajonale Burrel për operatorit ekonomik "4 A-M" SHPK për objektin e kontratës "Rikonstruksioni i rrjetit TU ABC dhe ndërtim i kabinave shtyllore, në Agjencinë e Bulqizë Drejtoria Rajonale Burrel", data e fillimit të kontratës 23.06.2021, data e mbarimit të punimeve të kontratës 28.10.2021, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik "4 A-M" SHPK 100%; Vlerësimi: Punimet janë kryer sipas kërkesave të projektit dhe KTZ-së në fuqi.
4. Akt-kolaudimi nr. 459/23 prot., datë 06.12.2021.
5. Situacion i punimeve përfundimtar
6. Faturë tatimore nr. 1/2022 datë 06.01.2022
7. Akt marrje në dorëzim i punimeve nr. 459/14 prot., datë 06.12.2021.

..............................

1. Kontratë pune me nr. 849/10 prot., datë 16.06.2021 me objekt "Kthim në 20 Kv i një pjese të Fiderit 126 nënstacioni Kinostudio, Tiranë", lidhur midis operatorit ekonomik "4 A-M" SHPK dhe autoriteti kontraktor OSSH Sha Drejtoria Rajonale Tiranë, me vlerë xxxxxxxxxxx lekë me TVSh.
2. Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor OSSH Sha Drejtoria Rajonale Tiranë për operatorit ekonomik "4 A-M" SHPK për objektin e kontratës "Kthim në 20 Kv i një pjese të Fiderit 126 nënstacioni Kinostudio, Tiranë", data e fillimit të kontratës 30.08.2021, data e mbarimit të punimeve të kontratës 30.06.2022, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik "4 A-M" SHPK 100%; Vlerësimi: Punimet janë kryer sipas kërkesave të projektit dhe KTZ-së në fuqi.
3. Akt kolaudimi nr. 1630 prot., datë 15.07.2022
4. Situacion përfundimtar
5. Faturë tatimore nr. 1777/2022, datë 09.08.2022
6. Certifikatë marrje në dorëzim

..................................

1. Formular vlerësimi lëshuar nga sipërmarrësi "Iliriada" SHPK për operatorin ekonomik "4 A-M" SHPK për objektin e kontratës "Realizim i punimeve civile në nënstacion dhe elektrike për ndërtimin e linjës së tensionit 110Kv-Nënstacioni i kaskadës së darsit-Carja mes Nënstacionit të Sucit dhe nënstacionit të Bulqizës (shtylla nr. 58)" në funksion të Ndërtimit të Hidrocentraleve Darsi 1, Darsi 2, Klos, Shqipëri", data e fillimit të kontratës bazë 26.04.2018, data e mbarimit të punimeve të kontratës bazë 31.10.2018, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxxxxx lekë me TVSh, si dhe për pjesën e kontratës shtesë, të realizuar nga operatori ekonomik "4 A-M" SHPK 100%; data e fillimit të kontratës shtesë 03.12.2018, data e mbarimit të punimeve të kontratës shtesë 30.06.2020, vlera e realizuar e

kontratës xxxxxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik “4 A-M” SHPK 100%; Vlerësimi: Punimet janë kryer konform kontratës, kushteve teknike të zbatimit dhe brenda afateve të përcaktuara.

2. Shtesë Kontratë nënsipërmarrje datë 03.12.2018 me objekt Punime shtesë për “Realizimin e punimeve civile në nënstacion dhe elektrike për ndërtimin e linjës së tensionit 110Kv-Nënstacioni i kaskadës së darsit-Carja mes Nënstacionit të Sucit dhe nënstacionit të Bulqizës (shtylla nr. 58)” në funksion të Ndërtimit të Hidrocentraleve Darsi 1, Darsi 2, Klos, Shqipëri”, lidhur midis operatorit ekonomik “4 A-M” SHPK dhe shoqërisë “Iliriada” SHPK, me vlerë xxxxxxxxxxx lekë me TVSh.
3. Procesverbal kolaudimi datë 06.07.2020
4. Situacion nr. 1
5. Faturë tatimore nr. 04, datë 31.03.2019 (situacionin nr. 1)
6. Situacion nr. 2 dhe përfundimtar
7. Faturë tatimore nr. 29, datë 30.06.2020 (situacion nr. 2 dhe përfundimtar)
8. Kontratë nënsipërmarrje datë 26.04.2018 e lidhur ndërmjet sipërmarrësi “Iliriada” SHPK për operatorin ekonomik “4 A-M” SHPK për objektin e kontratës “Realizim i punimeve civile në nënstacion dhe elektrike për ndërtimin e linjës së tensionit 110Kv-Nënstacioni i kaskadës së darsit-Carja mes Nënstacionit të Sucit dhe nënstacionit të Bulqizës (shtylla nr. 58)”, me vlerë xxxxxxxxxxx lekë me TVSh.
9. Formular vlerësimi lëshuar nga sipërmarrësi “Iliriada” SHPK për operatorin ekonomik “4 A-M” SHPK për objektin e kontratës “Realizim i punimeve civile në nënstacion dhe elektrike për ndërtimin e linjës së tensionit 110Kv-Nënstacioni i kaskadës së darsit-Carja mes Nënstacionit të Sucit dhe nënstacionit të Bulqizës (shtylla nr. 58)” në funksion të Ndërtimit të Hidrocentraleve Darsi 1, Darsi 2, Klos, Shqipëri”, data e fillimit të kontratës 26.04.2018, data e mbarimit të punimeve të kontratës 31.10.2018, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxxxxx lekë me TVSh, Vlerësimi: shumë mirë.
10. Akt kolaudimi 10.11.2018
11. Situacion progresim nr. 4
12. Faturë tatimore nr. 47, datë 31.10.2018 (Situacion progresim nr. 4)
13. Situacion progresiv nr. 3
14. Faturë tatimore nr. 46, datë 31.10.2018 (Situacion progresim nr. 3)
15. Situacion progresiv nr. 2
16. Faturë tatimore nr. 28, datë 30.10.2018 (Situacion progresim nr. 2)
17. Situacion nr. 1
18. Faturë tatimore nr. 16, datë 31.05.2018 (Situacion progresim nr. 1)

...............................

1. Kontratë pune me nr. 8274/10 prot., datë 24.05.2017 me objekt “Zgjatim i rrjetit 20KV nga F.53 Nst Shkozet, dhe ndërtimi i kabinave të reja dhe rrjetit TU për zonën Kantina e Verës, Tuneli i Trenit, Laboratori, Rrashbull”, lidhur midis operatorit ekonomik “4 A-M” SHPK dhe autoriteti kontraktor Operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike sh.a., me vlerë xxxxxxxxxxx lekë me TVSh.
2. Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike sh.a., për operatorit ekonomik “4 A-M” SHPK për objektin e kontratës “Zgjatim i rrjetit 20KV nga F.53 Nst Shkozet, dhe ndërtimi i kabinave të reja dhe rrjetit TU për

zonën Kantina e Verës, Tuneli i Trenit, Laboratori, Rrashbull", data e fillimit të kontratës 11.09.2017, data e mbarimit të punimeve të kontratës 11.12.2017, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik "4 A-M" SHPK 100%; Vlerësimi: e përmbushur.

3. Akt-kolaudimi nr. 26461/2 prot., datë 05.01.2018.
4. Situacion i punimeve përfundimtar
5. Faturë tatimore nr. 25 datë 10.11.2017 (situacioni nr. 1)
6. Faturë tatimore nr. 02 datë 03.01.2018 (situacioni përfundimtar)
7. Vërtetim për përmbushjen e garancisë së punimeve me nr. 1156/2 prot., datë 15.05.2020.

.......................................

1. Kontratë pune me nr. 3838/11 prot., datë 20.10.2020 me objekt "Ndërtim i linjës së re 110 kv. Me një qark Cërrik-Kajan-Kuçovë-Jagodinë dhe rehabilitimi i trakteve dalëse të linjave 110 Kv të N-stacioneve Cërrik dhe Kuçovë", lidhur midis bashkimi të operatorëve ekonomikë "4 A-M" SHPK & "Bonus" SHPK dhe autoriteti kontraktor Operatori i sistemit të Transmetimit (OST sha), me vlerë xxxxxxxxxxx lekë me TVSh.
2. Kontratë për bashkimin e përkohshëm të shoqërive, nr. 5371 Rep., Nr.1056 kol., datë 21.09.2020, ndërmjet operatorëve ekonomikë "Bonus" SHPK 2% dhe "4 A-M" SHPK 98%. Ku shoqëria "4 A-M" SHPK do të kontribuojë në masën 98 % në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indekset përkatëse, këto zëra punimesh [...].(aneksi 1, neni 4), Prokurë e posaçme Nr. 5372 Rep., Nr.1057 Kol. Datë 21.09.2020.
3. Procesverbal kolaudimi me nr. 1304/1 prot.,datë 13.03.2023.
4. Certifikatë marrje së përkohshme në dorëzim të punimeve me nr. 1304/2, datë 13.03.2023.
5. Situacioni përfundimtar i punimeve.
6. Fatura tatimore nr. 557/2023 datë 10.03.2023
7. Fatura tatimore nr. 65/2021 datë 26.08.2021
8. Fatura tatimore nr. 573/2021 datë 09.12.2021
9. Fatura tatimore nr. 698/2022 datë 04.05.2022
10. Fatura tatimore nr. 2218/2022 datë 03.10.2022
11. Fatura tatimore nr. 2524/2022 datë 10.11.2022
12. Fatura tatimore nr. 15 datë 22.10.2020

....................................

1. Kontratë Sipërmarrje objekti me nr. 27394/65 prot., datë 27.10.2020 me objekt "Ndërtim i godinës TIP në RSU Nr. 3 (Nr. 1)", ndërmjet autoritetit kontraktor Bashkia Tiranë dhe operatorit ekonomik "4 A-M" SHPK, me vlerë xxxxxxxxxxx lekë me TVSh.
2. Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë për operatorin ekonomik "4 A-M" SHPK për objektin e kontratës "Ndërtim i godinës TIP në RSU Nr. 3 (Nr. 1)", data e fillimit të kontratës 21.12.2020, data e mbarimit të punimeve të kontratës 27.01.2022, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga shoqëria "4 A-M" SHPK, ka realizuar 100 % të punimeve; Vlerësimi: Punimet janë kryer konform kontratës, së sipërmarrjes dhe kushteve teknike të zbatimit.
3. Akt kolaudimi
4. Situacion nr. 5

5. Situacion nr. 4
6. Situacion nr. 3
7. Situacion nr. 2
8. Situacion nr. 1
9. Faturë tatimore nr. 9/2021 datë 12.04.2021
10. Faturë tatimore nr. 21/2021 datë 14.06.2021
11. Faturë tatimore nr. 62/2021 datë 12.08.2021
12. Faturë tatimore nr. 741/2021 datë 24.12.2021
13. Faturë tatimore nr. 792/2022 datë 18.05.2022
14. Procesverbal marrje në dorëzim (përkohshme) datë 25.03.2022

.......................................

1. Kontratë Sipërmarrje objekti me nr. 11819/9 prot., datë 20.12.2018 me objekt "Rikonstruksion i rrjetit elektrik TM, TU në Qytetin Lezhë", ndërmjet autoritetit kontraktor OSHEE Operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike sh.a., dhe operatorit ekonomik "4 A-M" SHPK, me vlerë xxxxxxxxxxx lekë me TVSh.
2. Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor OSHEE Operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike për operatorin ekonomik "4 A-M" SHPK për objektin e kontratës "Rikonstruksion i rrjetit elektrik TM, TU në Qytetin Lezhë", data e fillimit të kontratës 06.03.2019, data e mbarimit të punimeve të kontratës 20.09.2019, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga shoqëria "4 A-M" SHPK, ka realizuar 100 % të punimeve; Vlerësimi e përmbushur.
3. Akt koladumi datë 21.10.2019
4. Procesverbali i marrjes në dorëzim të punimeve datë 02.11.2019
5. Procesverbal mbi përfundimin e punimeve datë 20.09.2019
6. Faturë tatimore nr. 26 datë 02.11.2019 (situcion përfundimtar)
7. Faturë tatimore nr. 15 datë 10.06.2019 (situcion nr. 2)
8. Faturë tatimore nr. 23 datë 06.04.2019 (situcion nr. 1)
9. Situacion përfundimtar
10. Akt kontrolli përfundimtar me nr. 2056/2 prot., datë 15.11.2021 i veprës për përmbushjen e kushteve të garancisë së punimeve.
11. Vërtetim me nr. 2056/3 datë 19.11.2021 për përmbushjen e kushteve të garancisë.

.........................................

1. Kontratë Sipërmarrje objekti me nr. 6086/10 prot., datë 08.10.2019 me objekt "Rrjeti 20 Kv i Fiderave T16, T17, T18, T19 nga Nënstacioni i ri 110/20 Kv Kombinat si dhe rrjeti TU me kabllo me vetëmbajtje tip ABC në kabinat e tyre Tiranë", ndërmjet autoritetit kontraktor OSHEE Drejtoria Rajonale Tiranë sh.a., dhe operatorit ekonomik "4 A-M" SHPK, me vlerë xxxxxxxxxxx lekë me TVSh.
2. Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor OSSH Drejtoria Rajonale Tiranë sh.a., për operatorin ekonomik "4 A-M" SHPK për objektin e kontratës "Rrjeti 20 Kv i Fiderave T16, T17, T18, T19 nga Nënstacioni i ri 110/20 Kv Kombinat si dhe rrjeti TU me kabllo me vetëmbajtje tip ABC në kabinat e tyre Tiranë", data e fillimit të kontratës 06.11.2019, data e mbarimit të punimeve të kontratës 07.07.2021, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga shoqëria "4 A-M" SHPK, ka realizuar 100 %

të punimeve; Vlerësimi : Punimet janë kryer sipas kërkesave të projektit dhe KTZ-së në fuqi.

3. Akt kolaudimi nr. 1883/2 prot., datë 23.07.2021
4. Situacion përfundimtar
5. faturë tatimore nr. 39/2021 datë 02.08.2021
6. Certifikatë e marrjes në dorëzim të punimeve me nr. 1883/4 prot., datë 05.08.2021.

.....................................

1. Kontratë Sipërmarrje objekti me nr. 3161/18 prot., datë 05.01.2021 me objekt "Ndërtim i rrjetit TM 20Kv, fideri F6, kabinave përkatëse dhe rrjeti TU me përcjellës ABC, N/ST Gjiri i Lalëzit, Loti II", ndërmjet autoritetit kontraktor OSSH Drejtoria Rajonale Durrës sh.a., dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë "4 A-M" SHPK & "Iliriada" SHPK, me vlerë xxxxxxxxxxx lekë me TVSh.
2. Kontratë për bashkimin e përkohshëm të shoqërive, nr. 8617 Rep., Nr.1528 kol., datë 10.12.2020, ndërmjet operatorëve ekonomikë "Iliriada" SHPK 5% dhe "4 A-M" SHPK 95%. Ku shoqëria "4 A-M" SHPK do të kontribuojë në masën 95 % në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indekset përkatëse, këto zëra punimesh [...].(neni 3), Prokurë e posaçme Nr. 8618 Rep., Nr.1529 Kol. Datë 10.12.2020.
3. Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor OSSH Drejtoria Rajonale Durrës sh.a., për operatorin ekonomik "4 A-M" SHPK për objektin e kontratës "Ndërtim i rrjetit TM 20Kv, fideri F6, kabinave përkatëse dhe rrjeti TU me përcjellës ABC, N/ST Gjiri i Lalëzit, Loti II", data e fillimit të kontratës 05.02.2021, data e mbarimit të punimeve të kontratës 04.06.2021, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga shoqëria "4 A-M" SHPK, ka realizuar 95 % të punimeve; Vlerësimi: Realizuar konform kushteve teknike dhe kërkesave ligjore, e përmbushur.
4. Akt kolaudimi nr. 316/35 prot., datë 30.06.2021.
5. Situacion përfundimtar
6. Faturë tatimore nr. 19, datë 30.06.2021.
7. Certifikatë e marrjes në dorëzim të punimeve me nr. 3161/37 prot., datë 19.07.2021.

...........................................

1. Kontratë Sipërmarrje objekti me nr. 335/17 prot., datë 18.06.2021 me objekt "Rikonstruksion i N/Stacionit Vorës 35/20/6 Kv", ndërmjet autoritetit kontraktor Drejtoria e Tensionit të Lartë OSSH sha., dhe operatorit ekonomik "4 A-M" SHPK, me vlerë xxxxxxxxxxx lekë me TVSh.
2. Modifikim kontrate me nr. 335/79 prot., datë 28.06.2022 referuar Kontratë Sipërmarrje objekti me nr. 335/17 prot., datë 18.06.2021 me objekt "Rikonstruksion i N/Stacionit Vorës 35/20/6 Kv", ndërmjet autoritetit kontraktor Drejtoria e Tensionit të Lartë OSSH sha., dhe operatorit ekonomik "4 A-M" SHPK.
3. Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Tensionit të Lartë OSSH sha për operatorin ekonomik "4 A-M" SHPK për objektin e kontratës "Rikonstruksion i N/Stacionit Vorës 35/20/6 Kv", data e fillimit të kontratës 19.07.2021, data e mbarimit të punimeve të kontratës 12.07.2022, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga shoqëria "4 A-M" SHPK, ka realizuar 100 % të punimeve; Vlerësimi: Punimet janë kryer sipas kërkesave të projektit dhe KTZ-së në fuqi.
4. Akt kolaudimi me nr. 355/80 prot., datë 09.08.2022.

5. Situacion përfundimtar
6. Faturë tatimore nr. 1815/2022 datë 12.08.2022.

7. Procesverbal me nr. 335/82 prot., datë 10.08.2022 Mbi marrjen në dorëzim të punimeve.

III.3.4. Në nenin 77 te ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*
*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*
*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*
*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*
*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*
*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

III.3.5. Në nenin 39 "*Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike*" pika 5 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", e ndryshuar,* parashikohet se:
*"5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*
*a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;*
*b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*
*Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.*
*Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.*
*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera,*

*afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve."*

III.3.6. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit KPP vëren, se autoriteti kontraktor në kapacitetin teknik ka kërkuar shprehimisht që *"Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën: a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo me te vogel se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: 45,758,074 (dyzet e pesë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates. b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më te vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: 183,032,296 (njëqind e tetëdhjetë e tre milion e tridhjetë e dy mijë e dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH. Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. [...]"*

III.3.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.
Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.3.8. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, për kontratat për punë publike, për të provuar përvojën e ngjashme operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë njërin prej dy kushteve të përcaktuara në nenin 39 pika 5 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", e ndryshuar*, ku operatori ekonomik duhet të provojë se ka kryer punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; ose të provojë se ka kryer punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.
Sa më sipër, referuar kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor për sa i përket eksperiencës së ngjashme, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik "4 A-M" SHPK, konstatojmë, se ky i fundit nuk përmbush kushtin e parë të vendosur nga autoriteti kontraktor për një për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë

viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kështu që rrjedhimisht KPP verifikoi dokumentacionin e dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “4 A-M” SHPK për plotësimin e kushtit të dytë: “*Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e kontratave të punëve të kryera dhe të realizuara, të marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës të procedurës së prokurimit është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet”.*

Sa më sipër, nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ky i fundit në Sistemin e Prokurimit Publik, konstatohet, se operatori ekonomik “4 A-M” SHPK për secilën nga punët e ngjashme të deklaruara, ka paraqitur dokumentacionin përkatës të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Konkretisht ka paraqitur:

-Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor OSSH Sha Drejtoria Rajonale Fier për bashkimit të operatorëve ekonomikë “Iliriada” SHPK dhe “4 A-M” SHPK për objektin e kontratës “*Rikonstruksion i kabinave 6/0.4 KV dhe linjave TU, 0.4Kv te fiderit 26, 6 KV, Nenstacioni Kafaraj*”, data e fillimit të kontratës 26.07.2021, data e mbarimit të punimeve të kontratës 04.02.2022, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga shoqëria ekonomikë “Iliriada” SHPK 20% dhe “4 A-M” SHPK 80%; *Vlerësimi: Kontrata e përmbushur sipas specifikimeve teknike, preventivit dhe projektit përkatës* si dhe dokumentacionin shoqërues siç kërkohet në dokumentet e tenderit si Kontratë Sipërmarrje, Situacion përfundimtar, Akt Kolaudimi, Certifikatën e marrjes në dorëzim objekti, fatura tatimore si dhe Kontratën e Bashkimit të operatorëve ekonomikë me prokurën e posaçme.

-Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor OSHEE Sha Drejtoria Rajonale Tiranë për operatorit ekonomik “4 A-M” SHPK për objektin e kontratës “*Ndërtim i Fiderit 20 KV S1 dhe S2 të Nënstacionit 110/20/10 KV Selitë, Kabina të reja dhe kabina rikonstruksion si dhe Linja TU me kabull ABC” (punëtori),* data e fillimit të kontratës 10.07.2018, data e mbarimit të punimeve të kontratës 10.10.2018, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga shoqëria “4 A-M” SHPK 100%; *Vlerësimi: Objekti është realizuar në përputhje me kushtet teknike të zbatimit dhe të projektimit* si dhe dokumentacionin shoqërues siç kërkohet në dokumentet e tenderit si Kontratë Sipërmarrje, Situacion përfundimtar, situacion nr. 1, situacion nr.2, situacion nr. 3 Akt Kolaudimi, Certifikatën e marrjes në dorëzim objekti, Fatura tatimore.

-Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor OSHEE Sha Drejtoria Rajonale Shkodër për operatorit ekonomik “4 A-M” SHPK për objektin e kontratës “Loti II: Rikonstruksion i rrjetit ajror TM, rikonstruksion i tete Kabinave dhe ndërtim i dy kabinave Fidri 10Kv Zejmen Nënstacioni 110/10kv Lezhë)”, data e fillimit të kontratës 03.10.2018, data e mbarimit të punimeve të kontratës 01.12.2018, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga shoqëria “4 A-M” SHPK 100%; *Vlerësimi: Objekti është realizuar në përputhje me kushtet teknike të zbatimit dhe të projektimit* si dhe dokumentacionin shoqërues siç kërkohet në dokumentet e tenderit si Kontratë Sipërmarrje, Situacion përfundimtar, situacion nr. 1, situacion nr.2, situacion nr. 3 Akt Kolaudimi, Certifikatën e marrjes në dorëzim objekti, Vërtetim për përmbushjen e kushteve të garancisë, formular i sigurimit të kontratës, akt kontrolli përfundimtar për përmbushjen e kushteve të garancisë, Fatura tatimore.

Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor OSSH Sha Drejtoria Rajonale Elbasan për bashkimin e operatorëve ekonomikë “Iliriada” SHPK & “4 A-M” SHPK për objektin e

kontratës "Rikonstruksion i rrjetit TU me kabull ABC në Belsh, si dhe kabinave gjatë rrugës kryesore Elbasan-Peqin", data e fillimit të kontratës 30.12.2020, data e mbarimit të punimeve të kontratës 12.07.2021, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "Iliriada" SHPK & "4 A-M" SHPK 100%; *Vlerësimi: Objekti është realizuar në përputhje me kushtet teknike të zbatimit dhe të projektimit* si dhe dokumentacionin shoqërues siç kërkohet në dokumentet e tenderit si Kontratë Sipërmarrje, Situacion përfundimtar, situacion nr. 1, situacion nr.2, Akt Kolaudimi, Certifikatën e marrjes në dorëzim objekti, Vërtetim për përmbushjen e kushteve të garancisë, Fatura tatimore.

Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor OSHEE Sha Drejtoria Rajonale Tiranë për operatorit ekonomik "4 A-M" SHPK për objektin e kontratës "Zëvendësimi i rrjetit ekzistues 6KV në rrjet me tension 20 Kv të Fiderit 248 N/Stacionit Dinamo", data e fillimit të kontratës 22.05.2019, data e mbarimit të punimeve të kontratës 02.10.2019, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik "4 A-M" SHPK 100%; *Vlerësimi: Objekti është realizuar në përputhje me kushtet teknike të zbatimit dhe të projektimit* si dhe dokumentacionin shoqërues siç kërkohet në dokumentet e tenderit si Kontratë Sipërmarrje, preventiv nr.1, nr.2, nr.3, Situacion përfundimtar, situacion nr.1, situacion nr.2, Akt Kolaudimi, Certifikatën e marrjes në dorëzim objekti, Vërtetim për përmbushjen e kushteve të garancisë, akt - kontrolli përfundimtar për përmbushjen e kushteve të garancisë së punimeve, Fatura tatimore.

-Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor OSSH Sha Drejtoria Rajonale Burrel për operatorit ekonomik "4 A-M" SHPK për objektin e kontratës "Rikonstruksioni i rrjetit TU ABC dhe ndërtim i kabinave shtyllore, në Agjencinë e Bulqizë Drejtoria Rajonale Burrel", data e fillimit të kontratës 23.06.2021, data e mbarimit të punimeve të kontratës 28.10.2021, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik "4 A-M" SHPK 100%; *Vlerësimi: Punimet janë kryer sipas kërkesave të projektit dhe KTZ-së në fuqi* si dhe dokumentacionin shoqërues siç kërkohet në dokumentet e tenderit si Kontratë Sipërmarrje, Situacion përfundimtar, Akt Kolaudimi, Certifikatën e marrjes në dorëzim objekti, Fatura tatimore.

-Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor OSSH Sha Drejtoria Rajonale Tiranë për operatorit ekonomik "4 A-M" SHPK për objektin e kontratës "Kthim në 20 Kv i një pjese të Fiderit 126 nënstacioni Kinostudio, Tiranë", data e fillimit të kontratës 30.08.2021, data e mbarimit të punimeve të kontratës 30.06.2022, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik "4 A-M" SHPK 100%; *Vlerësimi: Punimet janë kryer sipas kërkesave të projektit dhe KTZ-së në fuqi* si dhe dokumentacionin shoqërues siç kërkohet në dokumentet e tenderit si Kontratë Sipërmarrje, Situacion përfundimtar, Akt Kolaudimi, Certifikatën e marrjes në dorëzim objekti, Fatura tatimore.

Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor OSSH Sha Drejtoria Rajonale Tiranë për operatorit ekonomik "4 A-M" SHPK për objektin e kontratës "Kthim në 20 Kv i një pjese të Fiderit 126 nënstacioni Kinostudio, Tiranë", data e fillimit të kontratës 30.08.2021, data e mbarimit të punimeve të kontratës 30.06.2022, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik "4 A-M" SHPK 100%; *Vlerësimi: Punimet janë kryer sipas kërkesave të projektit dhe KTZ-së në fuqi* si dhe dokumentacionin shoqërues siç kërkohet në dokumentet e tenderit si Kontratë nënsipërmarrje, shtesë kontratës bazë, Situacion përfundimtar, procesverbal kolaudimi, Fatura tatimore.

- Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike sh.a., për operatorit ekonomik “4 A-M” SHPK për objektin e kontratës “Zgjatim i rrjetit 20KV nga F.53 Nst Shkozet, dhe ndërtimi i kabinave të reja dhe rrjetit TU për zonën Kantina e Verës, Tuneli i Trenit, Laboratori, Rrashbull”, data e fillimit të kontratës 11.09.2017, data e mbarimit të punimeve të kontratës 11.12.2017, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik “4 A-M” SHPK 100%; *Vlerësimi: e përmbushur* si dhe dokumentacionin shoqërues siç kërkohet në dokumentet e tenderit si Kontratë Sipërmarrje, Situacion përfundimtar, Akt Kolaudimi, vërtetim për përmbushjen e kushteve të garancisë, Fatura tatimore.
-Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë për operatorin ekonomik “4 A-M” SHPK për objektin e kontratës “Ndërtim i godinës TIP në RSU Nr. 3 (Nr. 1)”, data e fillimit të kontratës 21.12.2020, data e mbarimit të punimeve të kontratës 27.01.2022, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga shoqëria “4 A-M” SHPK, ka realizuar 100 % të punimeve; *Vlerësimi: Punimet janë kryer konform kontratës, së sipërmarrjes dhe kushteve teknike të zbatimit* si dhe dokumentacionin shoqërues siç kërkohet në dokumentet e tenderit si Kontratë Sipërmarrje, Situacion përfundimtar, Akt Kolaudimi, procesverbal marrje në dorëzim (të përkohshëm), Fatura tatimore.
-Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor OSHEE Operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike sh.për operatorin ekonomik “4 A-M” SHPK për objektin e kontratës “Rikosntruksion i rrjetit elektrik TM, TU në Qytetin Lezhë”, data e fillimit të kontratës 06.03.2019, data e mbarimit të punimeve të kontratës 20.09.2019, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga shoqëria “4 A-M” SHPK, ka realizuar 100 % të punimeve; *Vlerësimi e përmbushur* si dhe dokumentacionin shoqërues siç kërkohet në dokumentet e tenderit si Kontratë Sipërmarrje, Situacion përfundimtar, Akt Kolaudimi, procesverbal marrje në dorëzim, Akt kontrolli përfundimtar i veprës për përmbushje e kushteve të garancisë së punimeve, Fatura tatimore.
-Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor OSSH Drejtoria Rajonale Tiranë sh.a., për operatorin ekonomik “4 A-M” SHPK për objektin e kontratës “Rrjeti 20 Kv i Fiderave T16, T17, T18, T19 nga Nënstacioni i ri 110/20 Kv Kombinat si dhe rrjeti TU me kabllo me vetëmbajtje tip ABC në kabinat e tyre Tiranë”, data e fillimit të kontratës 06.11.2019, data e mbarimit të punimeve të kontratës 07.07.2021, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga shoqëria “4 A-M” SHPK, ka realizuar 100 % të punimeve; *Vlerësimi : Punimet janë kryer sipas kërkesave të projektit dhe KTZ-së në fuqi* si dhe dokumentacionin shoqërues siç kërkohet në dokumentet e tenderit si Kontratë Sipërmarrje, Situacion përfundimtar, Akt Kolaudimi, procesverbal marrje në dorëzim, Vërtetim për përmbushjen e kushteve të garancisë, Fatura tatimore.
- Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor OSSH Drejtoria Rajonale Durrës sh.a., për operatorin ekonomik “4 A-M” SHPK për objektin e kontratës “Ndërtim i rrjetit TM 20Kv, fideri F6, kabinave përkatëse dhe rrjeti TU me përcjellës ABC, N/ST Gjiri i Lalëzit, Loti II”, data e fillimit të kontratës 05.02.2021, data e mbarimit të punimeve të kontratës 04.06.2021, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga shoqëria “4 A-M” SHPK, ka realizuar 95 % të punimeve; *Vlerësimi: Realizuar konform kushteve teknike dhe kërkesave ligjore, e përmbushur* si dhe dokumentacionin shoqërues siç kërkohet

në dokumentet e tenderit si Kontratë Sipërmarrje, Situacion përfundimtar, Akt Kolaudimi, certifikatë marrje në dorëzim, Fatura tatimore.
- Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Tensionit të Lartë OSSH sha për operatorin ekonomik "4 A-M" SHPK për objektin e kontratës "Rikonstruksion i N/Stacionit Vorës 35/20/6 Kv", data e fillimit të kontratës 19.07.2021, data e mbarimit të punimeve të kontratës 12.07.2022, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga shoqëria "4 A-M" SHPK, ka realizuar 100 % të punimeve; *Vlerësimi: Punimet janë kryer sipas kërkesave të projektit dhe KTZ-së në fuqi* si dhe dokumentacionin shoqërues siç kërkohet në dokumentet e tenderit si Kontratë Sipërmarrje, modifikim kontrate, Situacion përfundimtar, Akt Kolaudimi, certifikatë marrje në dorëzim, Fatura tatimore..
Sa më sipër, referuar kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor për sa i përket kontratave të ngjashme, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik "4 A-M" SHPK, konstatojmë, se ky i fundit nuk ka paraqitur një kontratë të ngjashme për një objekt të vetëm në vlerën jo më të vogël se 50 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që do të prokurohet, siç është kërkuar në dokumentet e tenderit. Kështu që, rrjedhimisht KPP verifikoi plotësimin e kushtit të dytë "Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më te vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

III.3.9. Sa më lart, nga verifikimi i punëve të realizuara dhe dokumentacionit shoqërues të tyre, të paraqitur si dëshmi për eksperiencat e mëparshme të ngjashme, konstatohet se operatori ekonomik ankimues ka kryer punime të ngjashme me zërat në preventivin e hartuar nga autoriteti kontraktor për këtë procedurë prokurimi.
KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit.
Sa më sipër, nisur nga arsyeja e skualifikimit, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale, por të analizojë në themel dhe në mënyrë të arsyeshme e proporcionale eksperiencat e dokumentuara nga ofertuesit/kandidatët, në funksion të qëllimit dhe rrethanave faktike për të cilin vendosen kriteret e përcaktuara.
Pra, për të plotësuar pikën e mësipërme të kërkesave për kualifikim për eksperiencën e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet dhe jo kontrata të njëjta, pasi për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Sa më sipër, KPP konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik ankimues vërteton se ka kryer punime të ngjashme me zërat e parashikuara për kontratën objekt - shqyrtimi.

Gjithashtu, nga përllogaritja e vlerës së punëve të ngjashme të paraqitura nga operatori ekonomik ankimues, duke e përllogaritur sipas përqindjes së pjesëmarrjes së këtij të fundit në secilën prej kontratave të paraqitura, vlen të theksohet, se vlera e përgjithshme e punimeve të ngjashme të realizuara në dokumentet e paraqitura nga ky operator ekonomik, e tejkalon vlerën prej **1,607,414,214.60** lekë pa TVSH, të përcaktuar nga autoriteti kontraktor .
Nga verifikimi i zërave dhe volumeve të ngjashme të preventivit të kontratave të paraqitura nga ankimuesi si eksperienca të ngjashme të mëparshme, nga përllogaritja e zërave të ngjashëm për sa i përket llojit, tipologjisë, emërtimit/përshkrimit, me zërat e preventivit të kontratës objekt shqyrtimi, rezulton se operatori ekonomik ankimues ka arritur të dëshmojë se ka kryer kontrata të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit në vlerën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi zërat e konsideruar të ngjashëm përmbushin vlerën prej **1,607,414,214.60** lekë pa TVSH, sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.
Ndërsa lidhur me Kontratë nënsipërmarrje datë 26.04.2018 "Realizim i punimeve civile në nënstacion dhe elektrike për ndërtimin e linjës së tensionit 110Kv-Nënstacioni i kaskadës së darsit-Carja mes Nënstacionit të Sucit dhe nënstacionit të Bulqizës (shtylla nr. 58)", *me vlerë të realizuar* XX,XXX,XXX *lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacione, akt kolaudim, certifikate e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.,* Komisioni Prokurimit Publik nuk do ta marrë në shqyrtim në themel këtë kontratë, por në këtë rast është deklaruar si një kontratë e lidhur midis dy subjekteve private, ku subjekti "Iliriada" SHPK është në rolin e sipërmarrësit dhe subjekti "4 A-M" në rolin e nënsipërmarrësit. Për sa kohë që Komisioni Prokurimit Publik nuk ka informacion nëse në procedurën e prokurimit të kësaj kontrate autoriteti kontraktor ka lejuar nënkontraktimin, atëherë nuk mund ta marrë në konsideratë atë, por edhe në rast se operatori ekonomik, i cili kishte barrën e provës në kuptim të nenit 82 pika 1 "*Barra Provës*" të ligjit 44/2015 "*Kodi Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*" për të vërtetuar këtë fakt do të kishtë paraqitur fakte dhe prova, sërish komisioni nuk do ta kishte marrë në konsideratë, pasi nga shqyrtimi i kontratës rezulton, se kjo kontratë e lidhur midis dy subjekteve private është lidhur në vlerën e plotë prej *308'335'113 (kontratë bazë dhe shtesë kontrate),* ndërkohë që në nenin 61 "Nënkontraktimi" i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar (ligj ky në fuqi në kohën e lidhjes së kësaj kontrate) shprehimisht përcaktohej se *Autoriteti kontraktor, në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit, u kërkon ofertuesve të tregojnë në ofertat e tyre përqindjen e kontratës, që ata mendojnë të nënkontraktojnë te palët e treta, si dhe nënkontraktorin e propozuar. Kjo përqindje e caktuar për nënkontraktim duhet të jetë në përpjesëtim me vlerën e kontratës dhe nuk duhet të tejkalojë 40 përqind të vlerës së përgjithshme të kontratës. Autoriteti kontraktor miraton nënkontraktorët e mundshëm përpara lidhjes së nënkontratës me operatorin ekonomik fitues të kontratës publike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, pa cenuar parimet e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni.* Sa më sipër, nga përllogaritjet e kryera nga Komisioni për kontratat e ngjashme të marra në shqyrtim rezulton, se operatori ekonomik "4 A-M" SHPK, sipas në secilën prej kontratave të paraqitura, vlen të theksohet, se vlera e përgjithshme e punimeve të ngjashme të realizuara në dokumentet e paraqitura nga ky operator ekonomik është 1,607,414,214.60 lekë pa TVSH, duke tejkaluar vlerën prej 1,299,991,026 lekë pa TVSH që duhet të plotësonte ky operator, duke e përmbushur kriterin në lidhje me eksperiencën e ngjashme, në vlerën e kërkuar në kriteret e kualifikimit *punë të ngjashme deri në një kufi, ku*

*vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.* Rrjedhimisht ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nga operatori ekonomik ”4 A-M” SHPK.

III.3.10. Nisur nga sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, për të vërtetuar eksperiencën e mëparshme, është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se kontratat e paraqitura nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotësojnë kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Në këto kushte, KPP gjykon, se operatori ekonomik ankimues e ka përmbushur kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor për sa i përket eksperiencës së mëparshme të ngjashme.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik “4 A-M” ShPK qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “ENBI POWER” SHPK & “Aci Enginnering” SHPK se ““• *Në pikën 2/1/a të kritereve të veçanta është kërkuar: ‘’Ofertuesi duhet të paraqesë: Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8’’.*

*Referuar nenit 84/3 dhe 84/4 të LPP dhe nenit 90/2 të VKM nr. 285, detyrimin e paraqitjes së këtij formulari e kanë edhe subjektet mbështetëse të një ofertuesi në një procedurë prokurimi. Kjo gjë është specifikuar edhe në kriteret e përgjithshme të pranimit, ku është cilësuar se ‘’ Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.*
*Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur. Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës’’.*
*Në rastin konkret, BOE “Aci engineering’’ Shpk & ENBI POWER kanë deklaruar 2 subjekte mbështetës (AM RENTALS dhe Mimoza Gjani), por për asnjë prej tyre nuk është paraqitur shtojca nr. 8, për të vërtetuar plotësimin e nenit 84/4 të LPP dhe nenit 90/2 të VKM nr. 285”,* Komisioni konstaton se:

III.4.1. Në shtojcën 7, tek “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:
*Ofertuesi deklaron se:*

*a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*
*b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);*
*c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;*
*ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda*

*Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;*
*d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;*
*dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;*
*e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.*
*f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;*
*g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;*
*gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;*
*h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.*
*i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.*

*Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.*

*Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.*

*Në rast te bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.*

*Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.*

***Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.***

***Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.***

*Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :*

- *Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.*

- *Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e*

*nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.*

Ndërsa, në shtojcën 7, tek "Kriteret e veçanta të kualifikimit", pika 1/a, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

***1. Ofertuesi duhet të paraqesë:***

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8,*

III.1.2. Në shtojcën 8 "Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit", autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

***Shtojca 8***

*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)*

*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*

*I. Unë i nënshkruari _______________ në cilësinë e _________________të operatorit ekonomik _______________________ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:*

*PJESA I: A.* ***INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK***

| ***Identifikimi*** | ***Përgjigjja*** |
|---|---|
| *Emri i operatorit ekonomik:*<br>*(Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)* | ------------------------------------------------ |
| *Numri NIPT/et:* | --------------------------------------------------<br>- |
| *Adresa postare:*<br>*Qyteti / qyteti; Kodi postar* | --------------------------------------------------<br>---- |
| *Përfaqësuesi (emri):* | -------------------------------------------- |
| *Telefoni:* | --------------------------------------------------<br>--- |
| *E-mail:* | --------------------------------------------------<br>-------- |

***B: DEKLARATË***

***Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)***

*Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:*

- ***Informacione për nënkontraktorin***

| ***Emri i nënkontrakto*** | ***NIPT –i*** | ***Përqindja e nënkontraktimit*** | ***Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar*** |
|---|---|---|---|

| | | | |
|---|---|---|---|
| ***rit të propozuar*** | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

- ***formacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik***

| ***Emri (at) e subjekteve*** | ***NIPT-i*** | ***Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik*** | ***Specifiko konkretisht kapacitetin/et*** |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

***Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit***

***A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT***

| ***Deklarata*** |
|---|
| *Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.*<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*<br>________________________________________________________ |
| *Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.*<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*<br>________________________________________________________ |
| *Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:* |

| |
|---|
| *etj.*<br>*nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.*<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*<br>____________________________________________ |
| *Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.*<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*<br>____________________________________________ |
| *Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).*<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*<br>____________________________________________ |
| *Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së*<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*<br>____________________________________________ |
| *Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.*<br>*Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.*<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*<br>____________________________________________ |
| *Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.*<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*<br>____________________________________________ |
| *Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.*<br>*Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.* |

| |
|---|
| *Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ___________________________________________ |

***B: DEKLARATA***

*Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", bëj këtë deklarim dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:*

19. *Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;*

20. *Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s'kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;*

21. *Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;*

22. *Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës,është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;*

23. *Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala "konkurrentë" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:*

    e) *paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;*
    f) *është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.*

24. *Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):*

    a) *Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;*
    ☐
    b) *Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më*

*shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).*

□

25. *Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:*

    i) *çmimet ;*
    j) *metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;*
    k) *qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,*
    l) *paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.*

26. *Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).*

27. *Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).*

***C: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT***

| *Deklarata* |
|---|
| *Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:*<br>*Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.* |
| *Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:*<br>*Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca;* |

*telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtori i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.*

*Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.*

*Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).*

*Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.*

*Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".*

*Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.*

***D: DEKLARATA "Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës"***

***Deklarata***

*Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:*

- *Operatori ekonomik _________________________garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.*

- *Operatori ekonomik____________________lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.*

- *Operatori ekonomik _________________nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur*

| |
|---|
| *janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.*<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*<br>_______________________________________________ |

***Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit***

***A: DEKLARATË***

***"Per permbushjen e specifikimeve teknike dhe grafikut e realizimit të objektit të kontratës"***

| ***Deklarata*** | ***Përgjigje*** |
|---|---|
| *Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me preventivin e punimeve dhe grafikun e zbatimit të punimeve të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.* | *Po [ ] Jo [ ]* |

***B: DEKLARATË "Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate"***

| ***Deklarata*** | ***Përgjigje*** |
|---|---|
| *Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:*<br>*Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.* | ***Punonjës***<br>*Po [ ] Jo [ ]*<br>*Nëse, po, numri i punonjësve*<br>*Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatese:*<br><br>*.__________________________,me profesion_______________, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e ____________________,*<br><br>*. __________________________,me profesion_______________, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e ____________________,*<br><br>*.__________________________,me* |

| | |
|---|---|
| | *profesion________________, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____________________,*<br>***Makineri e mjete***<br>*Po [ ] Jo [ ]*<br>*Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete* |

***C: DEKLARATË***

***"Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate"***

*Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se, kam në dispozicion dhe/ose do te me vihen ne dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën, si me poshte:*

| ***Në pronësi*** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ***Lloji i Mjetit*** | ***Targa*** | ***Nr. Lejes qarkullimit*** | ***Nr. Shasisë*** | ***Të tjera*** |
| *1* | | | | |
| *2* | | | | |
| *3* | | | | |
| *4* | | | | |
| *5* | | | | |

| ***Me qira*** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| ***Lloji i Mjetit*** | ***Targa e mjetit*** | ***Nr. Lejes qarkullimit të mjetit*** | ***Nr. Shasisë së mjetit*** | ***Nr. Kont së qerasë (noterisë)*** | ***Afati i kontratës qerasë(data e fillimit dhe mbarimit)*** |
| *1* | | | | | |
| *2* | | | | | |
| *3* | | | | | |
| *4* | | | | | |
| *5* | | | | | |
| *6* | | | | | |

| ***Kontratë furnizimi*** | |
|---|---|
| | |

| ***Materiali/produkti për të cilin paraqitet kontrata e furnizimit*** | ***Nr. Kont së furnizimit (noterisë)*** | ***Afati i kontratës furnizimit (data e fillimit dhe mbarimit)*** | ***Të tjera*** | |
|---|---|---|---|---|
| *1.* | | | | |
| *2* | | | | |
| *3* | | | | |
| *4* | | | | |

*D.* ***Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera***

| |
|---|
| ***Deklarata***<br>*Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:*<br>*Mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruara në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jene ne dispozicion gjatë zbatimit të kontratës sipas grafikut te punimeve.*<br><br>*Nëse kërkohet, stafi teknik i poshtëshënuar:*<br>*Z. ___________________________,me profesion________________, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e ____________________,*<br>*etj .,*<br>*i deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.* |
| ***Emri, Mbiemri________________***<br>***Firma _______________________***<br>***Vula__________________________***<br>***Data e dorëzimit të deklaratës _________________*** |

**Ju lutemi sigurohuni që:**

- **Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.**

- **Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.**

- **Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.**

- **Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.**

**Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.**

- ***Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.***
- ***Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.***

III.4.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "ENBI POWER" SHPK & "Aci Enginnering" SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur në SPE dokumentacion si më poshtë vijon:

-Formular Vetëdeklarimi për operatorin ekonomik "Enbi Power" SHPK;
-Formular Vetëdeklarimi për operatorin ekonomik "Aci Engneering" SHPK;
-Kontratë të përkohshme bashkëpunimi me datë 08.09.2023 të lidhur midis shoqërisë "Enbi Power" SHPK & "Aci Engeering" SHPK;
-Deklaratë nga subjektet *AM RENTALS dhe Mimoza Gjani të datës 08.09.2023.*

III.4.4. Në nenin 76 "*Kriteret detyruese për skualifikim*", të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik"* përcaktohet se:
*1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:*
*a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
*b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
*c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
*ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*

*d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
*dh) falsifikim;*
*e)puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.*
*Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.*
*2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur:*
*a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;*
*b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit;*
*c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;*
*ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.*
*3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:*
*a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;*
*b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja "ç", të këtij ligji;*
*c) operatori ekonomik është shpallur fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;*
*ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;*
*d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;*

*dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;*
*e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate, për të cilën është përjashtuar sipas parashikimeve në shkronjën "b" të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji.*
*ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kritereve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;*
*f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.*
*g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.*
*4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.*
*5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.*
*6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim.*
*Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një vepre penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera.*
*Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.*

*7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit apo koncesionit, nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.*

III.4.5. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 "*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*", të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*" përcaktohet se: "*1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.*
*2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.*

III.4.6. Në nenin 84 "*Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera*", të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*" përcaktohet se:
*"1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta.*
*2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t'i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë.*
***3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.***
***4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij.***
***Autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit.***
*5. Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e marrëveshjes.*
*6. Ndërkohë, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen*

*këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm.*
*7. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që detyra/punë/aspekte kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ofertues."*

III.4.7. Në nenin 26 "*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*", pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*"1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave,* ***autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla****.*
*2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:*
*a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*
*b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*
*c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*
*ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;*
*d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;*
*dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;*
*e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;*
*ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit te interesit, sipas legjislacionit në fuqi;*
*f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;*
*g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;*
*gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;*

*h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);*
*i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;*
*j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;*
*k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.*
*3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*
*4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.*
*5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.*
*6**. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.***

III.4.8. Në nenin 90 "*Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera*" të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*"1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.*
*2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:*
*- ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;*
*- t´i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.*
*- t´i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.*
*- Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.*
*3. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale, atëherë shërbimet, për të cilat kërkohet një aftësi e tillë ose punët do të kryhen nga subjekti tjetër.*

*4. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e një subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e kontratës.*
*5. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm.*
*6. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti/enti kontraktor, mund të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ofertuesi. Ky informacion publikohet në dokumentet e tenderit.*
*7. Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit.*
*Subjekti mbështetës nuk mund të mbështesë më shumë se një operator ekonomik në të njëjtën procedurë prokurimi."*

III.4.9. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues se arsyeja e skualifikimit *"Në pikën 2/1/a të kritereve të veçanta është kërkuar: ''Ofertuesi duhet të paraqesë: Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8''. Referuar nenit 84/3 dhe 84/4 të LPP dhe nenit 90/2 të VKM nr. 285, detyrimin e paraqitjes së këtij formulari e kanë edhe subjektet mbështetëse të një ofertuesi në një procedurë prokurimi. Kjo gjë është specifikuar edhe në kriteret e përgjithshme të pranimit, ku është cilësuar se '' Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.*
*Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur. Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës''.*
*Në rastin konkret, BOE "Aci engineering'' Shpk & ENBI POWER kanë deklaruar 2 subjekte mbështetës (AM RENTALS dhe Mimoza Gjani), por për asnjë prej tyre nuk është paraqitur shtojca nr. 8,* Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "Enbi Power" SHPK & "Aci Engeneering" SHPK, konstaton se këto të fundit kanë paraqitur Formularët Përmbledhës të Vetëdeklarimit të secilit, ku në Pjesa I, pika B, është dhënë informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet bashkimi i operatorëve ekonomikë "Enbi Power" SHPK & "Aci Engeneering" SHPK. Konkretisht, tek operatorët ekonomikë *AM RENTALS dhe Mimoza Gjani*.
Nisur nga arsyeja e skualifikimit, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, konstatohet se këto të fundit, për operatorët ekonomikë *AM RENTALS dhe Mimoza Gjani*., si subjekte mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështeten, kanë paraqitur një Letër angazhimi..

Komisioni gjykon, se referuar nenit 76, pika 1 të LPP-së, përcaktohen disa nga arsyet për skualifikimin e një operatorit ekonomik nga një procedurë prokurimi, konkretisht "*Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme: a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; c) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; dh) falsifikim; e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij".* Ndërsa në nenin 26 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit", pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se, për pikën 1 të nenit 76 të Ligjit "Për Prokurimin Publik", nga ana e operatorit ekonomik duhet të plotësohet formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82 të LPP-së, dhe në rregullat e prokurimit publik.

Referuar dokumenteve të tenderit, në shtojcën 8 "Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit", në pjesën e fundit përcaktohet, se, "*në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës".*

Në procedurën objekt-shqyrtimi, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues "Enbi Power" SHPK& "Aci Engeneering" SHPK, kanë deklaruar si një nga subjektet në kapacitetet e të cilit do të mbështetet, operatorët ekonomikë "*AM RENTALS dhe Mimoza Gjani PF*", ku kanë paraqitur formularët e vetdeklarimit të secilit ku kanë deklaruar se, për këto subjekte nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikim ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.

Në këtë kontekst, KPP, nisur nga arsyeja e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, gjykon, se në pikën 1, 3 dhe 4 të nenit 84 "Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera", të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" përcaktohet se: *"1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta.*

*3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.*

*4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit."*

Pra, në rastin konkret, në arsyen e skualifikimit, autoriteti kontraktor pretendon se subjekti "*AM RENTALS dhe Mimoza Gjani*, në kapacitetet e të cilit do të mbështetet bashkimi i operatorëve ekonomikë "Enbi Power" SHPK & "Aci Engeneering" SHPK, nuk ka plotësuar sipas kërkesave ligjore Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, pasi nuk ka deklaruar "*Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, qe nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.",* ndërkohë që, referuar pikës 4 të nenit 84 të LPP-së, përcaktohet, se autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij dhe në ato raste kur vërteton se këto shkaqe ekzistojnë, autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit.

Në rastin konkret, nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, për këtë procedurë prokurimi, nuk vërtetohet në asnjë moment që autoriteti kontraktor, në lidhje me shkaqet e mësipërme për skualifikim të ketë kryer veprimet procedurale të parashikuara në pikën 4 të nenit 84 të LPP-së, duke i kërkuar operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit. Për këtë arsye, për sa kohë, nga ana e autoritetit kontraktor nuk janë respektuar të gjitha hapat procedurale, të parashikuara në ligj, skualifikimi i operatorit ekonomik ankimues, për arsyen e mësipërme nuk është i drejtë. Vlen të theksojmë, se autoriteti kontraktor, ka detyrimin që në zhvillimin e procedurave të prokurimit të zbatojë me përpikëri të gjitha parashikimet ligjore, më qëllim mosdiskriminimin dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.5. . Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë "ENBI POWER" SHPK & "Aci Enginnering" SHPK se: "• *Në kriteret të veçanta është kërkuar: Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim të prodhuesit/Distributorit të autorizuar.*
*Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.*
*a) Shënim: Operatori ekonomik /Bashkimi i operatorëve, duhet të ofertojë vetëm me një prodhues për secilin artikull, rastet kur paraqiten autorizime nga dy ose më shumë prodhues për të njëjtin artikull, përbëjnë objekt skualifikimi.*
*b) Autorizimi i prodhuesit duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe.*

*Referuar ndarjes së punimeve në marrëveshjen e bashkëpunimit, subjekti "Aci engineering'' ShPK ka marrë përsipër 100% të furnizimit me cela 12 KV dhe Cela të brendshme TM 40 5KV dhe duhet të kishte paraqitur autorizim prodhuesi për këto mallra, por autorizimi i kompanisë Schneider electrik është lëshuar për EnBI Power, në kundërshtim me nenin 88/3 të VKM NR. 285 ku parashikohet se: '' Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje",* Komisioni konstaton se:

III.5.1. Në shtojcën 7, tek "Kriteret e veçanta të kualifikimit", autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

*1. Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim të prodhuesit/Distributorit të autorizuar*

*Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.*

*a)* **Shënim:** *Operatori ekonomik /Bashkimi i operatorëve, duhet të ofertojë vetëm me një prodhues për secilin artikull, rastet kur paraqiten autorizime nga dy ose më shumë prodhues për të njëjtin artikull, përbëjnë objekt skualifikimi.*
*b) Autorizimi i prodhuesit duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe.*

III.5.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "ENBI POWER" SHPK & "Aci Enginnering" SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur në SPE dokumentacion si më poshtë vijon:

*-Kontratë të përkohshme bashkëpunimi të datës 08.09.2023 të lidhur midis shoqërisë "Enbi Power" SHPK & "Aci Engeering" SHPK;*

*-Vërtetim njësie me origjinalin datë 10.09.2023 nr. REP 5022, Autorizim prodhuesi datë 07.09.2023 (schneider).*

*-Vërtetim përkthimi datë 10.09.2023 nr. REP. 5037, sipas së cilës përkthyesja është e licencuar nga Ministria e Drejtësisë, e cila më deklaroi se përktheu me përpikëri dhe saktësi dokumentin bashkëngjitur "Autorizim prodhuesi datë 07.09.2023" nga gjuha angleze në gjuhën shqipe.*

III.5.3. Në nenin 44 "Kërkesat e cilësisë" të VKM nr. 285 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", e ndryshuar parashikohet se: "

*1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit".*

III.5.4. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.5.5. Në rastin konkret, referuar kontratës së bashkëpunimit të lidhur midis operatorëve ekonomikë "Enbi Power" SHPK & "Aci Engeering" SHPK, Komisioni konstaton, se operatori ekonomik "Aci Engeering" SHPK ka marrë përsipër 100% të realizojë kapitullin e Celave të brendshme TM 40.5 kV dhe TM 12 kV (izolacion 24 kV). Në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) , bashkimi i operatorëve ekonomikë ka dorëzuar një dokument të njehsuar me origjinalin dhe të përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe, një autorizim prodhuesi nga Schneider Electric, të cilët janë prodhues të Celat 40.5Kv dhe Celat 245kV PIX24. Autorizimi në fjalë është lëshuar për operatorin ekonomik "Enbi Power" SHPK, i cili autorizohet të dorëzojë një ofertë si dhe të garantojë sigurinë e furnizimit të mallrave Celat 40.5kV dhe 24kV PIX24, nga prodhuesi Schneider Electric, ndërkohë që këtë furnizim sipas kontratës së bashkëpunimit e ka marrë përsipër 100%, operatori ekonomik "Aci Engeening" SHPK, dhe ky autorizim duhet të ishte lëshuar në emër të këtij të fundit, duke qenë në kundërshtim me nenin 88/3 të VKM nr. 285 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje".

Rrjedhimisht, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues nuk qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë "ENBI POWER" SHPK & "Aci Enginnering" SHPK se: *"• Në kriteret të veçanta është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij ose me kontratë shërbimi të paktën 1 (Një) Inxhinier Elektrik të certifikuar nga (prodhuesi ose ekuivalentët) për instalimin dhe komisionimin pajisjeve diagnostifikuese, analizuese të gazrave DGA (të Transformatorët e fuqisë), i cili do të realizoje këtë shërbim.*
*Për të provuar plotesimin e këtij kushti duhet të paraqitet:*
*- Kontrata e punës*
*- Diplomë, CV*

*- Librezat e punës*
*- Certifikata përkatëse e Inxhinierit Elektrik të certifikuar nga prodhuesi ose ekuivalente i pajisjeve DGA (Diagnostifikim, Analizim i Gazrave të Transformatorët e fuqisë).*
*- Listëpagesat E-sig 25 ku të jenë te pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë për një periudhë 3 muajsh nga dita e shpalljes se tenderit.*
*Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8. Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*
*ENBI POWER ka deklaruar një inxhinier kinez të shoqërisë prodhuese, ndërkohe duhet ta kishte staf të vetin dhe dokumentacioni shoqërues,* Komisioni konstaton se:

III.6.1. Në *SHTOJCËN NR. 1, DATË 08.08.2023*, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

**<u>BËHET</u>:** Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij ose me kontratë sherbimi të paktën 1 (Një) Inxhinier Elektrik të çertifikuar nga (prodhuesi ose ekuivalentët) per instalimin dhe komisionimin pajisjeve diagnostifikuese, analizuese të gazrave DGA (të Transformatorët e fuqisë), i cili do të realizojë këtë shërbim.

*Për të provuar plotesimin e këtij kushti duhet të paraqitet:*

- *Kontrata e punës*
- *Diplomë, CV*
- *Librezat e punës*
- *Certificata përkatëse e Inxhinierit Elektrik të certifikuar nga prodhuesi* ose *ekuivalente i pajisjeve DGA (Diagnostifikim, Analizim i Gazrave të Transformatoret e fuqisë).*
- *Listëpagesat E-sig 25 ku të jenë te pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë për një periudhë 3 muajsh nga dita e shpalljes se tenderit.*

III.6.2. Në shtojcën 8 të dokumenteve standarde të tenderit autoriteti kontraktor ka parashikuar:

***Shtojca 8***

*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)*

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari ______________ në cilësinë e ________________të operatorit ekonomik ______________________ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. **INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK**

| **Identifikimi** | **Përgjigjja** |
| --- | --- |

| | |
|---|---|
| Emri i operatorit ekonomik:<br>(Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE) | ------------------------------------------------- |
| Numri NIPT/et: | -------------------------------------------------- |
| Adresa postare:<br>Qyteti / qyteti; Kodi postar | ----------------------------------------------------- |
| Përfaqësuesi (emri): | -------------------------------------------- |
| Telefoni: | ---------------------------------------------------- |
| E-mail: | ---------------------------------------------------------- |

**B: DEKLARATË**
**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

| **Emri i nënkontraktorit të propozuar** | **NIPT –i** | **Përqindja e nënkontraktimit** | **Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar** |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

- **ormacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

| **Emri (at) e subjekteve** | **NIPT-i** | **Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik** | **Specifiko konkretisht kapacitetin/et** |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

**Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**
**A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

| **Deklarata** |
|---|
| Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ______________________________ |
| Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ______________________________ |
| Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:<br>______________________________<br>______________________________<br>etj.<br>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ______________________________ |
| Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ______________________________ |
| Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ______________________________ |
| Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ______________________________ |
| Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.<br>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ______________________________ |
| Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ______________________________ |

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ___________________________________________________

## B: DEKLARATA

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklarim dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

28. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;

29. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;

30. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;

31. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës,është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;

32. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:

    g) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
    h) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

33. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):

    a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
    ☐
    b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).

    ☐

34. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:

m) çmimet ;
n) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
o) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
p) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

35. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).

36. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

## C: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

| Deklarata |
|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:<br>Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike. |
| Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:<br>Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtori i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.<br><br>Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.<br>Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë |

| |
|---|
| 07.04.2005).<br>Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit. |
| Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".<br>Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu. |

**D: DEKLARATA "Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës"**

| **Deklarata** |
|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: |
| • Operatori ekonomik ________________________garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.<br><br>• Operatori ekonomik___________________lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.<br><br>• Operatori ekonomik ________________nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* __________________________________________________ |

**Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit**
**A: DEKLARATË**
**"Per permbushjen e specifikimeve teknike dhe grafikut e realizimit të objektit të kontratës"**

| **Deklarata** | **Përgjigje** |
|---|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (*nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor*), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me preventivin e punimeve dhe grafikun e zbatimit të punimeve të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor. | Po [ ] Jo [ ] |

**B: DEKLARATË "Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate"**

| Deklarata | Përgjigje |
|---|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:<br>Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor. | **Punonjës**<br>Po [ ] Jo [ ]<br>Nëse, po, numri i punonjësve<br>Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatese:<br>10. .__________________________,me profesion________________, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e ____________________,<br><br>11. . __________________________,me profesion________________, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e ____________________,<br><br>12. .__________________________,me profesion________________, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e ____________________,<br><br>**Makineri e mjete**<br>Po [ ] Jo [ ]<br>Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete |

**C: DEKLARATË**
**"Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate"**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se, kam në dispozicion dhe/ose do te me vihen ne dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën, si me poshte:

| **Në pronësi** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Lloji i Mjetit** | **Targa** | **Nr. Lejes qarkullimit** | **Nr. Shasisë** | **Të tjera** |
| 1 | | | | |
| 2 | | | | |
| 3 | | | | |
| 4 | | | | |
| 5 | | | | |

| **Me qira** | |
|---|---|

| **Lloji i Mjetit** | **Targa e mjetit** | **Nr. Lejes qarkullimit të mjetit** | **Nr. Shasisë së mjetit** | **Nr. Kont së qerasë (noterisë)** | **Afati i kontratës qerasë(data e fillimit dhe mbarimit)** |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | | | | | |
| 2 | | | | | |
| 3 | | | | | |
| 4 | | | | | |
| 5 | | | | | |
| 6 | | | | | |

| **Kontratë furnizimi** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Materiali/produkti për të cilin paraqitet kontrata e furnizimit** | **Nr. Kont së furnizimit (noterisë)** | **Afati i kontratës furnizimit (data e fillimit dhe mbarimit)** | **Të tjera** | |
| 1. | | | | |
| 2 | | | | |
| 3 | | | | |
| 4 | | | | |

D. **Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera**

**Deklarata**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:
Mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruara në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jene ne dispozicion gjatë zbatimit të kontratës sipas grafikut te punimeve.

Nëse kërkohet, stafi teknik i poshtëshënuar:
Z. __________________________,me profesion________________, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e ____________________,

etj .,

i deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

**Emri, Mbiemri_______________**
**Firma ______________________**
**Vula________________________**
**Data e dorëzimit të deklaratës ________________**

**Ju lutemi sigurohuni që:**

- **Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.**

- **Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës**.

- **Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.**

- **Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.**

**Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.**

- ***Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.***

- ***Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.***

III.6.3. Në përmbushje të kritereve më sipër bashkimi i operatorëve ekonomikë "Enbi Power" SHPK & "Aci Engeering" SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin si më poshtë:

- *Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik "Enbi Power" SHPK*

- *"Listëpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të ardhurat nga Punësimi" për periudhën maj 2023-korrik 2023, të operatorit ekonomik "Enbi Power" SHPK.*

*- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “*Aci Engeering*” SHPK*

*-Vërtetim njësie me origjinalin datë 10.09.2023 nr. REP 5026, Certifikatë specialisti operimi Xing Yang.*
*-Vërtetim përkthimi datë 10.09.2023 nr. REP. 5033, sipas së cilës përkthyesja është e licencuar nga Ministria e Drejtësisë, e cila më deklaroi se përktheu me përpikëri dhe saktësi dokumentin bashkëngjitur, nga gjuha angleze në gjuhën shqipe.*

III.6.4. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se*:*

*“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*

*Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivit dhe pasivit.*

*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*

*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*

*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve."*

Në nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" pika 1 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", parashikohet shprehimisht : *"1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik."*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *"3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji..."*

III.6.5. Në nenin 26 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, parashikohet se: "1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

*2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:*

*a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*

*b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

*c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

*ç)operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;*

*d)operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;*

*dh)operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve [5]të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;*

*e)operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;*

*ë)operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit te interesit, sipas legjislacionit në fuqi;*

*f)operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;*

*g)operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;*

*gj)operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;*

*h)operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);*

*i)operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;*

*j)informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;*

*k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.*

*3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

*4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.*

[5] Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

*5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.*

*6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike[6]. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

*Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.*

*Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.*

*Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.*

*7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t´i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.*"

III.6.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

[6] Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

III.6.7. Në rastin konkret, nga verifikimi në SPE vihet re, se në përmbushje të kriterit më sipër bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues kanë dorëzuar formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të secilit prej bashkimit të operatorëve ekonomikë, të cilin në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, Listëpagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të ardhurat nga Punësimi” për periudhën maj 2023-korrik 2023 si dhe Certifikatë specialisti operimi Xing Yang të njehsuar dhe të përkthyer nga origjinali, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontrator të kryejë verifikime në rast nevoje apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga bashkimi i operatorëve ekonomikë rezulton, se në përmbushje të kriterit më sipër kanë dorëzuar Listëpagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të ardhurat nga Punësimi” për periudhën maj 2023-korrik 2023, Certifikatë specialisti operimi Xing Yang të njehsuar dhe të përkthyer nga origjinali, si dhe formularin përmbledhës të vetëdeklarimit ku në Pjesën III; “*Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit*” seksioni “**B***: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate*” ku operatori ekonomik “Enbi Power” SHPK ka deklaruar burimet njerëzore dhe ato specifike që lidhen konkretisht për procedurën e prokurimit si më poshtë:
*“Z.* Xing Yang *me profesion inxhinier elektrik, dhe i certifikuar nga prodhuesi për instalimin dhe komisionimin e pajisjeve monitoruese MBT dhe DGA.*

Në këtë kuadër KPP gjykon, se operatori ekonomik ankimues ka dhënë indicie, se ka në dispozicion për kohën e realizimit të kontratës punonjësit e duhur sipas profileve që ka kërkuar, duke specifikuar numrin dhe llojin e certifikatës për secilin prej profileve të kërkuara. Akoma më tej, operatori ekonomik me listëpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat për periudhën maj 2023- korrik 2023 (tre muaj nga data e dorëzimit të ofertës) të paraqitura në SPE, vërteton, se punonjësit e specifikuar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas profileve të kërkuara i disponon në mënyrë të plotë shteruese dhe ligjore përmes listëpagesave të paraqitura si më sipër dhe çdo dokument tjetër në mbështetje të provës që operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore të nevojshme (në rastin konkret kërkesa për paraqitjen e kontratave të punës) për operatorin ekonomik të kualifikuar i pari janë objekt i verifikimit në një moment tjetër procedural, siç është faza përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontrator të kryejë verifikime në rast nevoje apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë, pasi legjislacioni i prokurimit publik i njeh të drejtën autoritetit kontraktor, por dhe vetë ky i fundit ka rezervuar në dokumentet standarde të tenderit edhe të

drejtën e verifikimit apo sqarimit nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës lidhur me vërtetësinë dhe saktësinë e informacionit që përmbajnë dokumentet e paraqitura nga ata dhe më pas të marrë vendim lidhur me to. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se skualifikimi i operatorit ekonomik ankimues për asyet më sipër për mospërmbushje të pikës 6 të kritereve të veçanta, lidhur me paraqitjen e dokumentacionit të kërkuar për punonjësit e specifikuar në DST dhe kontratave të punës, nuk është i drejtë. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t'u siguruar nëse cilësia e mallrave, shërbimeve apo punëve është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm për këtë fazë.

Për sa më lart, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues qëndron.

III.7. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë "ENBI POWER" SHPK & "Aci Enginnering" SHPK se: "*Kontratat ACI INGEENERING*
*Shuma aritmetike e kontratave të ngjashme nuk përmbush vlerën në 18.31% të dyfishit të fondit limit.* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.7.1. Në shtojcën 7, "*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*", në pikën 2.3 *"Kapaciteti teknik"* në dokumentet standarde të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

***2.3 Kapaciteti teknik:***

*Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori/et Ekonomik duhet të përmbushë/in kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:*

***2.3.1 Përvojë e suksesshme** në realizimin e të paktën:*

***c)*** *Punë të ngjashme e realizuar për një objekt të vetëm në një vlere jo më e vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës të procedurës së prokurimit.*

*Ose*

***d)*** *Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e kontratave të punëve të kryera dhe të realizuara, të marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës të procedurës së prokurimit është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

<u>*Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.*</u>

*Puna e ngjashme duhet te jete ne nenstacione elektrike me nivel tensioni jo me te vogel se 110kV.*

**2.3.1/a** *Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:*

**c)** *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.*

- *<u>Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:</u>*

- *Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;*
- *Kontratë Sipërmarrje;*
- *Situacionin përfundimtar te objektit;*
- *Fatura tatimore;*
- *Aktin e kolaudimit te objektit;*
- *Certifikaten e marrjes ne dorezim te perkohshem/perfundimtar*

**d)** *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.*

- *<u>Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:</u>*

- *Vërtetim per realizimin e punimeve ku të përcaktohet dhe përqindja e pjesëmarrjes së punës së realizuar në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik;*
- *Kontrate Sipërmarrje;*
- *Situacionin përfundimtar;*
- *Fatura tatimore per situacionin perfundimtar.*

- *Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues krahas dokumentacionit te sipercituar per secilin rast, respektivisht duhet te paraqese duhet te paraqesë: Kontraten e Bashkimit te operatoreve dhe Prokuren e Posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit shoqeruar me tabelen e ndarjes se punimeve qe ka marre persiper te kryeje secili anetar e i BOE.*
- *Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor si dhe Miratimi zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.*

III.7.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik "Aci Engeenering" SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon.

-Kontratë Sipërmarrje objekti me nr.3805/11 prot., datë 12.10.2018 me objekt "Rehabilitimi i anës 110kV të Nënstacionit Fushë Arrëz", ndërmjet autoritetit kontraktor Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sha) dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë "Aci Eneginneering" SHPK dhe "Sterkaj" SHPK, me vlerë xxxxxxxxxxx lekë me TVSh.

- Kontratë për bashkimin e përkohshëm të shoqërive, nr. 5511 Rep., Nr.2247 kol., datë 27.07.2018, ndërmjet operatorëve ekonomikë "Aci Eneginneering" SHPK dhe "Sterkaj" SHPK. Ku shoqëria "Aci Eneginneering" SHPK do të kontribuojë në masën 71 % në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indekset përkatëse, këto zëra punimesh [...].
- Akt kolaudimi nr. 5282/7 prot., datë 23.11.2020.
- Certifikatë marrje së përkohshme në dorëzim të punimeve me nr. 5282/8 prot., datë 24.11.2020.
- Faturë tatimore nr. 1, datë 23.09.2020.
- Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sha) për bashkimi të operatorëve ekonomikë "Aci Eneginneering" SHPK dhe "Sterkaj" SHPK për objektin e kontratës "Rehabilitimi i anës 110kV të Nënstacionit Fushë Arrëz", data e fillimit të kontratës 16.07.2019, data e mbarimit të punimeve të kontratës 01.09.2020, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga shoqëria "Aci Eneginneering" SHPK 71% të punimeve dhe "Sterkaj" SHPK, ka realizuar 13.6 % të punimeve; Vlerësimi: Realizuar me sukses.
- Situacion përfundimatar.

.................................

-Kontratë Sipërmarrje objekti me nr.2068/9 prot., datë 19.06.2020 me objekt "Punime për përfundimin e linjës kabllore 110kV Tirana-Selitë dhe lidhja me nënstacionin 110/20kV Kombinat", ndërmjet autoritetit kontraktor Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sha) dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë "Aci Eneginneering" SHPK dhe "Sterkaj" SHPK, me vlerë xxxxxxxxxxx lekë me TVSh.

- Kontratë për bashkimin e përkohshëm të shoqërive, nr. 5511 Rep., Nr.2247 kol., datë 27.07.2018, ndërmjet operatorëve ekonomikë "Aci Eneginneering" SHPK dhe "Sterkaj" SHPK. Ku shoqëria "Aci Eneginneering" SHPK do të kontribuojë në masën 71 % në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indekset përkatëse, këto zëra punimesh [...].
- Kontratë për bashkimin e përkohshëm të shoqërive, nr. 905 Rep., Nr.348 kol., datë 07.02.2020, ndërmjet operatorëve ekonomikë "Aci Eneginneering" SHPK dhe "Sterkaj" SHPK. Ku shoqëria "Aci Eneginneering" SHPK do të kontribuojë në masën 74.65 % në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indekset përkatëse, këto zëra punimesh [...].
- Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sha) për bashkimi të operatorëve ekonomikë "Aci Eneginneering" SHPK dhe "Sterkaj" SHPK për objektin e kontratës "Punime për përfundimin e linjës kabllore 110kV Tirana-Selitë dhe lidhja me nënstacionin 110/20kV Kombinat", data e fillimit të kontratës

20.07.2020, data e mbarimit të punimeve të kontratës 26.02.2021, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga shoqëria “Aci Eneginneering” SHPK 74.65% të punimeve dhe “Sterkaj” SHPK, ka realizuar 25.35 % të punimeve; Vlerësimi: Realizuar me sukses.
- Faturë tatimore nr. 4, datë 02.12.2020.(situacion pjesor nr.1)
- Faturë tatimore nr. 15, datë 01.03.2021.(situacion pjesor nr.2)
- Akt kolaudimi nr. 1863/1 prot., datë 08.04.2021.
- Certifikatë e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve nr. 1863/2 prot., datë 08.04.2021.
- Situacion nr. 1
- Situacion nr. 2 (përfundimtar)

...................................

-Kontratë sipërmarrje punimesh midis “Red&Black” SHPK dhe “Aci Eneginneering” SHPK datë 02.09.2019 me objekt “Furnizim dhe vendosje e pajisjeve të tensionit të lartë në primar dhe sekondar të N/Stacioneve 110 kV”, me vlerë xxxxxxxxxxx lekë me TVSh. (nënkontraktim)

-Faturë tatimore nr. 209, datë 20.09.2019.

-Situacion.

-Faturë tatimore nr. 208, datë 20.09.2019.

-Situacion.

-Faturë tatimore nr. 22, datë 22.10.2019.

-Situacion.

-Faturë tatimore nr. 221, datë 03.10.2019.

-Situacion.

-Faturë tatimore nr. 31, datë 02.11.2019.

-Situacion.

-Faturë tatimore nr. 245, datë 06.12.2019.

-Situacion.

-Faturë tatimore nr. 2225, datë 12.10.2019.

-Situacion

-Akt kolaudimi 30.12.2019.

-Formular vlerësimi.

...................................

- Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sha) për bashkimi të operatorëve ekonomikë “Aci Eneginneering” SHPK dhe “H&EEnergy” SHPK për objektin e kontratës “Plotësim dhe vënia në punë e traktit 110kV në N/Stacionin Fier për N/Stacionin 110/20/ kV të OSHEE + Trajnimi i personelit inxhiniero teknik të DSHMT-së”, data e fillimit të kontratës 29.10.2018, data e mbarimit të punimeve të kontratës 06.05.2019, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga shoqëria “Aci Eneginneering” SHPK 52% të punimeve dhe “H&EEnergy” SHPK, ka realizuar 48 % të punimeve; Vlerësimi: Realizuar me sukses.
- Kontratë Sipërmarrje objekti me nr.4558/14 prot., datë 29.10.2018 me objekt “Plotësim dhe vënia në punë e traktit 110kV në N/Stacionin Fier për N/Stacionin 110/20/ kV të OSHEE + Trajnimi i personelit inxhiniero teknik të DSHMT-së”, ndërmjet autoritetit kontraktor

Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sha) dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë "Aci Eneginneering"SHPK dhe "H&EEnergy" SHPK, me vlerë xxxxxxxxxxx lekë me TVSh.

-Kontratë për bashkimin e përkohshëm të shoqërive, nr. 6506 Rep., Nr.2635 kol., datë 18.09.2018, ndërmjet operatorëve ekonomikë "Aci Eneginneering" SHPK dhe "H&EEnergy" SHPK. Ku shoqëria "Aci Eneginneering" SHPK do të kontribuojë në masën 52 % në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indekset përkatëse, këto zëra punimesh [...].
-Akt kolaudimi dhe i marrjes në dorëzim me nr. 2954/1 prot., datë 06.05.2019.
-Faturë tatimore nr. 35, datë 02.05.2019.
--Faturë tatimore nr. 01 datë 04.01.2019.
-Faturë tatimore nr. 31, datë 30.10.2018
-Situacion përfundimtar pjesor nr.2.

III.7.3. Në nenin 77 te ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*
*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*
*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*
*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*
*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*
*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

III.7.4. Në nenin 39 "*Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike"* pika 5 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", e ndryshuar,* parashikohet se:
*"5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*
*a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;*

*b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*
*Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.*
*Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.*
*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve."*

III.7.5. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit KPP vëren, se autoriteti kontraktor në kapacitetin teknik ka kërkuar shprehimisht që *Punë të ngjashme e realizuar për një objekt të vetëm në një vlere jo më e vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës të procedurës së prokurimit.*
*Ose*
*Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e kontratave të punëve të kryera dhe të realizuara, të marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës të procedurës së prokurimit është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

*Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.*

*Puna e ngjashme duhet te jete ne nenstacione elektrike me nivel tensioni jo me te vogel se 110kV.[...]"*

III.7.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.
Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.7.8. Sqarojmë, se referuar rregullave të prokurimit publik, për kontratat për punë publike, për të provuar përvojën e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë njërin prej dy kushteve të përcaktuara në nenin 39 pika 5 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", e ndryshuar,* ku operatori ekonomik duhet të provojë se ka kryer punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; ose të provojë se ka kryer punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Sa më sipër, referuar kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor për sa i përket eksperiencës së ngjashme, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur operatori ekonomik "Aci Engeneering" SHPK, në bazë të kontratës së përkohshme të bashkëpunimit, i cili ka marrë përsipër të realizojë 18.31%, konstatojmë, se ky i fundit e përmbush kushtin e parë të vendosur nga autoriteti kontraktor për një për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kështu që rrjedhimisht KPP verifikoi dokumentacionin e dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik "Aci Engeneering" SHPK për plotësimin e kushtit të parë. Sa më sipër, nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ky i fundit në Sistemin e Prokurimit Publik, konstatohet, se operatori ekonomik "Aci Engeneering" SHPK për një nga punët e ngjashme të deklaruara, ka paraqitur dokumentacionin përkatës të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Konkretisht ka paraqitur:

Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sha) për bashkimi të operatorëve ekonomikë "Aci Eneginneering" SHPK dhe "Sterkaj" SHPK për objektin e kontratës "*Rehabilitimi i anës 110kV të Nënstacionit Fushë Arrëz*", data e fillimit të kontratës 16.07.2019, data e mbarimit të punimeve të kontratës 01.09.2020, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga shoqëria "Aci Eneginneering" SHPK 71% të punimeve dhe "Sterkaj" SHPK, ka realizuar 13.6 % të punimeve; *Vlerësimi: Realizuar me sukses* si dhe dokumentacionin shoqërues siç kërkohet në dokumentet e tenderit si Kontratë Sipërmarrje, Situacion përfundimtar, Akt Kolaudimi, Certifikatën e marrjes në dorëzim/Certifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorëzim objekti, si dhe Kontratën e Bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Sa më sipër, referuar kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor për sa i përket kontratave të ngjashme, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik "Aci Eneginneering" SHPK, konstatojmë, se ky i fundit ka paraqitur një kontratë të ngjashme për një objekt të vetëm në vlerën jo më të vogël se 50 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që do të prokurohet, siç është kërkuar në dokumentet e tenderit. Kështu që, rrjedhimisht KPP verifikoi plotësimin e kushtit të parë "ku operatori ekonomik duhet të provojë se ka kryer punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës".

III.7.9. Sa më lart, nga verifikimi i punëve të realizuara dhe dokumentacionit shoqërues të tyre, të paraqitur si dëshmi për eksperiencat e mëparshme të ngjashme, konstatohet se operatori ekonomik ankimues ka kryer punime të ngjashme me zërat në preventivin e hartuar nga autoriteti kontraktor për këtë procedurë prokurimi.

KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Sa më sipër, nisur nga arsyeja e skualifikimit, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale, por të analizojë në themel dhe në mënyrë të arsyeshme e proporcionale eksperiencat e dokumentuara nga ofertuesit/kandidatët, në funksion të qëllimit dhe rrethanave faktike për të cilin vendosen kriteret e përcaktuara.

Pra, për të plotësuar pikën e mësipërme të kërkesave për kualifikim për eksperiencën e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet dhe jo kontrata të njëjta, pasi për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Sa më sipër, KPP konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik ankimues vërteton se ka kryer punime të ngjashme me zërat e parashikuara për kontratën objekt - shqyrtimi.

Gjithashtu, nga përllogaritja e vlerës së punëve të ngjashme të paraqitura nga operatori ekonomik ankimues, duke e përllogaritur sipas përqindjes së pjesëmarrjes së këtij të fundit në kontratën e dorëzuar, vlen të theksohet, se vlera e përgjithshme e punimeve të ngjashme të realizuara në dokumentet e paraqitura nga ky operator ekonomik është 71 % ose 111,920,052 lekë pa TVSh, e tejkalon vlerën prej 59,507,089.2 lekë pa TVSH ( 18.31% i 50% të fondit limit), të përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

Nga verifikimi i zërave dhe volumeve të ngjashme të preventivit të kontratave të paraqitura nga ankimuesi, si eksperienca të ngjashme të mëparshme, nga përllogaritja e zërave të ngjashëm për sa i përket llojit, tipologjisë, emërtimit/përshkrimit, me zërat e preventivit të kontratës objekt - shqyrtimi, rezulton se operatori ekonomik ankimues ka arritur të dëshmojë se ka kryer kontrata të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit në vlerën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi zërat e konsideruar të ngjashëm përmbushin vlerën prej 59,507,089.2 lekë pa TVSH ( 18.31 % i 50% të fondit limit), sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.

Ndërsa lidhur me Kontratë sipërmarje punimesh midis “Red&Black” SHPK dhe “Aci Eneginneering” SHPK datë 02.09.2019 me objekt “Furnizim dhe vendosje e pajisjeve të tensionit të lartë në primar dhe sekondar të N/Stacioneve 110 kV”, me vlerë xxxxxxxxxxx lekë me TVSh, *shoqëruar me formular vlerësimi, situacione, akt kolaudim, certifikate e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.,* Komisioni Prokurimit Publik nuk do ta marrë në shqyrtim në themel këtë kontratë, por në këtë rast është deklaruar si një kontratë e lidhur

midis dy subjekteve private, ku subjekti “Red&Black” SHPK është në rolin e sipërmarrësit dhe subjekti “Aci Eneginneering” SHPK në rolin e nënsipërmarrësit. Për sa kohë që Komisioni Prokurimit Publik nuk ka informacion nëse në procedurën e prokurimit të kësaj kontrate autoriteti kontraktor ka lejuar nënkontraktimin, atëherë nuk mund ta marrë në konsideratë atë, por edhe në rast se operatori ekonomik, i cili kishte barrën e provës në kuptim të nenit 82 pika 1 “*Barra Provës*” të ligjit 44/2015 “*Kodi Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*” për të vërtetuar këtë fakt do të kishtë paraqitur fakte dhe prova, sërish komisioni nuk do ta kishte marrë në konsideratë, pasi nga shqyrtimi i kontratës rezulton, se kjo kontratë e lidhur midis dy subjekteve private është lidhur në vlerën e plotë prej *41,797,281.67 lekë pa TVSH,* ndërkohë që në nenin 61 “Nënkontraktimi” i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar (ligj ky në fuqi në kohën e lidhjes së kësaj kontrate) shprehimisht përcaktohej se *Autoriteti kontraktor, në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit, u kërkon ofertuesve të tregojnë në ofertat e tyre përqindjen e kontratës, që ata mendojnë të nënkontraktojnë te palët e treta, si dhe nënkontraktorin e propozuar. Kjo përqindje e caktuar për nënkontraktim duhet të jetë në përpjesëtim me vlerën e kontratës dhe <u>nuk duhet të tejkalojë 40 përqind të vlerës së përgjithshme të kontratës</u>. Autoriteti kontraktor miraton nënkontraktorët e mundshëm përpara lidhjes së nënkontratës me operatorin ekonomik fitues të kontratës publike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, pa cenuar parimet e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni*. Sa më sipër, nga përllogaritjet e kryera nga Komisioni për kontratën e ngjashme të marrë në shqyrtim rezulton, se vlera e përgjithshme e punimeve të ngjashme të realizuara në dokumentet e paraqitura nga operatori ekonomik ”Aci Eneginneering” SHPK është 111,920,052 lekë pa TVSH, duke tejkaluar vlerën prej 59,507,089.2 lekë pa TVSH ( 18.31 % i 50% të fondit limit), që duhet të plotësonte ky operator, duke e përmbushur kriterin në lidhje me eksperiencën e ngjashme, në vlerën e kërkuar në kriteret e kualifikimit *ku operatori ekonomik duhet të provojë se ka kryer punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.* Rrjedhimisht ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nga operatori ekonomik ”Aci Eneginneering” SHPK.

III.7.10. Nisur nga sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, për të vërtetuar eksperiencën e mëparshme, është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se kontratat e paraqitura nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotësojnë kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Në këto kushte, KPP gjykon, se njëri nga operatorët ekonomikë ankimues e ka përmbushur kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor për sa i përket eksperiencës së mëparshme të ngjashme.

Rrjedhimisht pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë qëndron.

III.8. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “ENBI POWER” SHPK & “Aci Enginnering” SHPK se: “*Nuk ka teknikun e ndërtimit të deklaruar në shtojcën 8 për asnjë nga operatorët ekonomikë”,* Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se:

III.8.1. Në shtojcën 7, "*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*", në pikën 2.3 *"Kapaciteti teknik"* në dokumentet standarde të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

f)Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën 3-muajt e fundit, stafi mbështetës si më poshtë:

- **1 Teknik Ndërtimi**

* Në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Diplomë (Dëftesë), Kartelat përkatëse të Sigurimit Teknik (të vlefshme) si dhe Kontrata e punës e vlefshme.

*Për pikën si më sipër operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.*

*Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*

III.8.2. Në shtojcën 8 të dokumenteve standarde të tenderit autoriteti kontraktor ka parashikuar:

***Shtojca 8***

*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)*

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _______________ në cilësinë e _________________të operatorit ekonomik ______________________ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. **INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK**

| **Identifikimi** | **Përgjigjja** |
|---|---|
| Emri i operatorit ekonomik:<br>(Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE) | ------------------------------------------------- |
| Numri NIPT/et: | ---------------------------------------------------- |
| Adresa postare:<br>Qyteti / qyteti; Kodi postar | ------------------------------------------------------- |

| | |
|---|---|
| Përfaqësuesi (emri): | -------------------------------------------- |
| Telefoni: | ----------------------------------------------------- |
| E-mail: | -------------------------------------------------------- --- |

**B: DEKLARATË**
**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

| **Emri i nënkontraktorit të propozuar** | **NIPT –i** | **Përqindja e nënkontraktimit** | **Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar** |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

- **ormacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

| **Emri (at) e subjekteve** | **NIPT-i** | **Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik** | **Specifiko konkretisht kapacitetin/et** |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

**Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**
**A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

| **Deklarata** |
|---|
| Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ________________________________________________ |

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ___________________________________________________

---

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

_______________________________________________________________________________

_______________________________________________________________________________

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ___________________________________________________

---

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ___________________________________________________

---

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ___________________________________________________

---

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ___________________________________________________

---

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ___________________________________________________

---

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ___________________________________________________

---

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim

është në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ________________________________________________

**B: DEKLARATA**

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", bëj këtë deklarim dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

37. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;

38. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s'kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;

39. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;

40. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës,është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;

41. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala "konkurrentë" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:

   i) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
   j) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

42. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):

   a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
      ☐
   b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).

      ☐

43. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:

   q) çmimet ;
   r) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;

s) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
t) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

44. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).

45. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

## C: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

| Deklarata |
|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:<br>Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike. |

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:
Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtori i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.
Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).
Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me

| |
|---|
| përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit. |
| Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik". Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu. |

**D: DEKLARATA "Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës"**

| **Deklarata** |
|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: |
| • Operatori ekonomik ________________________garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.<br>• Operatori ekonomik___________________lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.<br>• Operatori ekonomik ________________nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ____________________________________________________ |

**Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit**
**A: DEKLARATË**
**"Per permbushjen e specifikimeve teknike dhe grafikut e realizimit të objektit të kontratës"**

| **Deklarata** | **Përgjigje** |
|---|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (*nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor*), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me preventivin e punimeve dhe grafikun e zbatimit të punimeve të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor. | Po [ ] Jo [ ] |

**B: DEKLARATË "Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate"**

| **Deklarata** | **Përgjigje** |
|---|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj | **Punonjës** |

| | |
|---|---|
| nën përgjegjësinë time se:<br>Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor. | Po [ ] Jo [ ]<br>Nëse, po, numri i punonjësve<br>Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatese:<br>13. .__________________________,me profesion________________, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e ____________________,<br>14. . __________________________,me profesion________________, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e ____________________,<br>15. .__________________________,me profesion________________, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e ____________________,<br>**Makineri e mjete**<br>Po [ ] Jo [ ]<br>Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete |

**C: DEKLARATË**
**“Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se, kam në dispozicion dhe/ose do te me vihen ne dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën, si me poshte:

| **Në pronësi** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Lloji i Mjetit** | **Targa** | **Nr. Lejes qarkullimit** | **Nr. Shasisë** | **Të tjera** |
| 1 | | | | |
| 2 | | | | |
| 3 | | | | |
| 4 | | | | |
| 5 | | | | |

| **Me qira** | |
|---|---|

| Lloji i Mjetit | Targa e mjetit | Nr. Lejes qarkullimit të mjetit | Nr. Shasisë së mjetit | Nr. Kont së qerasë (noterisë) | Afati i kontratës qerasë(data e fillimit dhe mbarimit) |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | | | | | |
| 2 | | | | | |
| 3 | | | | | |
| 4 | | | | | |
| 5 | | | | | |
| 6 | | | | | |

| **Kontratë furnizimi** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Materiali/produkti për të cilin paraqitet kontrata e furnizimit** | **Nr. Kont së furnizimit (noterisë)** | **Afati i kontratës furnizimit (data e fillimit dhe mbarimit)** | **Të tjera** | |
| 1. | | | | |
| 2 | | | | |
| 3 | | | | |
| 4 | | | | |

D. **Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera**

**Deklarata**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:
Mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruara në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jene ne dispozicion gjatë zbatimit të kontratës sipas grafikut te punimeve.

Nëse kërkohet, stafi teknik i poshtëshënuar:
Z. __________________________,me profesion________________, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e ____________________,

etj .,

i deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

| |
|---|
| **Emri, Mbiemri_______________**<br>**Firma ______________________**<br>**Vula________________________**<br>**Data e dorëzimit të deklaratës ________________** |

**Ju lutemi sigurohuni që:**

- **Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.**

- **Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës**.

- **Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.**

- **Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.**

**Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.**

- ***Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.***

- ***Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.***

III.8.3. Në përmbushje të kritereve më sipër operatori ekonomik "Enbi Power" SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin si më poshtë:

- *Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik "Enbi Power" SHPK*

- *Listëpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të ardhurat nga Punësimi" për periudhën maj 2023-korrik 2023.*

III.8.4. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", parashikohet shprehimisht se*:*

*"1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*

*Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivit dhe pasivit.*

*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*

*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*

*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve."*

Në nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" pika 1 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", parashikohet shprehimisht : *"1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik."*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *"3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji..."*

III.8.5. Në nenin 26 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, parashikohet se: "1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

*2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:*

*a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*

*b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

*c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

*ç)operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;*

*d)operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;*

*dh)operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve [7]të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;*

*e)operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;*

*ë)operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit te interesit, sipas legjislacionit në fuqi;*

*f)operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;*

*g)operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;*

*gj)operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;*

*h)operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);*

*i)operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;*

*j)informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;*

*k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.*

*3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

*4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.*

*5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.*

*6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike[8]. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

[7] Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

[8] Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

*Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.*

*Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.*

*Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.*

*7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t´i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.*"

III.8.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.8.7. Në rastin konkret, nga verifikimi në SPE vihet re, se në përmbushje të kriterit më sipër ankimuesi ka dorëzuar Listëpagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të ardhurat nga Punësimi" për periudhën maj 2023-korrik 2023 si dhe formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik, të cilin në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2, të nenit 26, të Vendimit Nr. 285,

datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontrator të kryejë verifikime në rast nevoje apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik "Enbi Power" SHPK rezulton, se në përmbushje të kriterit më sipër ka dorëzuar listpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, si dhe formularin përmbledhës të vetëdeklarimit ku në Pjesën III; "*Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit*" seksioni "**B**: *DEKLARATË "Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate*" operatori ekonomik "Enbi Power" SHPK, ka deklaruar burimet njerëzore dhe ato specifike që lidhen konkretisht për procedurën e prokurimit, por ka deklaruar një punonjës në pozicionin e inxhinierit të ndërtimit (znj. J.B.). Për sa më sipër cituar, duke qenë se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet, që operatori ekonomik zotëron personelin e nevojshëm për realizimin e kontratës objekt-shqyrtimi, dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria "Enbi Power "SHPK provon, se e ka të punësuar një punonjës Inxhinier Ndërtimi në përputhje dhe në tejkalim të kërkesave të autoritetit kontraktor si më sipër cituar. Në këtë kuadër KPP gjykon, se operatori ekonomik ankimues ka dhënë indicie, se ka në dispozicion për kohën e realizimit të kontratës punonjësit e duhur sipas profileve që ka kërkuar, duke specifikuar numrin dhe llojin e certifikatës për secilën prej profileve të kërkuara. Akoma më tej, operatori ekonomik me listëpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat për periudhën maj 2023- korrik 2023 (tre muaj nga data e dorëzimit të ofertës) të paraqitura në SPE, vërteton se punonjësit e specifikuar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas profileve të kërkuara, i disponon në mënyrë të plotë shteruese dhe ligjore përmes listëpagesave të paraqitura si më sipër dhe çdo dokument tjetër në mbështetje të provës që operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore të nevojshme (në rastin konkret kërkesa për paraqitjen e kontratave të punës) për operatorin ekonomik të kualifikuar i pari janë objekt i verifikimit në një moment tjetër procedural, siç është faza përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontrator të kryejë verifikime në rast nevoje apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë, pasi legjislacioni i prokurimit publik i njeh të drejtën autoritetit kontraktor, por dhe vetë ky i fundit ka rezervuar në dokumentet standarde të tenderit edhe të drejtën e verifikimit apo sqarimit nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës lidhur me vërtetësinë dhe saktësinë e informacionit që përmbajnë dokumentet e paraqitura nga ata dhe më pas të marrë vendim lidhur me to. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se skualifikimi i operatorit ekonomik ankimues për asyet më sipër për mospërmbushje të pikës 6 të kritereve të veçanta, lidhur me paraqitjen e dokumentacionit të kërkuara për punonjësit e specifikuar në DST dhe kontratave të punës nuk është i drejtë. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t'u siguruar nëse cilësia e mallrave, shërbimeve apo punëve është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm për këtë fazë.

Për sa më lart, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues qëndron.

III.9. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë "ENBI POWER" SHPK & "Aci Enginnering" SHPK se: "*Mjeku është kërkuar në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë të paraqitet nga të dy anetarët e bashkimit dhe nga OE ACI nuk ka paraqitur në vetdeklarim mjekun e shoqërisë",* Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se:

III.9.1. Në shtojcën 7, "*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*", në pikën 2.3 *"Kapaciteti teknik"* në dokumentet standarde të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

*h) Operatori Ekonomik duhet te kete te punesuar ose me kontrate sherbimi, mjekun e shoqerise te pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë, sipas parashikimeve te VKM-se Nr.692 date 13.12.2001 ndryshuar me VKM Nr. 742 date 06.11.2003.*
*(Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet te plotesoje kete kerkese duke pasur ne konsiderate edhe parashikimin e pikes 3 të nenit 88 te VKM-se Nr. 285 date 19.05.2021, i ndryshuar).*
*Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.*

*Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*

III.9.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik "Enbi Power" SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon.

-Formular Përmbledhës i vetdeklarimit për operatorin ekonomik "Enbi Power" SHPK;
- Formular Përmbledhës i vetdeklarimit për operatorin ekonomik "Aci Engennering" SHPK

III.9.3. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", parashikohet shprehimisht se*:*
*"1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*
*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*
*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*
*Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*
*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*
*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivit dhe pasivit.*
*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*
*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*
*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*
*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*
*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*
*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*
*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve."*

Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”*
Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.9.4. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*.

*2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:*

*a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*

*b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

*c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

*ç)operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;*

*d)operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;*

*dh)operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;*

*e)operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;*

*ë)operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit te interesit, sipas legjislacionit në fuqi;*

*f)operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;*

*g)operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;*

*gj)operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;*

*h)operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);*

*i)operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;*

*j)informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;*

*k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.*

*3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

*4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.*

*5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.*

*6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

*Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.*

*Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj*

*Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.*

*7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.*"

III.9.5. Në nenin 88 pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, parashikohet se:

*"Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*
*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht."*

III.9.6. Në nenin 7, piat 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 10 237, Datë 18.2.2010 Për Sigurinë Dhe Shëndetin Në Punë" parashikohet se: *"1. Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës, që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje/institucion.*
*3. Punëdhënësi u drejtohet personave ose shërbimeve të specializuara jashtë ndërmarrjes/institucionit, duke hyrë në marrëdhënie kontraktore me ta, nëse kapacitetet e ndërmarrjes/institucionit janë të pamjaftueshme për të organizuar veprimtari për mbrojtjen dhe parandalimin."*

III.9.7. Në Vendimin Nr.108, datë 9.2.2011 "*Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë*", parashikohet shprehimisht se:
*1. Në zbatim të nenit 7 të ligjit nr.10 237, datë 18.2.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", çdo punëdhënës, për të siguruar parandalimin dhe mbrojtjen e punëmarrësve për të gjitha çështjet, që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë:*
*a) ngarkon një ose disa punëmarrës, si persona përgjegjës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje/institucion;*
*b) u drejtohet personave ose shërbimeve të specializuara jashtë ndërmarrjes/institucionit, duke vendosur marrëdhënie kontraktuale me ta".*
Kapitulli II "Klasifikimi i punëdhënësve në grupe, për efekt të organizimit të punëmarrësve në shërbimet për mbrojtjen dhe parandalimin", përcaktohet se:
*"1. Për efekt të organizimit të shërbimit të brendshëm për mbrojtjen dhe parandalimin, punëdhënësit janë klasifikuar në katër grupe, si më poshtë vijon:*
*1.1 Grupi A përfshin punëdhënësit me më shumë se 1000 (një mijë) punëmarrës. Ky numër punëmarrësish reduktohet në:*
*1.1.1 500 (pesëqind) punëmarrës për ndërmarrjet e:*
*a) industrisë së pastrimit dhe shpërndarjes së ujit;*
*b) industrisë së transformimit të metaleve, mekanikës e precizionit dhe industrisë optike, me përjashtim të ndërmarrjeve/institucioneve që ushtrojnë veprimtari në industritë e referuara në nënndarjen*

*1.1.2, shkronjat "dh", "e", "ë" e "f";*
*c) industritë e tjera prodhuese, me përjashtim të ndërmarrjeve/institucioneve që ushtrojnë veprimtari në industritë referuara në pikën 1.1.2, shkronja "g".*
*1.1.2 250 (dyqind e pesëdhjetë) punëmarrës për ndërmarrjet e:*
*a) industrisë së prodhimit e të shpërndarjes së energjisë elektrike, gazit, avullit dhe ujit të ngrohtë;*
*b) industrisë së prodhimit dhe të përpunimit fillestar të metaleve;*
*c) prodhimit industrial prej guri, çimentos, betonit, qeramikës, qelqit dhe të tjerët;*
*ç) industrisë kimike, me përjashtim të ndërmarrjeve/institucioneve që ushtrojnë veprimtari në industritë e referuara në 1.1.3, shkronjat "ç", "d" dhe "dh";*
*d) prodhimit industrial të fibrave artificiale dhe sintetike;*
*dh) industrisë së fabrikimit të veprave në metale;*
*e) industrisë së ndërtimit të makinerive dhe të pajisjeve mekanike;*
*ë) industrisë së ndërtimit dhe të autopjesëve;*
*f) industrisë së ndërtimit të pajisjeve të tjera të transportit;*
*g) industrisë së drurit dhe mobilieve të drurit;*
*gj) industrisë së ndërtimit dhe të punëve publike.*
*1.1.3. 50 (pesëdhjetë) punëmarrës për ndërmarrjet:*
*a) e industrisë bërthamore;*
*b) me furrat koks;*
*c) e përpunimit të naftës;*
*ç) e industrisë së prodhimit të kimikateve bazë;*
*d) e industrisë petro-kimike dhe karbokimike;*
*dh) e industrisë së prodhimit të produkteve të tjera kimike, kryesisht për industri dhe bujqësi.*

*1.2 Grupi B përfshin punëdhënësit me punëmarrës:*
*a) nga 251 deri në 1000 persona, të cilët nuk janë përfshirë në grupin A;*
*b) nga 100 deri në 250 persona, të cilët nuk janë të përfshirë në sektorët e industrisë së përcaktuar në pikën 1.1.1 të këtij kreu;*
*c) nga 50 deri në 200 persona, që nuk janë të përfshirë në sektorët e industrisë së përcaktuar në pikën 1.1.2 të këtij kreu;*
*ç) nga 20 deri në 50 persona, që nuk janë të përfshirë në sektorët e industrisë së përcaktuar në pikën 1.1.3 të këtij kreu.*

*1.3 Grupi C përfshin punëdhënësit me më pak se 200 (dyqind) punëmarrës, të cilët nuk përfshihen në grupet A dhe B.*

*1.4 Grupi D përfshin punëdhënësit që punësojnë më pak se 20 (njëzet) punëmarrës".*

*Për punëdhënësit, që përfshihen në grupet A, B dhe C, përgjegjësitë dhe detyrat e parashikuara në pikat 10 e 11 të kreut III të këtij vendimi kryhen gjithmonë nga personat e ngarkuar përgjegjës për çështjet e sigurisë e të shëndetit në punë.*

*3. <u>Vetëm në rastet kur kapacitetet dhe burimet e ndërmarrjes/institucionit janë të pamjaftueshme për ta përmbushur këtë shërbim, ato bashkëpunojnë me persona apo shërbime të jashtme të specializuara për zbatimin e masave mbrojtëse dhe parandaluese.</u>*

*4. Për punëdhënësit e grupit D, përgjegjësitë dhe detyrat e parashikuara në pikat 10 e 11 të kreut III të këtij vendimi, kryhen gjithmonë nga persona apo shërbime të specializuara jashtë ndërmarrjes, të kontraktuara nga punëdhënësi.*

III.9.8. Në Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, "*Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë*", pika 1, pika 3, gërma" b " dhe pika 4 gërma "b" është përcaktuar:

1. *"Pas pikës 5, të kreut II, shtohet pika 6, me përmbajtje, si më poshtë vijon: "6. Punëdhënësit e grupeve "A" dhe "B", në zbatim të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, për çdo 700 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës. Ndërsa punëdhënësit e grupeve "C" dhe "D", për çdo 1500 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë.". [...]*
2. *Në kreun IV, pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon: "7. Personi përgjegjës, i ngarkuar nga shërbimi i specializuar jashtë ndërmarrjes për menaxhimin e riskut, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:*

*b) në lidhje me shëndetin në punë të ketë formim profesional në fushën e mjekësisë së përgjithshme dhe i cili:*

*b.1 të jetë kualifikuar si mjek i sëmundjeve profesionale/mjek pune;*

*b.2 të jetë i licencuar nga Urdhri i Mjekut për ushtrimin e profesionit".*

*4/b) Pas pikës 2 shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:*

*<u>"3. Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, "Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë", shfuqizohet.</u>*

*Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e zbatimit një vit pas hyrjes në fuqi*

*Në nenin 1 të Vendimit Nr.312, Datë 5.5.2010 Për Miratimin E Rregullores "Për Sigurinë Në Kantier" parashikon se : "Neni 1 Objekti Kjo rregullore përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm të përkufizuara sipas nenin 2, shkronja "a", si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes, të cilat i përmban aneksi V".*

III.9.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka

në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.9.10. Referuar kriterit të veçantë të kualifikimit, rezulton, se nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar që shoqëria të ketë mjekun e shoqërisë, i cili është një përcaktim detyrues referuar VKM nr. 742, date 06.11.2003 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 692, datë 13.12.2001 të Këshillit të Ministrave 'Për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë'". Lidhur me sa më sipër Komisioni sqaron, se në Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave 'Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë'", pika 1, pika 3, gërma "b" dhe pika 4 gërma "b" thuhet shprehimisht se: *Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, "Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë", shfuqizohet. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e zbatimit një vit pas hyrjes në fuqi".* Duke qenë se VKM nr. 742, datë 06.11.2003 ka ndryshuar VKM nr. 692, datë 13.13.2001, rrjedhimisht edhe kjo e fundit rezulton të jetë e shfuqizuar, duke qenë se akti bazë nuk ka më fuqi ligjore.
Komisioni sjell në vëmendje, se referuar VKM Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave *"Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë",* dhe VKM *Nr.312, Datë 5.5.2010 Për Miratimin E Rregullores "Për Sigurinë Në Kantier",* çdo punëdhënës, për të siguruar parandalimin dhe mbrojtjen e punëmarrësve për të gjitha çështjet, që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë, ngarkon një ose disa punëmarrës, si persona përgjegjës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje/institucion ose u drejtohet personave ose shërbimeve të specializuara jashtë ndërmarrjes/institucionit, duke vendosur marrëdhënie kontraktuale me ta. Për plotësimin e kriterit për disponiin e mjekut të caktuar nga autoriteti kontraktor, nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "ENBI POWER" SHPK & "Aci Enginnering" SHPK, Komisioni konstaton, se pavarësisht se jemi përpara rastit ku kemi si ofertues bashkim operatorësh më përqindje të caktuar në pjësëmarrje, është detyrim ligjor për sa referuar më lart që çdo punëmarrës ka detyrimin

ligjor të disponimit të mjekut si pjesë të stafit të vet ose me shërbim të jashtëm. Por në rastin konkret, operatori ekonomik“ENBI POWER” SHPK ka deklaruar një punonjës në pozicionin e mjekut Znj. L. B., si në listpagesat e maj 2023 - korrik 2023 dhe në formular vetdeklarimi, ndërsa operatori ekonomik “Aci Enginnering” SHPK nuk ka deklaruar asnjë punonjës në pozicionin e mjekut të shoqërisë. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor për kriterin në pikën h) të dokumentave standarde të tenderit dhe nuk konsiderohet i vlefshëm.

Për sa më lart, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues nuk qëndron.

III.10. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “ENBI POWER” SHPK & “Aci Enginnering” SHPK se: “*KONTRATAT ENBI*
*I. K4_12 NENSTACIONET 62%*
*1. Certifikate përfundimi*
*2. Faturat*
*3. Situacione nuk ka, ka fatura blerje dhe konfigurimi, projektimi (Ska ndërtim duhet parë në zëra nëse konsiderohet kontratë e ngjashme teknikisht).*
*4. Marrëveshja e bashkëpunimit e papërkthyer dhe nuk ka ndarjen e zërave që merr përsipër të realizojë secili operator ekonomik*
*5. Kontratë*
*6. Akt kolaudimi*
*7. Ka vërtetim realizimi kontrate jo formular vlerësimi se nuk është kontratë pune*

*II. K 7- Fuqizimi i traktit të ri TR-4 NST 110/20 kv 1x20/25 MVA Plasmas Lushnje*
*1. Situacion përfundimtar e ka me objekt Fuqizimi i traktit të ri TR-4 NST 110/20 kv 1x20/25 MVA Plasmas Lushnje*
*2. Proces verbal marrje në dorëzim objektin e ka Rikonstruksion i nënstacionit plasmas 110/35/20/6 KV pra ska përputhje me objektin tek situacionet*
*3. Faturat*
*4. Akt kolaudimi*
*5. Kontrata*
*6. Ska formular vlerësimi*

*III. K-3 Nënstacioni Sallmone-Gjiri i Lalzit (ENBI&ONYX)*
*1. Situacion përfundimtar*
*2. Ka vërtetim realizimi jo formular vlerësimi sipas standardit sikundër kërkuar*
*3. Faturat*
*4. Akt kolaudimi*
*5. Kontratë*
*6. Ka Marrëveshje bashkëpunimi dhe prokurë por nuk ka tabelën e ndarjes së punëve*
*7. Certifikatë marrje në dorëzim*

*Vlera e realizuar nga ENBI POWER 156.268.465 lekë pa TVSh IV.*

*K-8 Kolektori kabllor 20 kv kombinat*
*1. Certifikatë marrje në dorëzim*
*2. Ka paraqitur vetëm një faturë tatimore në vlerë 3.548.729 lekë pa TVSh*
*3. Kontrata*
*4. Akt kolaudimi*
*5. Vërtetim për përmbushjen e kushteve të garancisë*
*6. Ska formular vlerësimi*
*7. Ska situacion përfundimtar*

*V. K-5 Rikonstruksion dhe fuqizim nënstacioni Selitë (kontrata furnizim malli)*
*1. Situacion përfundimtar*
*2. Fatura*
*3. Akt Kolaudimi*
*4. Kontrata*
*5. Certifikatë e pranimit të mallit*
*6. Ska formular vlerësimi as vërtetim realizimi të lëshuar nga autoriteti kontraktor*

*VI. K-1 Dizajnimi furnizimi dhe instalimi i nënstacionit 110.20kv kombinat (ENBI&JACOBSON) 60%*
*1. Kontrata*
*2. Certifikatë marrje në dorëzim*
*3. Formular Vlerësimi*
*4. Situacion përfundimtar*
*5. Ka marrëveshje bashkëpunimi dhe prokurën e posacme por nuk ka paraqitur tabelën e ndarjes së punimeve që ka marrë përsipër të realizojë secili operator*
*6. Akt kolaudimi*
*7. Fatura ka vetëm një faturë për situacionin përfundimtar*

*VII. K-9 Sallmone Loti I (ENBI&ALKOIMPEX) 63%*
*1. Marrëveshje bashkëpunimi dhe tabelën e ndarjes së punëve dhe prokurë*
*2. Situacion përfundimtar*
*3. Faturat*
*4. Kontrata*
*5. Ska formular vlerësimi*
*6. Ska certificatë marrje në dorëzim të punimeve*
*7. Ska akt kolaudimi*

*VIII. K-6 Nënstacioni Himara*
*1. Akt kolaudimi*
*2. Certifikatë e marrjes në dorëzim të objektit ska firmë mbikëqyrësi.*
*3. Fatura*
*4. Kontrata*
*5. Situacion përfundimtar*
*6. Ska formular vlerësimi*

*IX. K2-OST Rehabilitim i impiantit 110 KV RUBIK*
*1. Faturat tatimore*
*2. Kontrata*
*3. Akt Kolaudimi*
*4. Certifikatë marrje në dorëzim të punimeve*
*5. Situacion përfundimtar*
*6. Ka vërtetim realizimi ska formular vlerësimi sikundër kërkuar në dst".* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.10.1. Në shtojcën 7, "*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*", në pikën 2.3 *"Kapaciteti teknik"* në dokumentet standarde të tenderit në procedurën e prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

***2.3 Kapaciteti teknik:***
*Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori/et Ekonomik duhet të përmbushë/in kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:*

**2.3.1 Përvojë e suksesshme** *në realizimin e të paktën:*

***a)*** *Punë të ngjashme e realizuar për një objekt të vetëm në një vlere jo më e vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës të procedurës së prokurimit.*

*Ose*

***b)*** *Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e kontratave të punëve të kryera dhe të realizuara, të marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës të procedurës së prokurimit është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

*<u>Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.</u>*

*Puna e ngjashme duhet te jete ne nenstacione elektrike me nivel tensioni jo me te vogel se 110kV.*

**2.3.1/a** *Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:*

***e)*** *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.*

- *<u>Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:</u>*

- *Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;*
- *Kontratë Sipërmarrje;*
- *Situacionin përfundimtar te objektit;*
- *Fatura tatimore;*

- *Aktin e kolaudimit te objektit;*
- *Certifikaten e marrjes ne dorezim te perkohshem/perfundimtar*

**f)** *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.*

- *Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:*

- *Vërtetim per realizimin e punimeve ku të përcaktohet dhe përqindja e pjesëmarrjes së punës së realizuar në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik;*
- *Kontrate Sipërmarrje;*
- *Situacionin përfundimtar;*
- *Fatura tatimore per situacionin perfundimtar.*

- *Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues krahas dokumentacionit te sipercituar per secilin rast, respektivisht duhet te paraqese duhet te paraqesë: Kontraten e Bashkimit te operatoreve dhe Prokuren e Posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit shoqeruar me tabelen e ndarjes se punimeve qe ka marre persiper te kryeje secili anetar e i BOE.*
- *Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor si dhe Miratimi zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.*

III.10.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Enbi Power” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon.

1. Kontratë pune me nr. 1205 prot., datë 17.01.2019 me objekt “Projektim, Furnizim dhe Instalim i zgjerimit të SCDA/EMS ekzistuese në OST për Nënstacionet 110kV Kombinat” , lidhur midis bashkimit të operatorëve ekonomikë “Enbi Power” SHPK 60% dhe “Jacobs Elektro AS” 40% dhe autoriteti kontraktor Operatori Shqiptar i Energjisë Elektrike OSHEE Sha, me vlerë xxxxxxxxxxx lekë me TVSh.
2. Kontratë për bashkimin e përkohshëm të shoqërive, nr. 53 Rep., Nr.18 kol., datë 11.01.2018, ndërmjet operatorëve ekonomikë “Enbi Power” SHPK 60% dhe “Jacobs Elektro AS” 40% . Ku shoqëria “Enbi Power” SHPK do të kontribuojë në masën 60 % në këtë pjesëmarrje, Prokurë e posaçme Nr.54 Rep., Nr.19 Kol. Datë 11.01.2019.
3. Procesverbali i marrje në dorëzim me nr. 3374/1, datë 17.05.2021.
4. Situacioni përfundimtar i punimeve.
5. Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Operatori Shqiptar i Energjisë Elektrike OSHEE Sha për bashkimit të operatorëve ekonomikë “Enbi Power” SHPK

60% dhe “Jacobs Elektro AS” 40% për objektin e kontratës “Projektim, Furnizim dhe Instalim i zgjerimit të SCDA/EMS ekzistuese në OST për Nënstacionet 110kV Kombinat”, data e fillimit të kontratës 15.05.2019, data e mbarimit të punimeve të kontratës 19.09.2020, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga shoqëria ekonomikë “Enbi Power” SHPK 60% dhe “Jacobs Elektro AS” 40%; Vlerësimi: E përmbushur.

6. Akt kolaudimi me nr. 7020/2 prot., datë 04.03.2021.
7. Fatura tatimore nr. 71 datë 30.11.2020 (Situacion punimesh nr.14).

.................................

1. Certifikatë e marrjes në dorëzim me nr. 5072/5, datë 11.11.2019.
2. Akt kolaudimi me nr. 5072/4 prot., datë 11.11.2019.
3. Fatura tatimore nr. 63 datë 31.10.2018 situacion punimesh nr,1.
4. Fatura tatimore nr. 67 datë 30.11.2018 situacion punimesh nr,2 .
5. Fatura tatimore nr. 75 datë 31.12.2018 situacion punimesh nr,3
6. Fatura tatimore nr. 3 datë 31.01.2019 situacion punimesh nr,4
7. Fatura tatimore nr. 9 datë 28.02.2019 situacion punimesh nr,5
8. Fatura tatimore nr. 11 datë 31.03.2019 situacion punimesh nr,6
9. Fatura tatimore nr. 18 datë 30.04.2019 situacion punimesh nr,7
10. Fatura tatimore nr. 20 datë 31.05.2019 situacion punimesh nr,8
11. Fatura tatimore nr. 22 datë 30.06.2019 situacion punimesh nr,9
12. Fatura tatimore nr. 25 datë 31.07.2019 situacion punimesh nr,10
13. Kontratë pune me nr. 201/9 prot., datë 06.04.2018 me objekt “Rehabilitimi i impiantit 110kV të N/stacionit Rubik” , lidhur midis operatorit ekonomik “Enbi Power” SHPK dhe autoriteti kontraktor Operatori i Sistemit të Transmetimit OST Sha, me vlerë xxxxxxxxxxx lekë me TVSh.
14. Situacion përfundimtar
15. Vërtetim realizim kontrate nr. 2314/1 prot., datë 12.04.2021.

.........................................

1. Akt kolaudimi nr. 4442/5 prot., datë 21.12.2020.
2. Certifikatë e marrjes në dorëzim me nr. 4442/6 datë 21.12.2020.
3. Fatura tatimore nr. 1 datë 31.10.2019 situacion punimesh nr,1.
4. Fatura tatimore nr. 64 datë 30.11.2019 situacion punimesh nr,2
5. Fatura tatimore nr. 10 datë 31.12.2019 situacion punimesh nr,3
6. Fatura tatimore nr. 6 datë 31.01.2020 situacion punimesh nr,4.
7. Fatura tatimore nr. 16 datë 29.02.2020 situacion punimesh nr,5.
8. Fatura tatimore nr. 22 datë 31.03.2020 situacion punimesh nr,6.
9. Fatura tatimore nr. 26 datë 30.04.2020 situacion punimesh nr,7.
10. Fatura tatimore nr. 37 datë 31.05.2020 situacion punimesh nr,8.
11. Fatura tatimore nr. 45 datë 30.06.2020 situacion punimesh nr,9.
12. Kontratë pune me nr. 8448/11 prot., datë 22.10.2018 me objekt “Ndërtim Linja TL, 110 kV, N/Stacioni Sallmone Gjiri Lalëzit dhe shtese trakti 110 kVnë N/Stacionin Sallmone” , lidhur midis bashkimit të operatorëve ekonomikë “Enbi Power” SHPK dhe “ONYX”

SHPK dhe autoriteti kontraktor  Operatori i SIStemit të Transmetimit (OST Sha), me vlerë xxxxxxxxxxx lekë me TVSh.

13. Situacion përfundimatar (nr.9).
14. Vërtetim realizim kontrate nr. 2315/1 prot., datë 14.04.2021.

....................................................

1. Procesverbal kolaudimi nr. 4045/2 prot., datë 28.09.2021.
2. Certifikat e pranimit për Operimi datë 03.11.2014.
3. Certifkat përfundimi datë 03.11.2014.
4. Kontratë me nr. 8448 prot., datë 20.12.2019 me objekt "Projektim, Furnizim dhe Instalim i zgjerimit të SCDA/EMS ekszituese në OST për Nënstacionet 110kV" , lidhur midis bashkimit të operatorëve ekonomikë "Enbi Power" SHPK 60% dhe "Jacobs Elektro AS" 40% dhe autoriteti kontraktor  Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST Sha), me vlerë xxxxxxxxxxx lekë me TVSh.
5. Prokurë e posaçme Nr. 4473 Rep., Nr.858 kol., datë 06.08.2019.
6. Fatura tatimore nr. 38 datë 31.05.2020 situacion punimesh nr,1.
7. Fatura tatimore nr. 43 datë 30.06.2020 situacion punimesh nr,2.
8. Fatura tatimore nr. 48 datë 30.07.2020 situacion punimesh nr,3.
9. Fatura tatimore nr. 51 datë 21.08.2020
10. Fatura tatimore nr. 56 datë 31.08.2020 situacion punimesh nr,4.
11. Fatura tatimore nr. 59 datë 30.09.2020 situacion punimesh nr,5.
12. Fatura tatimore nr. 64 datë 31.10.2020 situacion punimesh nr,6.
13. Fatura tatimore nr. 67 datë 24.11.2020.
14. Fatura tatimore nr. 69 datë 30.11.2020 situacion punimesh nr,7.
15. Fatura tatimore nr. 73 datë 12.12.2020
16. Fatura tatimore nr. 11 datë 31.03.2021
17. Fatura tatimore nr. 18 datë 31.03.2021
18. Fatura tatimore nr. 24 datë 30.04.2021
19. Fatura tatimore nr. 27 datë 31.05.2021
20. Fatura tatimore nr. 31 datë 14.06.2021
21. Fatura tatimore nr. 33 datë 18.06.2021
22. Fatura tatimore nr. 35 datë 21.06.2021
23. Situacione

.....................................

1. Kontratë malli me nr. 955/23 prot., datë 23.11.2020 me objekt "Rokonstruksion dhe fuqizim i N/Stacionit të Selitës 110/20 kV" , lidhur operatorit ekonomik "Enbi Power" dhe autoriteti kontraktor  Drejtoria e Përgjithshme e Tensionit të Lartë, me vlerë xxxxxxxxxxx lekë me TVSh.
2. Akti koludimi nr. 955/42 prot., datë 29.06.2021.
3. Certifikat e pranimit të mallit
4. me nr. 955/43 prot., datë 29.06.2021.
5. Faturë tatimore nr. 37, datë 22.06.2021
6. Situacion përfundimtar.

.........................................

1. Kontratë pune me nr. 348/20 prot., datë 11.06.2021 me objekt “Fuqizimi i N/Stacionit Himara e Re 110/35/20kV” , lidhur operatorit ekonomik “Enbi Power” SHPK dhe autoriteti kontraktor  Drejtoria e e Tensionit të Lartë”OSSH sha.,, me vlerë xxxxxxxxxxx lekë me TVSh.
2. Faturë tatimore nr. 52/2022, datë 08.08.2022.
3. Procesverbal mbi marrjen në dorëzim të punimeve dhe mallrave me nr. 348/67 prot., datë 26.08.2022.
4. Situacion punimesh nr. 4 përfundimtar.
5. Akt kolaudimi nr. 348/65 prot., datë 12.08.2022.

..................................................

1. Kontratë pune me nr. 348/20 prot., datë 11.06.2021 me objekt “Rikonstruksion i N/Stacionit Plasmasi 110/35/20/6 kV” , lidhur operatorit ekonomik “Enbi Power” SHPK dhe autoriteti kontraktor Drejtoria e e Tensionit të Lartë OSSH sha. me vlerë xxxxxxxxxxx lekë me TVSh.
2. Akt kolaudimi
3. Procesverbal mbi marrjen në dorëzim të punimeve dhe mallrave me nr. 353/65 prot., datë 09.08.2022.
4. Fatura tatimore nr. 31/2022 datë 09.06.2022
5. Situacion përfundimtar nr,3.

..........................................

1. Certifikat marrje në dorëzim të punimeve me nr. 105/6 prot., datë 08.03.2021.
2. Kontratë pune me nr. 3838/11 prot., datë 16.07.2019 me objekt “Ndërtim i kolektorit kabllor 20kV N/Stc Kombinat 110/20/10 kV Tiranë, Ndërtim i Fiderit T1 20kV, N/Stc Kombinat  dhe Ndërtim i Fiderit T2 20kV, N/Stc Kombinat” , lidhur ndërmjet operatorit ekonomik “Enbi Power” SHPK dhe autoriteti kontraktor  Drejtoria Rajonale Tiranë OSHEE sha., me vlerë xxxxxxxxxxx lekë me TVSh.
3. Akt kolaudimi me nr.105/4 prot., datë 01.03.2021.
4. Faturë tatimore nr. 6 datë 31.01.2021, situacion punimesh nr,10 .
5. Vërtetim për përmbushjen e kushteve të garancisë së punimeve nr. 4406/3 prot., datë 18.11.2022.

...................................

1. Faturë tatimore nr. 18/2022 datë 30.03.2022
2. Kontratë pune me nr. 219/9 prot., datë 01.06.2021 me objekt “Zgjatimi i fiderit 12 me kabina dhe rrjet të ri TU, nënstacioni 110/20 kV Sallmone, Loti 1” , lidhur me bashkimin e operatorëve ekonomikë “Enbi Power” SHPK & “Alko Impex General Construction” SHPK dhe autoriteti kontraktor  Drejtoria e Rajonale e OSSH Durrës sha.,, me vlerë xxxxxxxxxxx lekë me TVSh.
3. Kontratë për bashkimin e përkohshëm të shoqërive, nr. 1886 Rep., Nr.410/2 kol., datë 23.03.2021, ndërmjet operatorëve ekonomikë “Enbi Power” SHPK 63% dhe “Alko Impex General Construction” SHPK 37% . Ku shoqëria “Enbi Power” SHPK do të kontribuojë në masën 63% në këtë pjesëmarrje, Prokurë e posaçme Nr.1887 Rep., Nr.411/2 Kol.  Datë 23.03.2021.
4. Situacion punimesh përfundimtar.

III.10.3. Në nenin 77 te ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

III.10.4. Në nenin 39 "*Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike*" pika 5 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", e ndryshuar,* parashikohet se:

*"5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

*a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;*

*b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

*Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.*

*Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve."*

III.10.5. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit KPP vëren, se autoriteti kontraktor në kapacitetin teknik ka kërkuar shprehimisht që: *Punë të ngjashme e realizuar për një objekt të vetëm në një vlere jo më e vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës të procedurës së prokurimit.*

*Ose*

*Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e kontratave të punëve të kryera dhe të realizuara, të marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës të procedurës së prokurimit është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

*Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.*

*Puna e ngjashme duhet te jete ne nenstacione elektrike me nivel tensioni jo me te vogel se 110kV.[...]"*

III.10.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.10.7. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, për kontratat për punë publike, për të provuar përvojën e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë njërin prej dy kushteve të përcaktuara në nenin 39 pika 5 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", e ndryshuar,* ku operatori ekonomik duhet të provojë se ka kryer punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; ose të provojë se ka kryer punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.
Sa më sipër, referuar kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor për sa i përket eksperiencës së ngjashme, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur operatori ekonomik ekonomik "Enbi Power" SHPK, konstatojmë, se ky i fundit nuk përmbush kushtin e parë të vendosur nga autoriteti kontraktor për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë

pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kështu që rrjedhimisht KPP verifikoi dokumentacionin e dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik "Enbi Power" SHPK për plotësimin e kushtit të dytë "*të provojë se ka kryer punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet*".

Sa më sipër, nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ky i fundit në Sistemin e Prokurimit Publik, konstatohet, se operatori ekonomik "Enbi Power" SHPK për secilën nga punët e ngjashme të deklaruara, ka paraqitur dokumentacionin përkatës të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Konkretisht ka paraqitur:

-Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Operatori Shqiptar i Energjisë Elektrike OSHEE Sha për bashkimit të operatorëve ekonomikë "Enbi Power" SHPK 60% dhe "Jacobs Elektro AS" 40% për objektin e kontratës "Projektim, Furnizim dhe Instalim i zgjerimit të SCDA/EMS ekzistuese në OST për Nënstacionet 110kV Kombinat", data e fillimit të kontratës 15.05.2019, data e mbarimit të punimeve të kontratës 19.09.2020, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga shoqëria ekonomikë "Enbi Power" SHPK 60% dhe "Jacobs Elektro AS" 40%; Vlerësimi: E përmbushur si dhe dokumentacionin shoqërues siç kërkohet në dokumentet e tenderit si Kontratë Sipërmarrje, Situacion përfundimtar, Akt Kolaudimi, procesverbal i marrjes në dorëzim objekti, Kontratën e Bashkimit të operatorëve ekonomikë si dhe prokurën e posaçme dhe fatura.

-Kontratë pune me nr. 201/9 prot., datë 06.04.2018 me objekt "Rehabilitimi i impiantit 110kV të N/stacionit Rubik" , lidhur midis operatorit ekonomik "Enbi Power" SHPK dhe autoriteti kontraktor Operatori i Sistemit të Transmetimit OST Sha, me vlerë xxxxxxxxxxx lekë me TVSh si dhe dokumentacionin shoqërues siç kërkohet në dokumentet e tenderit si Vërtetim realizim kontrate, Situacion përfundimtar, Akt Kolaudimi, Certifikatën e marrjes në dorëzim objekti dhe fatura.

-Kontratë pune me nr. 8448/11 prot., datë 22.10.2018 me objekt "Ndërtim Linja TL, 110 kV, N/Stacioni Sallmone Gjiri Lalëzit dhe shtese trakti 110 kVnë N/Stacionin Sallmone" , lidhur midis bashkimit të operatorëve ekonomikë "Enbi Power" SHPK dhe "ONYX" SHPK dhe autoriteti kontraktor Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST Sha), me vlerë xxxxxxxxxxx lekë me TVSh si dhe dokumentacionin shoqërues siç kërkohet në dokumentet e tenderit si Vërtetim realizim kontrate, Situacion përfundimtar, Akt Kolaudimi, Certifikatën e marrjes në dorëzim objekti dhe fatura.

Sa më sipër, referuar kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor për sa i përket kontratave të ngjashme, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik "Enbi Power" SHPK, konstatojmë, se ky i fundit nuk ka paraqitur një kontratë të ngjashme për një objekt të vetëm në vlerën jo më të vogël se 50 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që do të prokurohet, siç është kërkuar në dokumentet e tenderit. Kështu që, rrjedhimisht KPP verifikoi plotësimin e kushtit të dytë *"Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet* konkretisht: 1,299,991,026 lekë pa TVSH".

III.10.8. Sa më lart, nga verifikimi i punëve të realizuara dhe dokumentacionit shoqërues të tyre, të paraqitur si dëshmi për eksperiencat e mëparshme të ngjashme, konstatohet se operatori ekonomik ankimues ka kryer punime të ngjashme me zërat në preventivin e hartuar nga autoriteti kontraktor për këtë procedurë prokurimi.

KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Sa më sipër, nisur nga arsyeja e skualifikimit, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale, por të analizojë në themel dhe në mënyrë të arsyeshme e proporcionale eksperiencat e dokumentuara nga ofertuesit/kandidatët, në funksion të qëllimit dhe rrethanave faktike për të cilin vendosen kriteret e përcaktuara.

Pra, për të plotësuar pikën e mësipërme të kërkesave për kualifikim për eksperiencën e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet dhe jo kontrata të njëjta, pasi për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi, por edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Sa më sipër, KPP konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik ankimues vërteton se ka kryer punime të ngjashme me zërat e parashikuara për kontratën objekt - shqyrtimi. Gjithashtu, nga përllogaritja e vlerës së punëve të ngjashme të paraqitura nga operatori ekonomik ankimues, duke e përllogaritur sipas përqindjes së pjesëmarrjes së këtij të fundit në secilën prej kontratave të paraqitura, vlen të theksohet, se vlera e përgjithshme e punimeve të ngjashme të realizuara në dokumentet e paraqitura nga ky operator ekonomik, nuk e tejkalon vlerën prej 1,299,991,026 lekë pa TVSH *“Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet*, të përcaktuar nga autoriteti kontraktor. Nga verifikimi i zërave dhe volumeve të ngjashme të preventivit të kontratave të paraqitura nga ankimuesi si eksperienca të ngjashme të mëparshme, nga përllogaritja e zërave të ngjashëm për sa i përket llojit, tipologjisë, emërtimit/përshkrimit, me zërat e preventivit të kontratës objekt - shqyrtimi, rezulton se operatori ekonomik ankimues ka arritur të dëshmojë se ka kryer kontrata të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit *jo në vlerën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor* në dokumentet e tenderit, pasi zërat e konsideruar të ngjashëm përmbushin vlerën prej 336,400,116.33 lekë pa TVSH, *jo konform kërkesës së autoritetit kontraktor*.

Referuar parashtrimeve të mësipërme, KPP, kërkon të sqarojë, se në lidhje me:

-Kontratën e Sipërmarrjes me nr. 8448 prot., datë 20.12.2019 me objekt “Projektim, Furnizim dhe Instalim i zgjerimit të SCDA/EMS ekzistuese në OST për Nënstacionet 110kV” , lidhur midis bashkimit të operatorëve ekonomikë “Enbi Power” SHPK 60% dhe “Jacobs Elektro AS” 40% dhe autoriteti kontraktor Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST Sha), me vlerë xxxxxxxxxxx lekë me TVSh, nuk është kontratë punë por shërbimi dhe si e tillë nuk është

marrë në konsideratë. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se operatori ekonomik "Enbi Power" SHPK me dokumentacionin e paraqitur, nuk provon se ka kryer furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit, duke mos plotësuar kështu kërkesën për kualifikim, për përvojë të suksesshme, pasi kontrata e paraqitur përmban objekt dhe natyrë, të cilat nuk janë të ngjashme me objektin e prokurimit, i cili si komponent kryesor të procedurës së prokurimit ka shërbimin.

-Kontratë *malli* me nr. 955/23 prot., datë 23.11.2020 me objekt "Rikonstruksion dhe fuqizim i N/Stacionit të Selitës 110/20 kV", lidhur operatorit ekonomik "Enbi Power" SHPK dhe autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Tensionit të Lartë, me vlerë xxxxxxxxxxx lekë me TVSh, nuk është kontratë punë por malli dhe si e tillë nuk është marrë në konsideratë. Në bazë të përcaktimeve të legjislacionit për prokurimin publik, bazuar edhe në konceptin e përgjithshëm të prokurimeve, "Kontrata publike për punë", janë kontratat publike që kanë si objekt të tyre:

a) kryerjen ose projektimin dhe kryerjen e punëve në lidhje me një ose më tepër aktivitete ndërtimore, sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik;

b) realizimin ose projektimin dhe realizimin e një pune;

c) realizimin me anë të çdo mjeti të një pune, që përkon me kërkesat e specifikuara nga autoriteti kontraktor që ushtron një ndikim vendimtar në llojin ose projektin e punës. Kontratat e ngjashme, që të mund të konsiderohen të tilla duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme. Pra, (i) objekti i përfunduar i kontratës duhet të jetë brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor, në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (elementi vlerë) dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe një prej këtyre elementëve e bën të pavlefshme eksperiencën e ngjashme të paraqitur nga kandidati ofertues.

Në këtë kuptim, KPP gjykon, se operatori ekonomik "Enbi Power" SHPK me dokumentacionin e paraqitur, nuk provon se ka kryer furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit, duke mos plotësuar kështu kërkesën për kualifikim, për përvojë të suksesshme, pasi kontrata e paraqitur përmban objekt dhe natyrë të cilat nuk janë të ngjashme me objektin e prokurimit, i cili si komponent kryesor të procedurës së prokurimit ka furnizimin me mallra.

-Kontratë pune me nr. 348/20 prot., datë 11.06.2021 me objekt "Fuqizimi i N/Stacionit Himara e Re 110/35/20kV", lidhur operatorit ekonomik "Enbi Power" SHPK dhe autoriteti kontraktor Drejtoria e Tensionit të Lartë"OSSH ShA., me vlerë xxxxxxxxxxx lekë me TVSh, s'ka formular vlerësimi dhe nuk është marrë në konsideratë.

-Kontratë pune me nr. 348/20 prot., datë 11.06.2021 me objekt "Rikonstruksion i N/Stacionit Plasmasi 110/35/20/6 kV", lidhur operatorit ekonomik "Enbi Power" SHPK dhe autoriteti kontraktor Drejtoria e Tensionit të Lartë OSSH sha. me vlerë xxxxxxxxxxx lekë me TVSh, s'ka formular vlerësimi dhe nuk është marrë në konsideratë.

-Kontratë pune me nr. 219/9 prot., datë 01.06.2021 me objekt "Zgjatimi i fiderit 12 me kabina dhe rrjet të ri TU, nënstacioni 110/20 kV Sallmone, Loti 1", lidhur me bashkimin e operatorëve ekonomikë "Enbi Power" SHPK & "Alko Impex General Construction" SHPK dhe autoriteti kontraktor Drejtoria e Rajonale e OSSH Durrës ShA, me vlerë xxxxxxxxxxx

lekë me TVSh, s'ka formular vlerësimi, certifikatë marrje në dorëzim të punimeve, s'ka stituacion përfundimtar dhe nuk është marrë në konsideratë.

III.10.9. Nisur nga sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, për të vërtetuar eksperiencën e mëparshme, nuk është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se kontratat e paraqitura nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Në këto kushte, KPP gjykon, se bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues nuk e ka përmbushur kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor, për sa i përket eksperiencës së mëparshme të ngjashme, referuar përqindjes së secilit në kontratën e përkohshme të bashkëpunimit.

Rrjedhimisht pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik"*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 *"Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik",* Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *"Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19"*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

**Vendos:**

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik "4 A-M" SHPK për procedurën e prokurimit "*Procedure e Hapur" me mjete elektronike – Pune mbi kufirin e lartë monetar*" me nr. REF-76782-08-04-2023 me objekt: "*Rikonstruksion dhe fuqizimi i N/Stacionit Kuçovë 110/35/20/10/6 kV*", me fond limit 649.995.513.87 (*gjashtëqind dyzet e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë e pesëqind e trembëdhjetë pikë tetëdhjetë e shtatë*) lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 11.09.2023, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Tensionit të Lartë OSSH, ShA.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë "ENBI POWER" SHPK & "Aci Enginnering" SHPK për procedurën e prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik "4 A-M" SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.

5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “4 A-M” SHPK.
6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “ENBI POWER” SHPK & “Aci Enginnering” SHPK.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

| Nënkryetar | Anëtar | Anëtar |
|---|---|---|
| Fiorent Zguro | Kreshnik Ternova | Anila Malaj |

**Kryetar**

**Jonaid Myzyri**

Digitally signed by Jonaid MYZYRI
Date: 2023.11.16 05:19:53

Vulosur elektronikisht nga Komisioni i Prokurimit Publik
Date:2023/11/16 14:29:34 +02'00'
2406132023111614292670020



*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Komisioni i Prokurimit Publik)*